



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT



PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL



Prill, 2010

PËRMBAJTJA:**1. HYRJE**

- 1.1. SISTEMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOSOVË
- 1.2. PËRFITUESIT E PROJEKTIT
- 1.3. BURIMI I TË DHËNAVE PËR HARTIMIN E PROFILIT KOMUNAL
- 1.4. ROLI DHE NATYRA E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

2. ROLI I PJESËMARRËSVE

- 2.1. ROLET-VENDIMMARRËSE /JO VENDIMMARRËSE
- 2.2. QEVERISJA KOMUNALE
- 2.3. NDARJA ADMINISTRATIVE DHE QEVERISJA E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

FAZA E PARË**I. PROFILI DHE VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE**

- I.1. HISTORIKU I KOMUNES**
- I.2. POZITA GJEOGRAFIKE KUFINJËT , MADHËSIA, DHE MIKROPOZITA E KAÇANIKUT**
- I.3. ZHVILLIMI DEMOGRAFIK I KOMUNËS SË KAÇANIKUT**
 - 3.1. NUMRI I POPULLSISË
 - 3.2. DENDËSIA E POPULLSISË
 - 3.3. SHTIMI NATYROR I POPULLSISË
 - 3.4. STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS MOSHËS DHE GJINISË
 - 3.5. STRUKTURA ETNIKE DHE FETARE E POPULLSISË
 - 3.6. STRUKTURA ARSIMORE E POPULLSISË
 - 3.7. FAMILJA DHE KARAKTERISTIKAT E SAJË
 - 3.8. LËVIZJA MEKANIKE E POPULLSISË - MIGRIMET
- I.4. ÇËSHTJET SOCIALE**
 - 4.1. ARSIMI
 - 4.2. SHËNDETËSIA
 - 4.3. PAPUNËSIA
 - 4.4. VARFËRIA
 - 4.5. KULTURA, RINIA DHE SPORTI
- I.5. VENDBANIMET**
 - 5.1. TIPOLOGJIA E VENDBANIMEVE SIPAS MADHËSISË
 - 5.2. SHTRIRJA HAPËSINORE E VENDBANIMEVE SIPAS MADHËSISË
 - 5.3. KARAKTERISTIKAT MORFOLOGJIKE DHE URBANISTIKE TË VENDBANIMEVE
 - 5.4. FUNKSIONALITETI I VENDBANIMEVE
 - 5.5. RRJETI I VENDBANIMEVE
 - 5.6. KARAKTERISTIKAT E VENDBANIMEVE SIPAS ZONA VE
 - 5.7. BANIMI NË KOMUNËN E KAÇANIKUT
 - 5.8. VENDBANIMET JOFORMALE
 - 5.9. SHFRYTËZIMI I TOKËS NË KOMUNËN E KAÇANIKUT
- I.6. KARAKTERISTIKAT FIZIKO - GJEOGRAFIKE DHE MJEDISI**
 - 6.1. NDËRTIMI GJEOLOGJIK DHE MBËRTHIMI TEKTONIK
 - 6.2. KARAKTERISTIKAT LITOSTRATIGRAFIKE
 - 6.3. TEKTONIKA
 - 6.4. SEIZMIKA
 - 6.5. RELIEVI
 - 6.6. EROZIONI DHE VERSHIMET
 - 6.7. KUSHTET KLIMATIKE, VALORIZIMI KLIMATIK, KARAKTERISTIKAT
 - 6.8. HIDROGRAFIA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT
 - 6.9. TOKAT
 - 6.10. BOTA BIMORE DHE SHTAZORE
 - 6.11. PYJET
 - 6.12. LIVADHET DHE KULLOSAT
 - 6.13. NDOTJA E UJIT
 - 6.14. DEGRADIMI I LUMENJËVE
 - 6.15. NDOTJA E AJRIT

- 6.16. DEGRADIMI I TOKËS
- 6.17. TRASHËGIMIA KULTURORE
- 6.18. TRASHËGIMIA NATYRORE

I.7. ZHVILLIMI EKONOMIK

- 7.1. BUJQËSIA, BLEGTORIA , SHPEZËTARIA
- 7.2. TRANSPORTI DHE TELEKOMUNIKACIONI
- 7.3. TREGTIA
- 7.4. TURIZMI
- 7.5. INDUSTRIA
- 7.6. MINJERAT DHE XEHETARIA
- 7.7. TREGU I PUNËS DHE PAPUNËSIA
- 7.8. PROJEKTET KAPITALE TË REALIZUARA NË PERIUHDHËN 2001-2008

I.8. INFRASTRUKTURA

- 8.1. INFRASTRUKTURA RRUGORE
- 8.2. RRJETI HEKURUDHOR
- 8.3. ENERJIA ELEKTRIKE
- 8.4. INFRASTRUKTURA E FURNIZIMIT ME UJË
- 8.5. SISTEMI I KANALIZIMIT
- 8.6. TELEKOMUNIKACIONI
- 8.7. MENAXHIMI I MBETURINAVE

I.9 SËOT ANALIZA – KOMUNA E KAÇANIKUT**I.10. SFIDAT E IDENTIFIKUARA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT****I.11. POTENCIALET LOKALE TË IDENTIFIKUARA****FAZA E DYTË****II. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET****II.1. PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS**

- 1.1. KARAKTERISTIKAT PËR ZONËN E VERDHË
- 1.2. VIZIONI PËR ZONËN E VERDHË
- 1.3. ZONAT ME INTERES TË VEÇANTË NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

II.2. VIZIONI PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT**II.3. PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT****II.4. PARIMET E QEVERISJES SË MIRË****II.5. QËLLIMET AFATGJATE TË ZHVILLIMIT****II.6. PRORITETET STRATEGJIKE****FAZA E TRETË****III. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË KOMUNËS****III.1. KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR**

- 1.1. SKENARËT E ZHVILLIMIT HAPËSINOR
- 1.2. STRUKTURAT KRYESORE HAPËSINORE
- 1.3. ZONAT DHE AKTIVITETET E TYRE
- 1.4. QENDRAT DHE ORGANIZIMI FUNKSIONAL I KOMUNËS
- 1.5. RRJETI I TRAFIKUT

III.2. STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

- 2.1. ZHVILLIMI EKONOMIK
- 2.2. POPULLSIA DHE VENDBANIMET
 - 2.2.1. PARASHIKIMET DEMOGRAFIKE
 - 2.2.2. VENDBANIMET
 - 2.2.3. ADMINISTRIMI TERRITORIAL
 - 2.2.4. ZHVILLIMI I VENDBANIMEVE
- 2.3. INFRASTRUKTURA SOCIALE DHE TRASHËGIMIA
 - 2.3.1. ARSIMI
 - 2.3.2. INSTITUCIONET SHËNDETËSORE
 - 2.3.3. ZVOGËLIMI I PAPUNËSISË DHE VARFËRISË
 - 2.3.4. TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

- 2.4. MOBILITETI DHE RRJETI I TRAFIKUT
- 2.5. INFRASTRUKTURA TEKNIKE
- 2.6. MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS
- 2.7. FATKEQËSITË ELEMENTARE DHE MASAT MBROJTËSE
- 2.8. SHËNJIMI I ZONAVE URBANE EKZISTUESE DHE TË PROPOZUARA PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM DHE NDËRTIMIN E ZONAVE JASHTË ZONËS URBANE
- 2.9. SHËNJIMI I ZONAVE TË RËNDËSISHME STRATEGJIKE, ZONAVE TË VEÇANTA TË APROVUARA NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS OSE PLANET E ZONAVE TË VEÇANTA

FAZA E KATËRT

IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT KOMUNAL

IV.1. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SOCIAL DHE ADMINISTRATËS

- 1.1. ADMINISTRATË PUBLIKE EFIKASE
- 1.2. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE DHE TEKNIKE NË SHËRBIMET SHËNDETËSORE DHE ARSIMORE
- 1.3. MINIMIZIM TË SHKALLËS SË PAPUNËSISË DHE VARFËRISË
- 1.4. KULTURA, SPORTI DHE REKREACIONI

IV.2. STRATEGJIA PËR KRIJIMIN E KUSHTEVE MË TË MIRA NË VISET RURALE

- 2.1. LIDHJE FUNKSIONALE ME QENDRËN URBANE
- 2.2. OFRIM ADEKUAT I SHËRBIMEVE PUBLIKE

IV.3. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT KOMPAKT DHE FUNKSIONALIZIMIT TË VENDBANIMEVE

IV.4. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM MJEDISOR

IV.5. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

- 5.1. ZHVILLIMI I EKONOMISË SË QËNDRUESHME

IV.6. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS

- 6.1. RRJETI I RRUGËVE
- 6.2. RRJETI HEKURUDHOR
- 6.3. INFRASTRUKTURË TEKNIKE FUNKSIONALE DHE CILËSORE
- 6.4. ENERJIA ELEKTRIKE
- 6.5. TELEKOMUNIKACIONI

FAZA E PESTË

V. DISPOZITAT PËR ZBATIM

- V. 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME
- V. 2. DETYRAT DHE MASAT PËR ZBATIMIN E PLANIT
- V. 3. KUSHTET PËR PËRCAKTIMIN E DESTINIMIT TË SIPËRFAQEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS
- V. 4. KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS
- V. 5. ZHVILLIMI I VENDBANIMEVE DHE NDËRTIMET TJERA JASHTË TYRE
- V. 6. ZHVILLIM SOCIAL DHE ADMINISTRATË EFIKASE
- V. 7. MJEDISI PASTËR DHE ATRAKTIV
- V. 8. ZHVILLIMI EKONOMIK I KOMUNËS
- V. 9. KUSHTET PËR VENDOSJEN E KORRIDOREVE APO TRASEVE, SIPËRFAQEVE KOMUNIKUESE DHE SISTEMEVE TJERA TË INFRASTRUKTURËS
- V. 10. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

TABELA E SHKURTESAVE:

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BPV (GDP)	Bruto Produkti i Vendit (Gross Domestic Product)
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
FMN (IMF)	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GND	Të ardhurat nacionale në dispozicion
KKK	Kuvendi Komunal i Kaçaniku
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
ZHEL	Zhvillimi Ekonomik Lokal
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
PSZHAKSH	Plani Strategjik Zhvillimor Afatmesëm komunës Kaçaniku
UNHCER	United nation Development program
	Programi i kombeve të Bashkuara për zhvillim
UNDP	United Nations High Commissioner for refugees
	Komisioni i lartë i kombeve të bashkime për refugjat

LISTA E SKEMAVE

Skema 1. Skema e mobilizimit institucional

LSTA E TABELAVE

- Tabela 1.** Vendbanimet në Komunën e Kaçanikut
Tabela 2. Gjatësia e vijës kufitare në Komunën e Kaçanikut
Tabela 3. Numri i popullsisë sipas regjistrimeve
Tabela 4. Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor
Tabela 5. Numri i popullsisë sipas vendbanimeve
Tabela 6. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve
Tabela 7. Kontingjentet më të rëndësishëm të strukturës së moshës dhe gjinisë në %
Tabela 8. Niveli i shkollimit
Tabela 9. Migrimi i popullsisë sipas vendeve të migrimit
Tabela 10. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë demografike në periudhën 1981-2009
Tabela 11. Popullsia dhe dendësia e banimit në zonat e ndërtuara, në hektar
Tabela 12. Rrjeti i vendbanimeve dhe dendësia e popullsisë në km²
Tabela 13. Dendësia dhe distanca mesatare e vendbanimeve në komunë
Tabela 14. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë
Tabela 15. Indikatorët themelorë të hapësirës Kodrinore-malore, mbi 700m, periudha 1981-2009
Tabela 16. Dendësia e popullsisë sipas zonave të lartësisë mbidetare në komunë në vitin 2009
Tabela 17. Shfrytëzimi i tokës ne hektar
Tabela 18. Pjesëmarrja e sipërfaqeve nëpër kate hipsometrike në Komunën e Kaçanikut
Tabela 19. Shkalla e erozionit
Tabela 20. Kategoria e erozionit
Tabela 21. Temperaturat në Ferizaj
Tabela 22. Lagështia e ajrit në Ferizaj
Tabela 23. Sasia e reshjeve në milimetra Kaçanik
Tabela 24. Ditët me borë për stacionin e Ferizajt
Tabela 25. Mesataret mujore të diellzimit-orë me diell/muaj -Ferizaj
Tabela 26. Tipet e tokave në Komunën e Kaçanikut
Tabela 27. Objektet arkeologjike dhe historike ne Komunën e Kaçanikut
Tabela 28. Monumentet me status të mbrojtjes në Komunën e Kaçanikut
Tabela 29. Struktura e përgjithshme e tokës ne Komunën e Kaçanikut
Tabela 30. Kategoritë e tokës bujqësore ne Komunën e Kaçanikut
Tabela 32. Të punësuarit dhe buxheti familjarë sipas vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut
Tabela 33. Rrjeta e rrugëve në Komunën e Kaçanikut
Tabela 34. Rrugë nacionale dhe aktivitetet
Tabela 35. Numri i banorëve që kanë qasje direkt në rrugët nacionale dhe regionale
Tabela 36. Kategorizimi i rrugëve në Komunën e Kaçanikut
Tabela 37. Statusi i rrugëve në vendbanimet në Komunën e Kaçanikut
Tabela 38. Pjesëmarrja e popullatës në rrjetin hekurudhor
Tabela 39. Qasja në transportin publik në Komunën e Kaçanikut
Tabela 40. Trafo-stacionet në Komunën e Kaçanikut
Tabela 41. Statusi i furnizimit me energji elektrike
Tabela 42. Resurset ujore
Tabela 43. Shtrirja e rrjetit të telefonisë
Tabela 44. Organizimi i mbeturinave në vendbanime
Tabela 45. Vendbanimet dhe nr. i popullsisë në Komunën e Kaçanikut/2009-2020
Tabela 46. Kategorizimi i rrugëve në Komunën e Kaçanikut
Tabela 47. Vendbanimet dhe popullsia e zonës aktive
Tabela 48. Kategoria e tokave dhe pjesëmarrja
Tabela 49. Vendbanimet dhe popullsia e zonës së vlerave natyrore - perëndimore
Tabela 50. Kategoria e tokave dhe pjesëmarrja
Tabela 51. Vendbanimet dhe popullsia në zonën e vlerave natyrore - lindore

LISTA E GRAFEVE

Grafiku 1.	Numri i popullsisë sipas regjistrimeve
Grafiku 2.	Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor
Grafiku 3.	Numri i popullsisë sipas vendbanimeve
Grafiku 4.	Shtimi natyror në vitin 2008
Grafiku 5.	Piramida e popullsisë së komunës së Kaçanikut në vitin 2009
Grafiku 6.	Tri grup-moshat e popullsisë së komunës
Grafiku 7.	Përqindja e popullsisë sipas gjinisë në Komunën e Kaçanikut
Grafiku 8.	Niveli i shkollimit
Grafiku 9.	Përqindja e familjeve sipas numrit të anëtareve
Grafiku 10.	Migrimi i popullsisë sipas vendeve të migrimit
Grafiku 11.	Objektet shkollore m ² / nxënës dhe numri i turneve, 2009
Grafiku 12.	Numri i nxënësve/mësimdhënës dhe kualifikimet e personelit arsimor
Grafiku 13.	Punëtorët shëndetësor në 10 000 banorë në komunë
Grafiku 14.	Papunësia sipas vendbanimeve dhe punëkërkesit në %
Grafiku 15.	Papunësia sipas moshës dhe gjinisë
Grafiku 16.	Punëkërkesit sipas kualifikimeve
Grafiku 17.	Shkalla e varfërisë në Kaçanik
Grafiku 18.	Popullsia me asistencë sociale – varfëri ekstreme
Grafiku 19.	Numri i vendbanimeve sipas madhësisë demografike për periudhën 1981-2009
Grafiku 20.	Pjesëmarrja e sipërfaqeve, popullsisë dhe e vendbanimeve në vitin 2009 sipas lartësisë mbidetare
Grafiku 21.	Shfrytëzimi i tokës në hektar
Grafiku 22.	Trëndafili i erërave
Grafiku 23.	Shpejtësia e erës
Grafiku 24.	Prurjet mesatare mujore të lumit Lepenc për periudhën 1951-75
Grafiku 25.	Pjesëmarrja e disa kulturave bujqësore në ha/tone
Grafiku 26.	Struktura e fundit të blegtorisë
Grafiku 27.	Numri dhe raporti i gjedheve, deleve-dhive dhe shpezëve për koke banori ne Komunën e Kaçanikut
Grafiku 28.	Raporti në mes madhësive të ngastrave/ha në Komunën e Kaçanikut
Grafiku 29.	Raporti në mes madhësive të ngastrave në komunat kadastrale të Kaçanikut
Grafiku 30.	Struktura e bizneseve ne Komunën e Kaçanikut
Grafiku 31.	Struktura industriale ne Komunën e Kaçanikut
Grafiku 32.	Projektet kapitale të realizuara në periudhën 2008-08' në Komunën e Kaçanikut
Grafiku 33.	Sipërfaqja e tokave me rrugë sipas parcelave kadastrale në Komunën e Kaçanikut
Grafiku 34.	Pjesëmarrja e popullsisë në rrugë nacionale dhe regionale
Grafiku 35.	Popullsia me qasje në transport publik
Grafiku 36.	Popullsia në% sipas kualitetit të furnizimit me energji elektrike
Grafiku 37.	Cilësia e ujit për pije
Grafiku 38.	Cilësia e ujit për pije në rajonin rural
Grafiku 39.	Rrjeti i telefonisë fikse

LISTA E HARTAVE

Harta 1.	Vendbanimet e komunës
Harta 2.	Pozita e komunës së Kaçanikut në Kosovë
Harta 3.	Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve
Harta 4.	Shtrirja hapësinore e Objekteve shkollore
Harta 5.	Objektet shëndetësore
Harta 6.	Vendbanimet sipas madhësisë në Komunën e Kaçanikut
Harta 7.	Organizimi administrativ i komunës së Kaçanikut
Harta 8.	Rrjeti i vendbanimeve
Harta 9.	Vendbanimet dhe dendësia e popullsisë
Harta 10.	Shtrirja e vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare në Komunën e Kaçanikut
Harta 11.	Vendbanimeve jo formale
Harta 12.	Shfrytëzimi i tokës në Komunën e Kaçanikut
Harta 13.	Lokacioni i varrezave në Komunën e Kaçanikut
Harta 14.	Gjeologjia e komunës së Kaçanikut

Harta 15.	Harta sizmike e komunës së Kaçanikut
Harta 16.	Hipsometria e terrenit
Harta 17.	Erozionet në Komunën e Kaçanikut
Harta 18.	Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet
Harta 18.	Lumenjtë dhe rrugët kryesore
Harta 19.	Harta pedologjike
Harta 20.	Pyjet në Komunën e Kaçanikut
Harta 21.	Ndotja e lumenjve
Harta 22.	Vërshimet, gurthyesit dhe degradimet e tokës
Harta 23.	Trashëgëmia kulturore
Harta 24.	Struktura dhe shpërndarja e tokave në Komunën e Kaçanikut
Harta 25.	Struktura e tokave punuese në ha në Komunën e Kaçanikut
Harta 26.	Struktura dhe shpërndarja e gjedheve në Komunën e Kaçanikut
Harta 27.	Shpërndarja e gjedheve, deleve-dhive dhe shpezëve në Komunën e Kaçanikut
Harta 28.	Shpërndarja e veprimtarive tregtare në Komunën e Kaçanikut
Harta 29.	Shpërndarja dhe struktura e industrisë në komunë
Harta 30.	Minierat dhe resurset tjera minerale
Harta 31.	Numri i të punësuarve në Komunën e Kaçanikut sipas vendbanimeve
Harta 32.	Të hyrat buxhetore (për familje) sipas vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut
Harta 33.	Rrjeti i rrugëve në Komunën e Kaçanikut
Harta 34.	Rrjeti hekurudhor në Komunën e Kaçanikut
Harta 35.	Rrjeti i rrugëve, urat dhe tunelet në Komunën e Kaçanikut
Harta 36.	Rrjeti energjetik
Harta 37.	Rrjeti i ujësjellësit
Harta 38.	Rrjeti i kanalizimit
Harta 39.	Antenat e telefonisë mobile
Harta 40.	Koncepti linear
Harta 41.	Koncepti monocentrik
Harta 42.	Koncepti i kombinuar linear dhe policentrit
Harta 43.	Strukturat zhvillimit hapësinor
Harta 44.	Strukturat hapësinore të zhvillimit ekonomik në Komunën e Kaçanikut
Harta 45.	Organizimi administrativ
Harta 46.	Shërbimet shëndetësore
Harta 47.	Trashëgimia kulturore dhe natyrore
Harta 48.	Rrjeti hekurudhor
Harta 49.	Rrjeti energjetik
Harta 50.	Struktura hapësinore në Komunën e Kaçaniku
Harta 51.	Ndërtimi në tokat e kategorisë II-IV-Doganaj
Harta 52.	Ndërtimi në tokat e kategorisë II-IV-Koxhaj
Harta 53.	Ndërtimi në tokat e kategorisë II-IV-Semajë
Harta 54.	Degradimi i tokës
Harta 55.	Sipërfaqet e rrezikuara
Harta 56.	Mbrojtja nga erozioni
Harta 57.	Objektet shkollore dhe shëndetësore të propozuara
Harta 58.	Rrjeti i ujësjellësit-të propozuar
Harta 59.	Shtrirja e rrjetit të kanalizimit-të propozuar

1. HYRJE

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka marrë vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Kaçanikut, në Shtator 2007. Me datën 05.11.2008 u nënshkrua kontrata me kohëzgjatje prej 8 muajve në mes K. K. Kaçaniku dhe **N. Sh. P. Data-GIS-consulting**.

Qëllimi i projektit - Qëllimi kryesor i këtij projekti është që komuna e Kaçanikut të ketë një plan zhvillimor komunal modern, efikas dhe të bazuar në norma e standarde evropiane. Ky projekt do të jetë në harmoni të plotë me objektivat e „Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor” si dhe harmonizim të plotë me Planin Hapësinor të Kosovës.

Plani Zhvillimor Komunal do të sigurojë një bazë për një zhvillim të qëndrueshëm për Komunën e Kaçanikut.

Zhvillimi i qëndrueshëm nuk nënkupton vetëm ruajtjen e mjedisit kryesor, por edhe shfrytëzimin e përkohshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe, balancimin e zhvillimeve hapësinore. Kjo do të thotë që të ri koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike, kështu që të kontribuojnë në balancimin e zhvillimeve hapësinore.

Plani zhvillimor është dokument, që hartohet për territorin e komunës së Kaçanikut për periudhën e ardhme kohore deri në vitin 2020 dhe jep udhëzime konkrete për veprimet që duhet të ndërmerren: Pse duhet ndërmarr ato veprime, po ashtu, sqaron se si duhet të realizohen veprimet e tilla?

Veprime këto që do të ndikonin në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës së Kaçanikut, duke ndikuar në ngritjen e kualitetit social, ekonomik dhe fizik të hapësirës përkatëse.

Plani Zhvillimor komunal jep mundësi të vazhdimësisë së planifikimit edhe për të ardhmen (pas periudhës së caktuar). Në dokumentin e planit merren vendime afatgjate, por gjithmonë duke pasur parasysh fleksibilitetin e planit, kur dihet se: në të ardhmen mund të paraqiten rrethana të reja që kërkojnë modifikime të vazhdueshme (kërkesat e ndryshme të popullsisë, ndryshimet në politikën qeveritare, parimet ndërkombëtare etj.).

PZHK sot orientohet kah procesi dhe veprimi, fillon me konsensus mbi çështjet, është seleksionuar dhe i fokusuar duke adresuar përparësitë dhe mangësitë. Është proces në të cilin përfshihet edhe ajo që është e paplanifikuar. Këtij procesi i paraprinë, një vizion realist dhe i qëndrueshëm. Me aprovimin e dokumentit, i cili do të jetë i hartuar përmes procesit të konsultimeve publike dhe, i bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, resurseve potenciale, duke identifikuar çështje apo fusha ku duhet ndërmarrë veprime urgjente, me qëllim të mbrojtjes, kultivimit dhe zhvillimit të vlerave socio-ekonomike dhe mjedisore të komunës së Kaçanikut.

Rezultat i përfundimit të Planit do të jetë informata përmbajtësore për gjendjen socio-ekonomike, demografike, të infrastrukturës, mjedisit etj. në Komunën e Kaçanikut. Në shtrirjen hapësinore të dukurive, do të duken qartë, caqet e zhvillimit të Komunës dhe, zonat me prioritet për intervenim nga do të rrjedhin propozimet për zhvillimin e ardhshëm hapësinor dhe, mënyrën se si do të arrihet ky zhvillim.

1.1. SISTEMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOSOVË

Sistemi i planifikimit në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor, nivelet e planifikimit në bazë të Nenit 9 ndahet në dy nivele

1. Planifikimi për territorin e Kosovës
2. Planifikimi për territorin e Komunave

Llojet e planeve në bazë të Nenit 10.2 Në nivel të Komunës do të ekzistoj:

1. Plani zhvillimor i komunës
2. Plani zhvillimor urban
3. Plani rregulativ urban


Në bazë nenit 13.1 Secila komunë është përgjegjëse për përgatitjen e Planit Zhvillimor të Komunës, i cili mbulon territorin e saj. Ky plan është strategjik dhe multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Plani zhvillimor i komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale të komunës.

Neni 13.2 komunat brenda të cilave ekzistojnë Zona të Veçanta të mbrojtura, implementojnë dispozitat e Ligjit për zona të Veçanta të mbrojtura gjatë hartimit të Planeve zhvillimore të Komunës.

PZHK bazohet në gjendjen ekzistuese sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe është proces gjithëpërfshirës, transparent me pjesëmarrje publike në vendimmarrje. Pjesëmarrja publike nënkupton involvimin e të gjithë faktorëve relevant në interes për Komunën: Drejtoritë komunale, Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, Institucionet shkencore dhe hulumtuese, Organizatat e shoqërisë civile, komunale etj.

Bazuar në kornizën logjike të aktivitetëve, ky proces planifikohet të zgjasë 8 muaj. Më poshtë është dhënë skema e mobilizimit institucional të pjesëmarrjes në procesin e hartimit të PZHK-së.

Skema 1. Skema e mobilizimit institucional



Plani Zhvillimor Komunal bazohet në:

- Parimet e përcaktuara me Ligj
- Vizionin dhe caqet strategjike
- Raportet e sektorëve të rëndësishëm
- Strategjitë zhvillimore të sektorëve të ndryshëm
- Elemente tjera të përcaktuara me akte të veçanta

Si i tillë, Plani përcakton, parimet dhe qëllimet afatgjate të planifikimit hapësinor për periudhën deri në vitin 2020. Gjithashtu përcakton afatet kohore reale dhe, implikimet buxhetore.

Korniza për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal përbëhet nga pesë faza:

Faza I -Përgatitja e profilit dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Faza II - Vizioni, Parimet dhe Caqet

Faza III - Korniza e Zhvillimit Hapësinor

Faza IV - Strategjitë dhe veprimet për zbatim

Faza V - Dispozitat për zbatim

- **Profili dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese** - Në këtë fazë evidentohet gjendja ekzistuese e zhvillimit hapësinor në tërë territorin e Komunës. Ky është dokumenti bazë për njohjen dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të zhvillimeve në hapësirë, si dhe, përcakton orientimet themelore për hartimin e PZHK -së
- **Vizioni, Parimet dhe Caqet** - Përfshin fazën e dyte ku përcaktohet vizioni për të ardhmen si dhe caqet strategjike të zhvillimit hapësinor të Komunës.
- **Korniza e Zhvillimit Hapësinor** - Kjo fazë përcakton parashikimet e dëshiruara të zhvillimeve afatgjata hapësinore për territorin e komunës.
- **Strategjitë dhe veprimet për zbatim** - Kjo fazë formulon pakon e strategjive dhe veprimet për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet kohore, implikimet financiare dhe, kornizën institucionale.
- **Dispozitat për zbatim** - Përfshin elementet e Zbatimit obligativ, që ndërlidhen me nivelin komunal.

Gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, struktura e projektit do të ndahet në katër fusha kryesore:

1. Popullsisë, çështjeve sociale, banimit dhe vendbanimet.
2. Mjedisit, përfshirë trashëgiminë kulturore, natyrore, peizazhet , etj.
3. Zhvillimin ekonomik, industrinë, turizmin, rekreacionin, tregtinë, bujqësinë etj;
4. Infrastruktura-transportit komunal, komunikimet, rrjeti i ujësjellësit,kanalizimit etj.

Pas përfundimit të të gjitha fazave të planit dhe gjatë realizimit të tërë aktivitetit planifikues, komuna do ti arrij këto rezultate:

1. Plani Zhvillimor Komunal (përgatitja e dokumentit final dhe pranimi i planit nga Kuvendi i Komunës) duke përfshirë edhe planin gjeneral të shfrytëzimit të tokës.
2. Rregullimi afatgjatë i zhvillimit hapësinorë dhe ekonomik i komunës së Kaçanikut duke u bazuar në koncepte të ndryshme të zhvillimit hapësinor.

3. Bashkëpunimi i ngushtë dhe trajnimi i stafit të qeverisë lokale gjatë hartimit të Planit zhvillimor komunal, si dhe, do tu mundësohet atyre për të vazhduar detyrimet dhe përgjegjësit të cilat dalin nga plani zhvillimor komunal.
4. Trajnimi i stafit të selektuar nga komuna në GIS, i cili do të ofroj njohuri të mira në GIS, si dhe, do të jetë ndihmë e madhe në implementimin e projektit.
 - ✓ Paketën e GIS softverit (me të cilën kompania e realizon projektin) komuna mund ta propozoj, ndërsa kompania Data GISconsulting do ta siguroj brenda ofertës së vet solucionin e MapInfos v. 8.0.
5. Ofrimin e konceptit për GIS infrastrukturë dhe menaxhimin e të dhënave me GIS.

I.2. PËRFITUESIT E PROJEKTIT

Ky projekt është gjithëpërfshirës dhe shumë dimensional. Andaj, përftimet janë shumë të rëndësishme nga fakti se do të planifikohet një zhvillim i përgjithshëm në përputhje të plot me interesat e qytetareve të komunës së Kaçanikut. Projekti, gjithashtu do të jetë në harmoni të plotë me politikën e zhvillimit dhe mbrojtës që ka Qeveria e Republikës së Kosovës dhe vet Qeveria lokale, e që do të jenë në harmoni të plotë edhe me qëllimin e politikave të Unionit Evropian.

Perspektiva evropiane e zhvillimit hapësinor është e orientuar drejt një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm të territorit të vet Unionit Evropian.

Ministrat përgjegjës për Planifikimin Hapësinor në Shtetet Anëtare të Unionit Evropian dhe anëtari i Komisionit Evropian, përgjegjës për Politikën Regjionale, theksuan në Potsdam se: qëllimi i politikave të zhvillimit hapësinor është që të punohet drejt një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm të territorit të Unionit Evropian. Sipas pikëpamjes së Ministrave, është e rëndësishme që të arrihen barabar tri qëllimet fundamentale të politikës evropiane në të gjitha regjionet e UE-së:

- ✓ Kohezioni ekonomik dhe social;
- ✓ Ruajtja dhe menaxhimi i resurseve natyrore dhe i trashëgimisë kulturore;
- ✓ Konkurrencë më e balancuar e territorit evropian.

Në përputhje me këto politika, është edhe Plani hapësinor i Kosovës, që ka për synim arritjen e një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm. Harmonizimi i politikave të tilla zhvillimore ka një rol të rëndësishëm edhe për Komunën e Kaçanikut, e cila gjatë këtij procesi, do të arrij të krijoj një bazë të mirë të planifikimit hapësinor në përputhje me këto politika.

Plani Zhvillimor Komunal që do të hartohet në përputhje të plotë me interesat e qytetarëve të komunës Kaçanikut dhe që do të bëhet në harmoni me politikën e zhvillimit hapësinor të Kosovës dhe, të Unionit Evropian, paraqet një përfitim real dhe afatgjatë për të ardhmen e komunës. Në këtë kontekst, përfituesit kryesor të këtij projekti do të jenë: KK Kaçaniku, Institucionet e Kosovës, komuniteti, sektori shoqëror, sektori privat, OJQ-të, grupet e interesit etj.

1.3. BURIMI I TË DHËNAVE PËR HARTIMIN E PROFILIT KOMUNAL

Mbledhja e të dhënave si bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal është element i domosdoshëm. Gjatë hartimit të profilit komunal si dhe për vlerësimin i gjendjes ekzistuese janë shfrytëzuar burime dhe metoda të ndryshme për grumbullimin, sistemimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme. Grumbullimi i të dhënave është bërë nga strukturat komunale të Kaçanikut dhe stafi i kompanisë përmes një bashkëpunimi të ngushtë mes grupeve punuese.

Të dhënat bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal janë shfrytëzuar nga burime të ndryshme:

- Të dhënat zyrtare nga sektorët e Qeverisë Komunale – plotësimi i veglave të punës.
- Regjistrimi i popullsisë që është realizuar në vitin 2009 nga komuna e Kaçanikut dhe kompania DataGIS Consulting.
- Të dhënat nga zyrat komunale dhe regionale të Qeverisë së Kosovës (Zyra e Punës dhe punësimit, Zyra për mirëqenie sociale, ESK etj).
- Të dhënat nga sektorë të ndryshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Të dhënat nga kompanitë publike komunale.
- Parcelat kadastrale – zyra komunale për Kadastër.
- Hartat topografike: 1: 50 000, 1:25 000
- Orto-fotot (prodhim: viti 2000 dhe 2004) - zyra komunale për Kadastër.
- Puna në terren(ekipet e kompanisë kanë vizituar të gjitha vendbanimet e komunës).
- Aplikimi i GIS dhe GPS
- Literatura shkencore.

Në vazhdimësi të procesit të hartimit të planit, do të grumbullohen të dhëna të reja dhe të rëndësishme, që do të inkorporohen në dokumentin e profilit. Kjo nënkupton plotësimin e profilit me të dhëna të reja në të ardhmen deri në përfundimin e projektit.

1.4. ROLI DHE NATYRA E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

a) Promovon interesat e përbashkëta të popullatës në katër fushat kryesore:

- Zhvillim social
- Mjedis dhe shfrytëzim të tokës
- Zhvillim ekonomik dhe
- Infrastrukturë

b) Plani Zhvillimor Komunal duhet të:

- Mundësojë që, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, të përcaktojë kahet e zhvillimit social, shfrytëzimin mjedisor, mbrojtjes mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe infrastrukturë për qasje dhe lidhje më të mirë, e mbi të gjitha rritjen e kualitetit të jetesës.
- Ndikojë në vendimet politike, lidhur me investimet publike në infrastrukturë, për t'i përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve;
- Përkrahë zhvillimin e balancuar në mes të zonave urbane dhe zonave rurale me zhvillim ekonomik më të ulët;
- Të jetë udhëzues në hartimin e Planit Zhvillimor Urban

- Identifikojë lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të komunës;
- Aprovojë vendimet lidhur me zonat e industrisë dhe biznesit, banimit, shërbimeve, turizmit dhe trashëgimisë natyrore e kulturore;
- Identifikojë rolin e zonave kryesore në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik dhe kulturor të komunës.

c) Roli i qeverisë lokale - Qeverisja, si vendimmarrëse dhe implementuese e vendimeve të marruara, duke u mbështetur në parimet kryesore

- Pjesëmarrja publike;
- Sundimi i ligjit;
- Transparenca;
- Përgjegjësia;
- Konsensusi;
- Barazia dhe gjithë përfshirja;
- Efikasiteti dhe
- Llogaridhënia

2. ROLI I PJESËMARRËSVE

Në respektim të parimeve ndërkombëtare të rekomanduara me ligj, e posaçërisht të Agjendës 21 dhe Agjendës së UN-HABITAT, procesi tenton të përfshijë një numër sa më të madh të pjesëmarrësve në fazën përgatitore për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, në mënyrë që parimet e gjithë-përfshirjes, transparencës, efikasitetit, barazisë dhe qëndrueshmërisë, të promovohen dhe zbatohen në praktikë nga Komuna.

Në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal është plan multi-sektorial, i cili merr parasysh zhvillimet e sektorëve që menaxhohen nga komuna, involvimi, i të gjithë pjesëmarrësve të cilët mund të kenë ndikim ose të jenë të ndikuar nga plani esencial për të zbatuar parimet e pjesëmarrjes publike dhe transparencës së procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

2.1. ROLET-VENDIMMARRËSE /JO VENDIMMARRËSE

Roli në vendim - marrje përveç qeverisë lokale duhet të jetë transparent edhe për pjesëmarrësit e tjerë në proces siç janë shoqëria civile, sektori privat, OJQ, shoqatat e ndryshme të fermerëve, bletarëve, ekspertëve të pa varur, e institucioneve të ndryshme që involvohen në proces të planifikimit.

Pjesëmarrësit nga niveli qendror, përfaqësues të ministrive të Qeverisë së Kosovës – me të dhënat, raportet dhe strategjitë e sektorëve përkatës e plotësojnë përmbajtjen e dokumentit

Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave rrjedhin nga sektori jo-qeveritar, analizat dhe raportet e të cilëve në të shumtën e rasteve kanë shërbyer për krahasim, e në disa raste edhe si të vetmet burime të të dhënave.

2.2. QEVERISJA KOMUNALE

Pas përfundimit të Luftës në qershor të vitit 1999 Kosova hyn nën administrimin ndërkombëtar të Kombëve të Bashkuara. UNMIK-u shtri ndikimin e vet edhe në

qeverisjen lokale, ku sipas Nenit 3 të Rregullores së vet Nr. 2000/45, komunave ju ndanë rolet dhe përgjegjësitë, si dhe, rolin në ofrimin e kushteve themelore bazike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Procesi i decentralizimit në Kosovë qartëson edhe kompetencat për vetëqeverisje lokale. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 ,kreu III, Kompetencat komunale, Neni 15 Parimi i subsidiaritetit – Komunitet ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit dhe, Neni 16 – Komunitet ushtron kompetenca vetjake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin si dhe Neni 17 –Komunitet ka kompetenca te plota dhe ekzekutive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjisllacionin e zbatueshëm në, fushat që vijojnë:

- a. Zhvillimi ekonomik lokal
- b. Planifikimi urban dhe rural
- c. Shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimi
- d. Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit
- e. Mbrojtjen e mjedisit lokal
- f. Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizim dhe drenazhim, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale.
- g. Përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale
- h. Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit.
- i. Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- j. Ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor
- k. Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijnor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshi regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale.
- l. Banimi publik
- m. Shëndetësinë publike
- n. Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë.
- o. Emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike
- p. Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike
- q. Turizmit
- r. Aktivitete kulturore dhe të lira
- s. Çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetencat e tyre, apo që nuk i është pacaktuar një autoriteti tjetër

Neni 18 kompetencat e deleguara pika 18.1 pika f)

Neni 28 bashkëpunimi ndërmjet komunave të Republikës së Kosovës

Ky ligj na obligon lidhshmërinë e PZHK –së dhe PZHU-së

Organet kryesore udhëheqëse komunale janë: Kuvendi që është organi më i lartë në komunë me 27 delegatë komunal dhe, Kryetari që kryen udhëheqjen komunale të ekzekutivit dhe Nënkryetari i Komunës.

Komitetet apo grupet e deputeteve:

- Komiteti për Politikë dhe Financa;
- Komiteti për Komunitete;

Drejtoritë komunale në Komunën e Kaçanikut:

1. Drejtoria për Administratë,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim,
3. Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike,
4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,
5. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
6. Drejtoria e Shëndetësisë, Mirëqenies sociale,
7. Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Kulturës,

2.3. NDARJA ADMINISTRATIVE DHE QEVERISJA E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Komuna e Kaçanikut zë sipërfaqen prej 211.40 km². Gjatësia e vijës kufitare e komunës është 101.4 km dhe kufizohet me Komunën e Ferizajt me gjatësi kufitare 20,05 km, me Komunën e Vitisë 27,10 km, me Republikën e Maqedonisë (JL) 6,62 km, me Komunën e Shtërpçës 12.88 km, Hani i Elezit 23,34 km dhe me Republikën e Maqedonisë (JP) 11,42 km.

Komuna kadastrale e Kaçanikut është e ndarë në 29 zona kadastrale dhe përfshin 31 vendbanime.


Statusi i Komunës :Neni 13.

Komuna e Kaçanikut është e përbërë prej këtyre fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Tabela 1. Vendbanimet në Komunën e Kaçanikut

Nr.	Vendbanimi	Nr.	Vendbanimi
1	Bajnicë	17	Kaçanik i Vjetër
2	Begracë	18	Korbliq
3	Biçec	19	Kotlinë
4	Bob	20	Kovaçec
5	Doganaj	21	Koxhaj
6	Drenogllavë	22	Nikaj
7	Dubravë	23	Nikoc
8	Duraj	24	Rekë
9	Elezaj	25	Runjevë
10	Gabricë	26	Semajë
11	Gajre	27	Sllatinë
12	Gërlinë e Epërme	28	Soponicë
13	Gjurgjedell	29	Stagovë
14	Gllaboçicë	30	Strazhë
15	Ivajë	31	Vatë
16	Kaçanik - Llanishtë		

Harta 1. Vendbanimet e komunës



Pjesëmarrës kyç në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Grupet punuese nga kompania:

1. Menaxher i projektit – Prof. Dr. Sc. Ibrahim Ramadani, Urbanist
2. Udhëheqësit e grupeve punuese:
 - a. Popullsia dhe zhvillimi social – Mr. Hazer Dana, demograf -planer
 - b. Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës – Prof. Dr. Sc. Gani Gashi
 - c. Zhvillimi ekonomik –Riza Murseli, gjeograf
 - d. Infrastruktura –Tomor Qela, GIS ekspert
3. Stafi profesional:
 - a. Dr. Sc. Shpejtim Bulliqi, Gjeomorfolog
 - b. Dr. Burbuqe Nushi-Latifi , specialist i shëndetit publik
 - c. Bajram Kafexholli, GIS ekspert
 - d. Hasim Kryeziu / GIS ekspert
 - e. Luljeta Krasniqi, ekonomiste
 - f. Mr. Sc. Ecc. Mic Avdullahu
 - g. Ramush Aliu, Ing. ndert.
 - h. Izjah Celaj, Prof. lektor

Pjesëmarrës kyç në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal nga K. Kaçanikut

Mbikëqyrësi i projektit nga K.K Kaçanik:

1. Bekim Troni – 044-945-923- bekim.troni@ks-gov.net
2. Fatos Koxha - 044-225-123 - fatos.koxha@hotmail.com

Grupet punuese:

1. Demografia dhe çështjet social

1. Avni Krasniqi	gjeograf	udhëheqës i grupit
2. Danush Koxha	gjeograf	anëtar
3. Hamzë Berisha	jurist	anëtar
4. Fadil Qallaku	ekonomist	anëtar
5. Xhelal Dema	ekonomist	anëtar
6. Avdi Vërbani	sociolog	anëtar
7. Vebi Koraqi	gjeometër	anëtar
8. Hajrush Dullovi	kimist	anëtar

2. Zhvillimi ekonomik

1. Kefsere Koxha	ekonomiste	udhëheqëse e grupit
2. Ibrahim Gjini	ekonomist	anëtar
3. Zylfi Koxha	agronom	anëtar
4. Çlirim Troni	ekonomist	anëtar
5. Remzi Hoxha	ekonomist	anëtar

3. Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës

1. Bujar Dullovi	gjeograf	udhëheqës i grupit
------------------	----------	--------------------

2. Afrim Fuga	ndërtimtar	anëtar
3. Shefket Koxha	ekonomist	anëtar
4. Rami Çaka	gjeolog	anëtar
5. Besnik Bajra	biokimist	anëtar
6. Zekirja Koxha	agronom	anëtar
7. Enver Zharku	kimi-biologji	anëtar

4. Infrastruktura

1. Fatos Koxha	ndërtimtar	udhëheqës i grupit
2. Hajredin Shehu	ndërtimtar	anëtar
3. Jehona Hoxha	arkitekte	anëtar
4. Imer Vlashi	gjeometër	anëtar
5. Izahir Kuka	ndërtimtar	anëtar
6. Faik Muqa	teknik i ndërtim.	anëtar
7. Mendu Krasniqi	ing.i makinerisë	anëtar
8. Muharrem Leka	jurist	anëtar
9. Xhelal Dema	ekonomist	anëtar

Udhëheqës i grupeve punuese nga Kuvendi Komunal Kaçanik:

1. Kefsere Koxha, Kryetar,
2. Ibrahim Xhini, anëtar

Këshilli i ekspertëve:

Emri Mbiemri	Profesioni
Agim Vishi	Ekonomist
Zajrete Muhagjeri	Juriste
Arxhent Brruti	Ekonomist
Skender Kuka	Arkitekt
Ibrahim Hoxha	Ndërtimtar
Remzi Çaka	Fizikant

Shoqatat jo qeveritare/OIQ, Komuniteti i biznesit, Shoqatat e dalura nga lufta e UÇK-ës:

1. OVL i UÇK-së
2. SHIL e UÇK-së,
3. Shoqata e familjeve të dëshmorëve
4. Shoqata për persona të zhdukur,
5. HANDIKOS,

6. KLMDNJ,
7. Shoqata e Gruas,
8. Kryqi i Kuq, ,
9. Klubi i Gazetarëve ,
10. Shoqata e Gjuetarëve "DRENI"
11. Shoqata e peshkatarëve,

Shkollat fillore dhe të Mesme:

1. Sh.F. "Emin Duraku", Kaçanik,
2. Sh.F. "Kadri Zeka", Dubravë,
3. Sh.F. "Idriz Seferi" Bob,
4. Sh.F. "Jusuf Gërvalla",
5. Sh.F. "Ali Asllani",
6. Sh.F. "Qamil Ilazi", Kaçanik i Vjetër,
7. Sh.F. "7 Shtatori", Begracë,
8. Sh.F. "K. i Manastirit", Glloboqicë,
9. Sh.F. "Dituria", Ivajë,
10. Sh.F. "Iliria", Stagovë,
11. Sh.F. "Naim Frashëri",
12. Sh.F. "Nazmi Osmani", Elezaj,
13. Gjimnazi "Skenderbeu", Kaçanik
14. Sh.M. P. " Vëllezërit Çaka&Feriz Guri", Bob

Drejtorët e Shërbimeve Komunale:

1. Enver Zharku, Drejtor i KRUK " BIFURKACIONI" , 044-368-125,
2. Ferat Malsiu, Drejtor i NPRM "PASTERTIA", 044-224-807,
3. Sylejman Selmani, Përgjegjës PTK, Njësia Kaçanik,
4. Lulzim Raka, Përgjegjës KEK, Njësia Kaçanik,
5. Ylber Shehu, Përgjegjës, 044-224-812
6. Jaser Jaha, Ushtrues Detyre Komandanti Stacionit Policor, 044-543-755
7. Ramadan Luzha, Drejtori i Qendrës për Punë Sociale, 044-224-919
8. Zyra Regjionale e Pylltarisë

Administratorët Lokal:

Nr.	Emri e mbiemri	Lokaliteti
1.	Zekirja Loku	Kaçanik
2.	Raif Dema	Bob
3.	Faik Muça	Kovaçec
4.	Shabi Dullovi	Biçec
5.	Xhevat Guri	Nikaj
6.	Zekirja Baftiu	Dubravë
7.	Kemal Murseli	Dogana
8.	Danush Koxha	Koxhaj
9.	Hasim Vogliqi	Gërlicë
10.	Mexhid Hasaj	Gabrricë
11.	Murat Rexhepi	Bajnicë
12.	Elez Prushi	Prushaj
13.	Rexhep Salihu	Duraj
14.	Ramadush Osmani	Elezaj
15.	Arif Gashi	Begracë
16.	Bislim Krasniqi	Kaçanik i Vjetër
17.	Kemal Jaha	Stagovë
18.	Muhamet Mulaku	Gajre
19.	Xhevahir Livoreka	Ivajë
20.	Shaban Kuçi	Kotlinë
21.	Mustafë Lika	Shtrazë
22.	Zimer Luma	Gllloboçicë
23.	Xhavit Dubova	Drenogllavë
24.	Hysni Bela	Gjurgjedell
25.	Abedin Axhami	Llanishtë
26.	Hisen Shorra	Sllatinë
27.	Fatmir Hasani	Semajë
28.	Ramadan Runjeva	Runevë
29.	Afrim Demnika	Soponicë
30.	Qamil Samakova (Muharremi)	Korbliq

“PROFILI DHE VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE”

FAZA E PARË

I. PROFILI ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Profili i gjendjes ekzistuese, do të realizohet përmes sigurimit dhe dokumentimit të informacioneve konkrete në lidhje me territorin komunal të Kaçanikut. Gjendja ekzistuese do të hulumtohet në sfera të ndryshme me qëllim të inkorporimit të, të gjitha elementeve hapësinore. Për këtë qëllim, në këtë fazë, formohen grupe punuese, që do të punojnë në fusha të ndryshme (p.sh. Popullsia, zhvillimi social, mjedisi, shfrytëzimi i tokës, zhvillimi ekonomik, infrastruktura etj). Pra, qëllimi është që të grumbullohen sa më shumë informata të nevojshme për fusha ndër më të ndryshmet, sepse kjo fazë përbën një bazë të rëndësishme të procesit të Planit Zhvillimor Komunal. Kjo për faktin se duke e ditur gjendjen aktuale në hapësirë, më lehtë mund të planifikohen zhvillimet e ardhshme. Në bazë të hulumtimeve dhe konsultimeve që do të realizohen për paraqitjen e gjendjes ekzistuese, në sektor dhe fusha të ndryshme tematike, duhet të identifikohen të gjitha problemet dhe çështjet që ekzistojnë në hapësirë.

Përcaktimi i çështjeve do të shërbej si bazë e mirë për hapat e mëtejme të procesit, duke planifikuar vazhdimisht të gjitha mundësitë e zgjidhjes së tyre. Profili përfshin këto elemente dhe, gjatë punës mund të evidentohen edhe fusha të tjera.

I.1. HISTORIKU I KOMUNËS

Kaçaniku me rrethinë janë vendbanime të banuara në kohët e lashta. Këtë e dokumentojnë mjaft burime arkeologjike edhe pse shumica janë dëmtuar. Gjurmët më të zakonshme janë themelet e kalave, varrezat, tjegullat, si dhe emërtimet e ndryshme. Në Kotlinë janë gjetur gërmadhat e vendbanimi të fortifikuar, pjesë armësh, një altar me mbishkrim i cili mendohet se tako shek. III dhe i takojnë periudhës ilire-romake. Gjurmë të njëjta ekzistojnë edhe mes fshatit Llanishtë dhe Gjurgjedell.

Kjo hapësirë në kohën e ilirëve ishte pjesë e Dardanisë. Dokumente arkeologjike të kësaj periudhe hasen në Bob, Sllatinë, Gllaboçicë, Gjurgjedell, Kotlinë, Kaçanik i Vjetër, Doganaj etj. Në vitin 395 kjo trevë bie nën sundimin e perandorisë Bizantine që zgjati deri kah mesi shek. IX. Kah fundi i shek XII sllavët depërtuan në këto pjesë, ndërsa Stefan Dushani pushtoi Maqedoninë, Shqipërinë dhe Thesalinë, ndërsa rezidencë e bëri Prizrenin. Nga kjo kohë fillon ndërrimi i toponimeve dhe përvetësimi i kishave katolike shqiptare. Në shek. e XIV turqit osmanë ia mësynë Ballkanit, mendohet se Kaçaniku u pushtua diku kah viti 1392 dhe sipas defterëve turq ishte si nahi e Vilajetit të Shkupit. Popullata e vendbanimeve të kësaj nahije ishin të regjistruar si „derbexhinj“, që do të thotë se kishin për detyrë sigurimin e rrugëve që ju lehtësonte tatimet. Kah fundi i shek. XVI Kaçaniku kishte arritur të formohej si qytezë. Në vitin 1595 Koxha Sinan Pasha e ndërtoi xhaminë që ekziston edhe sot, njëkohësisht kishte kuzhinë publike, dy hane dhe një hamam. Kalaja që ekziston edhe tani është ndërtuar gjatë shekujve XIV-XVI. Gjatë sundimit turk në vitin 1689 njihet lufta austro-turke, austriakët pushtuan Nishin, pastaj Prishtinën dhe Kaçanikun. Në këtë luftë kishte marr pjesë popullata lokale që kishte ndihmuar austriakët. Në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare që kishte filluar në fillim të shek XIX kishte marrë pjesë edhe popullata e kësaj ane. Ndërsa nga shpërngulja e dhunshme e vitit 1878 nga Sanxhaku i Nishit një pjesë e vogël e muhaxhirëve ishte e vendosur

edhe në këtë trevë si në Kaçanik të Vjetër, Kaçanik, Gajre, Gjurgjedell etj. Në vitin 1873 ndërtohet hekurudha Prishtinë-Shkup që në këtë qytet solli zhvillimin e tregtisë. Aspiratat për pavarësi u përcollën me kryengritje, ndërsa Kuvendi i mbajtur në Ferizaj me 20 korrik 1908 u përkrah pa rezerve nga popullata e kësaj ane. Është e njohur beteja e Kaçanikut me 1910 e udhëhequr nga patrioti Idriz Seferi. Pasi e pushtuan grykën ata morën pjesë edhe në çlirimin e Shkupit.

Gjate sundimit osman ekonomia kryesore ka qenë blegtoria, vreshtaria, pemëtaria e më pak lavërtaria në mungesë të tokës. Uji i lumit Lepenc ka shërbye si bazë e mirë që kjo anë të ketë mjaft mullinj me ujë për bluarjen e drithërave.

Pas dobësimit dhe përfundimisht tërheqjes së pushtetit osman më 1912 këto treva i okupoi Serbia dhe Mali i Zi. Okupimi i ri u përcjell me shume vrasje djegie të vendbanime dhe shpërngulje të popullatës. Që nga kjo kohë shumë shqiptarë nga kjo anë morën rrugën e emigrimit për në Turqi për mos tu kthyer më kurrë në vatrën e tyre.

Gjatë Luftës së Parë Botërore (26 tetor 1915) kjo trevë ishte nën okupimin bullgar të cilët poashtu djegën fshatra, vranë popullatë vendase e deri te internimet.

Në vitin 1918 u bë ripushtimi serb e cili më vonë filloi me konfiskimin e tokave shqiptare duke iu dhënë kolonëve serb të cilët i kishte sjellë për ndërrimin e strukturës etnike. Rezistenca shqiptare ishte e manifestuar me lëvizjen kaçake (ka ekzistua edhe me herët) e cila i kishte përfshi edhe këtë trevë. Sipas burimeve Kurtesh Durra ditën ishte Kryetar Komune e natën ishte kaçak i cili u vra nga xhandarmeria. Kaçak tjerë ishin Avdyll Dura, Zymer e Ramadan Gërlica, Xhemajl Bekteshi etj¹

Gjatë Luftës së Dytë Botërore territori i Kosovës u nda në tri pjesë, ndërsa hapësira e Kaçanikut u vu nën administrimin bullgar. Në vitin 1941 është ndërtuar hekurudha me binarë të ngushtë për transportin e xeheve së kromit Kaçanik-Vorboshticë. Me mbarimin luftës njësitë partizane kishin marrë fushatën të ashpra të dhunës. Ndërsa në gjoja mobilizimin e popullatës ata i drejtuan drejt masakrës së Tivarit, kishte edhe pjesëtar nga Kaçaniku me rrethinë. Në kanalën e Trogirit ranë 29 martirë nga kjo anë. Gjatë periudhës 1943-63 për shkak të aktiviteteve që nuk ishin në frymën e PKJ-së janë gjykuar 26 e disa prej tyre edhe me pushkatim (rreth 33 vetë). Nuk ka munguar dhuna shtetërore as në periudhën e Rankoviçit dhe në demostartat e vitit 1981 e 1989. Pas ndërrimeve kushtetuese të vitit 1974 vërehet një prosperitet ekonomik ku u hapën disa fabrika.

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës me 28 mars 1989 shqiptarët u organizuan dhe me 2 korrik 1990 shpallën deklaratën kushtetuese për pavarësinë e Kosovës. Me 7 shtator 1990 Kuvendi i Kosovës në Kaçanik miratoi Kushtetutën e Kosovës e njohur si „Kushtetuta e Kaçanikut”.

Në luftën kundër okupatorit në këto anë ishin formua celulata e para të UÇK-së të cilat më vonë u zgjeruan. Kështu me vendimet e Shtabit të Përgjithshëm Nënzona e Nerodimes dhe Njësitë i Kaçanikut u ngritën në nivel zone dhe brigade. Pas vrasjes së komandantit Agim Bajrami e merr emrin e tij, Brigada 162 „Agim Bajrami”. U

¹ Dr. Liman Rushiti, Kujtime për lëvizjen kaçake, Prishtinë 2003, faqe 58-68.

zhvilluan shumë beteja si edhe ajo e vrasjes së komandantit të policisë serbe në fshatin Gajre, e cila pat bërë bujë në mjetet e informimit².

Gjatë kësaj periudhe dhe gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s popullata ka pësuar mjaft humbje. Kështu ndodhi masakra e fshatit Kotlinë dhe ajo e Kaçanikut te përroi i Rakocit. Kjo anë për shkak të pozitës strategjike ka pasur edhe koncentrim më të madh të forcave serbe. Janë kontrolluar rrugët me Maqedoninë dhe dëbimin e popullatës nga trevat e Kosovës. Njëkohësisht ka pas edhe shumë dëme materiale. Kaçaniku është ngritë si qytet për shkak pozitës së tij gjeostrategjike për të kontrolluar rrugë që hynë nëpër grykë.

Popullata e kësaj komune është shpërngul në shumë vendbanime të Maqedonisë dhe në Turqi ndërsa në periudhën e 1990-1999 edhe nëpër Evropë.

Komuna e Kaçanikut deri në vitin 2006 e ka përfshi Hanin e Elezit dhe disa vendbanime rreth tij. Që nga ky vit është formuar komuna e Hanit të Elezit dhe sipërfaqja e saj është zvogëluar.

Emri i Kaçanikut është i vjetër dhe në defterët osman haset si "Kaçanikler", domethënia tij në literaturën shqipe sqarohet si vend me kaça³. Sipas defterëve osman në periudhën 1873-1912, Kaçaniku emërtohej me emrin „Orhanie”⁴. Me që popullata vendase gjatë pushtimit Osman ka pasur status të derbegjinjëve, kanë shërbye në sigurimin e rrugëve që nënkupton se kaçakët kanë ekzistuar herët. Lëvizja kaçake njihet prej shek XVI që ka pasur karakter ekonomik më vonë kalon merr karakter politik⁵. Mbetet si opsion që ndoshta emri i Kaçanikut lidhet me këtë lëvizje.

I.2. POZITA GJEOGRAFIKE, KUFINJËT, MADHËSIA, DHE MIKROPOZITA E KAÇANIKUT

Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunat Ferizaj në veri, Vitinë në verilindje, Shtërpçën në perëndim dhe Hanin e Elezit në jug. Mirëpo kjo komunë edhe pse nuk përfshin ekstremën jugor kufizohet edhe me Maqedoninë në juglindje e në perëndim. Gjatësia e vijës totale kufitare është 101.41 km dhe sipërfaqe prej 211.40 km². Kufiri komunal shtrihet në pjesë kryesisht malore, vetëm në pjesën veriore të komunës shtrihet në pjesën jugore të fushëgropës së Kosovës që shtrihet terren të ultë. Gjatësia e vijës kufitare me Ferizajin përfshinë 20.05 km dhe fillon më lartësi mbidetare 980 m në perëndim dhe lëshohet në fundin e fushëgropës së Kosovës deri në lartësi 570m. Në lindje kalon në luginën e Moravës së Binçës ku kufiri përfundon me Komunën e Ferizajit dhe fillon me Komunën e Vitisë. Me Komunën e Vitisë gjatësia e kufirit është 27,10 km dhe ka drejtim jugor dhe juglindor. Kufiri këtu nga fundi i luginës së Moravës ngritët rrëzë maleve të Karadakut dhe përfundon në këto male në lartësi mbidetare rreth 960m. Nga kjo pikë kufiri komunal njëkohësisht është edhe kufi shtetëror me drejtim të shtrirjes kah jugperëndim dhe ka gjatësi 6,62 km. Në këtë pjesë kufiri tërësisht ka karakter malor. Me Komunën e Hanit të Elezit gjatësia e kufirit është 23,34 km, ka shtrirje jugperëndim dhe kalon nëpër terren të theksuar malor. Kaçaniku prapë kufizohet me

² Jusuf Osmani Vendbanimet e Kosovës, Kaçaniku, Prishtine 2004

³ Dr. Mehmet Halimi, Vështrime Gjuhësore, Prishtinë 1993

⁴ Dr. Jusuf Osmani Vendbanimet e Kosovës, Kaçaniku, Prishtine 2004

⁵ Dr. Liman Rushiti, Kujtime për lëvizjen kaçake, Prishtinë 2003

Republikën e Maqedonisë në gjatësi 11,42 km. Këtu ndodhet kalimi kufitar Glloboçica dhe me tutje ngritët në malet e Sharrit deri te Maja e Lypetenit. Me Komunën e Shtërpçës gjatësia është 12.88km që kufizohet në anën perëndimore. Kalon tërësisht në terren malore dhe mund të thuhet se kjo pjesë ka lartësinë më të madhe mbidetare.

Tabela 2. Gjatësia e vijës kufitare në Komunën e Kaçanikut

Kufizimi me Komunën, shtetin	Gjatësia	Përqindja
Ferizaj	20,05	19.77
Vitia	27,10	26.72
Maqedonia JL	6,62	6,52
Hani i Elezit	23,34	23,00
Maqedonia JP	11,42	11,26
Shtërpca	12,88	12.74
Gjithsej	101.41	100

Gjatësia e pikave ekstreme më të largëta në territorin e komunës është 22,3 km në mes fshatrave Sllatinë në perëndim dhe Korbliq në lindje, vijë që gati se përputhet me drejtimin e paralelit. Edhe në drejtim veri-jug dallimet nuk janë aq të theksuara. Forma e sipërfaqes së komunës nuk ka ndonjë formë të rregullt por është mjaft e thyer. Lakueshmëria e vijës kufitare e shprehur në koeficient ka vlerën 1,7 që tregon se vija kufitare komunale ka gjatësi për 1,7 here më të madhe se perimetri i rrethit me të njëjtën sipërfaqe.

Harta 2. Pozita e komunës së Kaçanikut në Kosovë



Komuna e Kaçanikut ka mikropozitë relativisht të mirë gjeografike ngase ka lidhje të mira dhe funksionale me qendrat përreth. Ndodhet afër kryeqendrës-Prishtinës, në largësi 58 km, nga Ferizaji 21 km, Gjilani 45 km dhe me Shkupin e ndan distanca 30 km. Pozita e qendrës komunale ndaj vendbanimeve të komunës është pjesërisht e mirë ngase ndodhet pothuajse në qendër të sipërfaqes dhe nuk i ndajnë distanca të largëta. Relievi i shprehur malorë ndikon në shtrirjen e rrugëve dhe vështirëson lidhjen e vendbanimeve me qendrën komunale. Fshatrat Korbliq, Drenogllavë, Nikoc, Glloboçicë, Kotlinë, Ivajë, Sllatinë, nuk mund të thuhet që kanë lidhje të mira me qendrën komunale. Për shkak të lidhjeve komunikative disa fshatra shërbimet e tyre i përmbushin në qendrat përreth që janë më afër, ndërsa me qendrën komunale komunikojnë vetëm për çështje administrative. Buxheti komunal i kufizuar, varfëria e popullatës dhe kushtet klimatike gjatë dimrit e bëjnë edhe më të ndërlikuar komunikimin.

Komuna e Kaçanikut ka makropozitë të volitshme gjeografike. Nëpër këtë territor kalonin rrugë të vjetra. Këtu edhe tani kalon rruga nacionale Prishtine-Shkup që shtrihet edhe në vet qytetin e Kaçanikut. Përmes këtij korridori lidhet kah juglindja me Maqedoninë dhe më tutje me rrugët ndërkombëtare si nga jugu, veriu, e njashtu edhe me lindjen. Kjo vijë komunikative ka rëndësi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmes saj hynë pjesa më e madhe e mallrave në Kosovë. Kah veriu përmes rrugës nacionale lidhet me korridoret tjera që shkojnë në drejtim të Adriatikut dhe veriperëndimit.

Lidhje tjetër që funksionon është ajo Gllloboçicë-Tetovë që e lidhë me Pollogun në Maqedoni dhe me Maqedoninë perëndimore. Njëkohësisht këtu është edhe kalimi kufitar me këtë republikë që kalojnë mallra dhe njerëz. Në vitin 1873 u ndërtua hekurudha që kalonte përmes qytetit të Kaçanikut. Këtu kalonte vija ndërkombëtare hekurudhore Athinë-Shkup-Prishtinë-Beograd-Zagreb-Mynhen. Deceniet e fundit komunikacioni hekurudhor ka ngec për shkak të konflikteve dhe është humb kjo vijë e rëndësishme. Kushtet natyrore përkatësisht lugina e lumit Lepenc ka ndikuar që kjo komunë të ketë lidhje të mira që e avancojnë pozitën e saj gjeografike .

I.3. ZHVILLIMI DEMOGRAFIK I KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Zhvillimi demografik është një fushë mjaft komplekse dhe me rëndësi të veçanet për planifikim dhe zhvillimin e përgjithshëm të një vendi. Në përgjithësi i tërë planifikimi për një zhvillim të qëndrueshëm bëhet për njerëzit dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës së tyre në vendin ku ata jetojnë. Analiza e faktorëve bazë të zhvillimit demografik është një kusht i domosdoshëm në procesin e planifikimit. Bazuar në rrjedhën e zhvillimit të komponentëve të zhvillimit demografik më realisht mund të planifikohen kërkesat dhe nevojat e shoqërisë për të tashmen dhe të ardhmen.


Të dhënat për numrin e popullsisë kryesisht i japin regjistrimet e popullsisë. Për periudhën kohore 1948 - 1981 janë të dhënat për numrin e popullsisë së komunës së Kaçanikut sipas regjistrimeve të popullsisë. Gjithashtu janë shfrytëzuar të dhënat e regjistrimit 1991 që është vlerësim për faktin se në atë kohë kishte manipulime, por megjithatë konsiderohen si relativisht të sakta. Që nga viti 1991 nuk kemi fare të dhëna mbi popullsinë në Komunën e Kaçanikut, në përjashtim të disa vlerësimeve që janë bërë nga institucione të ndryshme. Andaj është realizuar regjistrimi i popullsisë për nevojat e Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban i cili jep rezultate mjaft të sakta. Ky regjistrim është realizuar nga Komuna e Kaçanikut dhe kompania Data GIS Consulting duke i inkuadruar maturanet e kësaj komune. Regjistrimi është një bazë e mirë për vlerësimin e situatës demografike dhe gabimet në rezultate nuk mund të jenë më të madha se 10 %.

3.1. Numri i popullsisë

Në Komunën e Kaçanikut jetojnë rreth 38174 banorë sipas këtij regjistrimi. Që nga viti 1948 e deri më sot komuna e Kaçanikut ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Në vitin 1948 Kaçaniku kishte 12836 banorë, ndërsa në vitin 2009 ajo kishte rreth 38174 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (60 vjeçare) numri i popullsisë është rritur për dy here më tepër.

Tabela 3. Numri i popullsisë sipas regjistrimeve

Vitet	Nr. i popullsisë
Regjistrimi 1948	12836
Regjistrimi 1953	14201
Regjistrimi 1961	15582
Regjistrimi 1971	18982
Regjistrimi 1981	24840
Vlerësimi 1991	30450
Vlerësimi 2009	38174


**Grafiku 1.** Numri i popullsisë sipas regjistrimeve

Numri i popullsisë në Komunën e Kaçanikut ka shënuar një rritje të konsiderueshme me rreth 25338 banorë prej vitit 1948 deri në vitin 2009. Pra në bazë të kësaj rritje del se mesatarisht popullsia ka shënuar rritje prej 415 banorë në vit.

Bazuar në indeksin bazik dhe vargor të rritjes së popullsisë në Komunën e Kaçanikut, mund të vërejmë periudhat kohore kur ka pasur rritje më të theksuar të popullsisë.

Tabela 4. Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor

Vitet	Nr. i popullsisë	Indeksi bazik	Indeksi vargor
1948	12836	100	100
1953	14201	111	111
1961	15582	121	110
1971	18982	148	122
1981	24840	194	131
1991	30450	237	123
2009	38174	298	109



Grafiku 2. Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor


Sipas të dhënave nga tabela dhe grafiku vërehet se deri në vitet e 60-ta Komuna e Kaçanikut ka shënuar rritje demografike, por shkallët e kësaj rritje kanë qenë më e vogla nga fakti se kishte shkallë të larta të natalitetit dhe mortalitetit ku si pasojë kishte shtim të ulët natyror. Pas viteve të 60-ta gjegjësisht viteve të 70-ta kemi një rritje më të theksuar të popullsisë si pasojë e zvogëlimit të shkallëve të mortalitetit dhe në anën tjetër shkalla e natalitetit mbetet ende e lartë ku si pasojë kemi shkallë më të lartë të shtimit natyror. Rritje më e theksuar demografike e popullsisë vërehet në periudhën kohore 1971 - 1981 kur popullsia është rritë për afër 6000 banorë. Gjithashtu rritje të konsiderueshme ka pasur edhe gjatë periudhës 1981 - 1991, gjithashtu me afër 6000 banorë dhe më pas vërehet një rritje më e vogël demografike si pasojë e rrethanave të vështira nëpër të cilat kaloi Kosova në përgjithësi dhe komuna e Kaçanikut në veçanti.

Popullsia e komunës së Kaçanikut jeton në gjithsej 29 vendbanime, prej tyre 28 janë fshatra dhe vetë qyteti i Kaçanikut. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Kaçanikut jetojnë rreth 13450 banorë që do të thotë se rreth 35 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 24724 banor apo rreth 65 %.

Tabela 5. Numri i popullsisë sipas vendbanimeve

Nr.	Vendbanimi	Numri i popullsisë	Nr.	Vendbanimi	Numri i popullsisë
1	Bajnicë	610	16	Korbliq	153
2	Begraca	2495	17	Kotlinë	618
3	Biçec	1620	18	Kovaçec	1418
4	Bob	1669	19	Nikaj	912
5	Gjurgjedell	235	20	Nikoc	7
6	Doganaj	1146	21	Rekë	843
7	Drenogllavë	54	22	Runjevë	839
8	Dubravë - Vatë	1253	23	Semajë	249
9	Duraj-Gabrricë	703	24	Sllatinë	189
10	Elezaj	547	25	Soponicë	1464
11	Gajre	540	26	Stagovë	1413
12	Glloboçicë	1289	27	Kaçanik i Vjetër	2188

13	Gërlicë e Epërme	432	28	Strazhë	271
14	Ivajë	587	29	Koxha	980
15	Kaçanik	13450			
Total					38174



Grafiku 3. Numri i popullsisë sipas vendbanimeve

Numër më të madh të popullsisë ka vet qyteti i Kaçanikut (13450 banor). Sa i përket vendbanimeve rurale, numër më të madh të banorëve kanë vendbanimet: Begracë (2495), Kaçanik i Vjetër (2188), Bob (1669).

3.2. Dendësia e popullsisë

Dendësia e popullsisë në Komunën e Kaçanikut është rreth 181 banorë në 1 km², ku rreth 38174 banorë jetojnë në 211,40 km². Kjo është një dendësi relativisht e ulët, krahasuar me mesataren e Kosovës.

Brenda territorit të komunës së Kaçanikut ekzistojnë dallime të theksuara sa i përket dendësisë së popullsisë. Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.


Tabela 6. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

Kodi	Vendbanimi	Nr. Popullsisë	Sip/km2	Dendësia b/km2
70917048	Kaçanik	13450	15.68	857.78
70917002	Bajnicë	610	3.39	179.94
70917003	Begracë	2495	11.52	216.58
70917007	Biçec	1620	18.06	89.70
70917008	Bob	1669	3.86	432.38
70917026	Doganaj	1146	3.50	327.42
70917032	Drenogllavë	54	3.48	15.51
70917035	Duraj - Gabrricë	703	1.84	382.06
70917038	Elezaj	547	2.77	197.47
70917016	Gajre	540	3.48	155.17
70917021	Gerlica e Epërme	432	1.28	337.50
70917037	Gjurgjedell	235	12.93	18.17
70917018	Glloboqicë	1289	13.03	98.92
70917041	Ivajë	587	8.17	71.84
70917086	Kaçanik i Vjetër	2188	9.80	223.26
70917050	Korbliq	153	16.06	9.52
70917052	Kotlinë	618	10.62	58.20
70917049	Kovaqec	1418	5.28	268.56
70917093	Koxhaj	980	2.58	379.84
70917064	Nikaj	912	3.18	286.79
70917074	Rekë	843	2.28	369.73
70917065	Nikoc	7	4.91	1.42
70917075	Runjevë	839	6.38	131.50
70917078	Semajë	249	2.61	95.40
70917080	Sllatinë	189	20.78	9.09
70917083	Soponicë	1464	3.13	467.73
70917085	Stagovë	1413	11.73	120.46
70917088	Strazhë	271	4.65	58.28
70917012	Dubravë - Vatë	1253	3.90	321.28
Total		38174	210.92	6181.5
Vlera mesatare				180.98

Dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Kaçanikut ku mesatarisht jetojnë rreth 857 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Soponica (467 b/km²), Bob (432 b/km²), Duraj - Gabrricë (382 b/km²), Rekë (369 b/km²), Doganaj (327 b/km²), Dubravë - Vatë (321 b/km²). Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Nikoc (1.4 b/km²), Sllatinë (9 b/km²), Korbliq (9.5 b/km²).

Vendbanimet që kanë dendësi më të vogël të popullsisë janë kryesisht vendbanime që gjenden më larg qendrës urbane të Kaçanikut, shtrihen në lartësi më të mëdha mbidetare, kanë mungesë të shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme, andaj edhe numri i popullsisë është më i vogël si dhe rreziku nga depopullimi është më i madh.

Harta 3. Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve




3.3. Shtimi natyror i popullsisë

Në periudhën e pasluftës, krahas shkallës së lartë të natalitetit, edhe mortaliteti ishte mjaft i lartë për shkak të mortalitetit të lartë infantil, si rezultat i nivelit të ulët të zhvillimit social e mjekësor. Gjatë periudhës 1971-1981, krahas rënies së natalitetit, bie dukshëm edhe mortaliteti e me këtë zvogëlohet edhe shtimi natyror i popullsisë. Përkundër zvogëlimit, shkalla e natalitetit mbetet ende shumë e lartë (rreth 30 promil), ndërsa rënia rapide e mortalitetit ndikoi që shtimi natyror dhe rritja e përgjithshme e popullsisë në Komunën e Kaçanikut të mbetet e lartë.

Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2008 janë vlerësuar duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Enti i Statistikës së Kosovës për vitin 2008 në tërë Kosovën dhe për çdo komunë.

Gjatë vitit 2008 në Komunën e Kaçanikut janë shënuar 1157 lindje⁶ dhe 188 vdekje⁷. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje për Komunën e Kaçanikut.



Grafiku 4. Shtimi natyror në vitin 2008

Siç shihet edhe nga grafiku, shkalla e natalitetit në Komunën e Kaçanikut është 21.7 promil apo 2.1%. Shkalla e mortalitetit është 4 promil apo 0.4%. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 17.7 promilë apo 1.7%.

3.4. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë


Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, si për të tanishmen ashtu edhe për të ardhmen. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyç të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate. Në aspektin demografik kjo strukturë ka rëndësi për riprodhimin biologjik sepse krijohet kontingjenti fertil, ndërsa në aspektin socio-ekonomik ndikon në krijimin e kontingjentit të punës. Struktura e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës ka rëndësi edhe për strukturat tjera demografike, për faktin se strukturat e popullsisë sipas veçorive të ndryshme socio-ekonomike (sipas aktivitetit, veprimtarisë, profesionit, arsimit etj.) hulumtohen njëkohësisht edhe sipas gjinisë dhe moshës.

⁶ ESK, Statistikat e lindjeve në Kosovë 2006.

⁷ ESK, Statistikat e vdekjeve në Kosovë 2006

Komuna e Kaçanikut në aspektin e zhvillimit demografik ka veçorit e sajë edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktor demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Kaçanikut ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë të zgjeruar të piramidës sipas moshës, edhe pse periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Mosha mesatare e popullsisë është 28.3 vjet, që tregon se kjo komunë ka popullsi shumë të re. Struktura gjinore e popullsisë po ashtu është karakteristike, me dominim të popullsisë mashkullore dhe me ndryshime të theksuara të koeficientit të maskulinitetit sipas grup-moshave.

Deri në vitet e 90-ta në Komunën e Kaçanikut ka dominuar plotësisht tipi progresiv i popullsisë, ku shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit kanë ndikuar drejtpërdrejtë në krijimin e këtij tipi të popullsisë. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëherit edhe në ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, piramida e popullsisë së komunës së Kaçanikut kishte bazë të zgjeruar me dominimin e grup-moshave 0 deri 4 vjeç. Gjatë analizës së të dhënave demografike nga regjistrimi, vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë. Këto ndryshime mund ti dallojmë më qartë përmes piramidës së popullsisë.




Grafiku 5. Piramida e popullsisë së komunës së Kaçanikut në vitin 2009

Në vitin 2009 forma e piramidës ndryshon duke u ngushtuar baza e saj dhe kjo si pasojë dy faktorëve: migrimeve dhe tendencave të zvogëlimit të natalitetit. Nga


piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 4 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup-moshën 5 deri 9 vjeç dhe 10 deri 14 vjeç.

Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.

Rreth 40 % të popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç, ndërsa grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje të vogël me 5.6 % të popullsisë së përgjithshme të Kaçanikut. Struktura gjinore e popullsisë në Komunën e Kaçanikut ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 1064, që do të thotë se mesatarisht ekzistojë 1064 meshkuj në çdo 1000 femra.



Grafiku. 6 Tri grup-moshat e popullsisë së komunës



Grafiku 7. Përqindja e popullsisë sipas gjinisë në Komunën e Kaçanikut

Sic shihet edhe nga grafiku, ekziston një debalans i vogël gjinor në popullsinë e komunës së Kaçanikut, ku popullsia mashkullore dominon me 51.6% në krahasim me popullsinë femërore që ka 48.4 % të popullsisë së gjithmbarshme.

Struktura e krijuar e moshës dhe gjinisë dhe ndryshimet e tyre gjatë kohës kanë krijuar efekte të reja socio-ekonomike dhe demografike. Këto dy struktura kanë

ndikuar në krijimin e kontingjenteve të rëndësishëm siç janë: Kontingjenti i punës, fertil, shkollor, i moshuar etj.

Tabela 7. Kontingjentet më të rëndësishëm të strukturës së moshës dhe gjinisë në %

Kontingjentet e rëndësishëm	Numri	Përqindja
Kontingjenti parashkollor dhe me shkollim të obligueshëm (0-14 vjet)	11223	29,4 %
Popullsia fertile femërore (15-49 vjet)	21187	55,5 %
Kontingjenti i punës (15-64/m dhe 15-59/f)	22981	60,2 %
Kontingjenti i moshuar (mbi 65 vjet)	2137	5,6 %

Kontingjentet e popullsisë janë në varshmëri reciproke në mes strukturës së popullsisë sipas moshës e gjinisë dhe proceseve tjera demografike e socio-ekonomike. Analiza dhe vlerësimi afatgjatë i këtyre kontingjenteve ka rëndësi të shumëfishtë, por para se gjithash për planifikime në sfera të ndryshme të organizimit shoqëror dhe ekonomik. Ato reflektojnë efekte në planifikimin afatgjatë kohor siç janë punësimi, shkollimi dhe entet parashkollorë, mbrojtja shëndetësore etj.


3.5. Struktura etnike dhe fetare e popullsisë

Në aspektin etnik komuna e Kaçanikut ka një popullsi gati të pastër me shqiptarë. Gjatë regjistrimit janë deklaruar vetëm 4 persona si rom, ndërsa të gjithë të regjistruarit e tjerë janë deklaruar si shqiptar.

Gjithashtu edhe në aspektin fetar, të gjithë të regjistruarit janë deklaruar se i përkasin fesë islame, ndërsa vetëm dy persona janë deklaruar se i përkasin fesë katolike

3.6. Struktura arsimore e popullsisë

Niveli i shkollimit të popullsisë është një element mjaft i rëndësishëm për të cilin janë evidentuar të dhëna gjatë regjistrimit të popullsisë.



Grafiku 8. Niveli i shkollimit

Sipas të dhënave nga grafiku vërehet se pjesa më e madhe e popullsisë së komunës së Kaçanikut është me shkollë fillore dhe të mesme.

Tabela 8. Niveli i shkollimit

Shkollimi	Numri	Përqindja
Fëmijë pa e filluar shkollimin	4657	12.2
Pa shkollë fillore	3894	10.2
Me shkollë fillore	13666	35.8
Me shkollë të mesme	12139	31.8
Me shkollë të lartë	687	1.8
Me fakultet	1184	3.1
Me shkollim superior	76	0.2
S'ka të dhëna	1871	4.9
Total	38174	100


Rreth 35 % e popullsisë së përgjithshme të komunës janë me shkollim fillore, ndërsa me shkollim të mesëm kemi rreth 31 %. Persona me shkollim të lartë dhe me fakultete kemi rreth 5 % të popullsisë së gjithmbarshme që mund ta konsiderojmë si një pjesëmarrje të vogël, dhe gjithashtu ata me shkollim superior që marrin pjesë me 0.2 %. Element mjaft shqetësues mbetet pjesëmarrja e lartë e popullsisë pa shkollim fare (pa shkollë fillore) që përfshinë 10.2 % të popullsisë së gjithmbarshme të komunës.

3.7. Familja dhe karakteristikat e saj

Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomikë, social, demografik etj.⁸

Siç dihet, ekzistojnë dallime sipas komunave në Kosovë sa i përket madhësisë së familjes. Komuna e Kaçanikut kryesisht karakterizohet me numër të madh të anëtareve të familjes, që është karakteristikë për vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale. Sipas të dhënave nga regjistrimi del se madhësia mesatare e familjes në Komunën e Kaçanikut është 6.9 anëtar. Në përgjithësi në Komunën e Kaçanikut dominojnë familjet me nga 5 dhe 6 anëtar si dhe ato me nga 4 dhe 7 anëtar. Gjithashtu kemi edhe numër të konsiderueshëm të familjeve që kanë 8 e më shumë anëtar, ndërsa familjet me 1, 2 dhe 3 anëtar janë shumë pakë, që janë rreth 7,6% e të gjitha familjeve në komunë.

⁸ Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008.



Grafiku 9. Përqindja e familjeve sipas numrit të anëtareve

Pjesëmarrja e vogël e ekonomive familjare me 1 - 3 anëtar është një dëshmi se, me gjithë transformimet socio-ekonomike dhe të tjera, proceset e modernizimit të shoqërisë në Komunën e Kaçanikut nuk kanë qenë të fuqishme për të kushtëzuar ndryshime rrënjësore në përbërjen e ekonomive familjare përmes sh'thurjes së ekonomive të zgjeruara tradicionale familjare në të ashtuquajtura familje nukleare, siç ka ndodhur në vendet e tjera të zhvilluara.

3.8. Lëvizja mekanike e popullsisë

Migrimet


Migrimet e popullsisë sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar⁹.

Me ndikimin e një varg faktorësh të natyrave të ndryshme si ata socio-ekonomik, politik, kulturor, demografik etj., në Komunën e Kaçanikut janë evidentuar një numër i konsiderueshëm i emigrantëve. Gjatë regjistrimit janë evidentuar 6795 emigrant, që përfshijnë 17,8 % të popullsisë së gjithmbarshme. Këta emigrant janë të shpërndarë në vende të ndryshme të Evropës dhe të botës, ku përfshijnë rreth 27 vende të ndryshme kryesisht nga Evropa, por kemi edhe emigrant në kontinentin e Amerikës, Azisë dhe Australisë.

⁹Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008. fq. 255.

Tabela 9. Migrimi i popullsisë sipas vendeve të migrimit

Nr.	Shteti	Nr. i emigr.	%	Nr.	Shteti	Nr. i emigr.	%
1	Gjermani	2955	43.5	15	Finlande	27	0.4
2	Zvicër	1590	23.4	16	Çeki	20	0.3
3	France	387	5.7	17	Holande	20	0.3
4	Amerike	340	5	18	Slloveni	14	0.2
5	Angli	245	3.6	19	Irak	7	0.1
6	Itali	238	3.5	20	Afganistan	7	0.1
7	Austri	217	3.2	21	Turqi	7	0.1
8	Suedi	211	3.1	22	Kroaci	7	0.1
9	Kanada	122	1.8	23	Shqipëri	7	0.1
10	Belgjike	115	1.7	24	Spanje	7	0.1
11	Norvegji	88	1.3	25	Australi	7	0.1
12	Danimarkë	75	1.1	26	Mali I Zi	7	0.1
13	Maqedoni	41	0.6	27	Irlandë	7	0.1
14	Greqi	27	0.4				
Total						6795	100



Grafiku 10. Migrimi i popullsisë sipas vendeve të migrimit

Migrimet e përhershme apo definitive janë ato migrime, kur njerëzit kanë migruar në një vendbanim apo komunë tjetër për të jetuar përgjithmonë. Të dhënat për këto migrime gjithashtu janë marrë nga regjistrimi i popullsisë, ku del se numri i emigrantëve që janë shpërngulur nga komuna e Kaçanikut është 97 persona apo 0,25 % e popullsisë së përgjithshme. Ata kryesisht kanë emigruar në qytetin e Ferizajit, Prishtinës, Fushë Kosovës etj.

I.4. ÇËSHTJET SOCIALE

4.1. Arsimi

Arsimimi është themeli i një shoqërie të shëndoshë i cili garanton perspektivë për të ardhmen shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike në vend. Vitet e '90-ta, ishin të rënda për arsim shqip në Kosovë për arsye të largimit të dhunshëm nga objektet shkollore. Gjatë periudhës 90 - 99, shqiptarët organizojnë sistemin paralel të arsimit


në Kosovë ku në mënyrë mjaft të mirë e ruajtën arsimin nga asimilimi i gjithmbarshëm i shoqërisë Kosovare. Lufta e fundit në Kosovë la pasoja të mëdha në infrastrukturën shkollore, këto dëme nuk kishin lënë pa prekur asnjë komunë me popullsi shqiptare në këtë rast edhe vetë Komunën e Kaçanikut. Pas vitit 2000 (pas luftës), institucionet kosovare bënë përpjekje në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore. Në vitin 2002, krijuan një model të ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e re ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të ulët të mesëm dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të lartë të mesëm. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re arsimit i obligueshëm është zgjatur për një vit nga 8 vite sa ishte në 9 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor në Komunën e Kaçanikut është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (I - V), arsimin e mesëm të ulët (VI - IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X - XII). Numri i objekteve shkollore gjithsejtë është 31, duke përfshi edhe çerdhen dhe shkollat e mesme. Nga të gjitha shkollat fillore 12 prej tyre janë amë dhe 16 të tjera janë satelite (paralele të ndara), 2 shkolla të mesme dhe një çerdhe. Në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar 548 punëtor. Prej tyre 488 mësimdhënës dhe 60 të tjerë punëtor administrativ dhe teknik. Numri i nxënësve gjithsejtë 8959, çka do të thotë se 18.35 nxënës /mësimdhënës.

Çerdhe dhe kopshte - posedon një çerdhe (QEAP “ **AGIMI** ”) për fëmijë të moshës nën 5 vjet, me kushte solide. Punohet me normë të plotë me një numër të vogël fëmijësh (17 fëmijë) . Kjo çerdhe shfrytëzohet për edukimin e nxënësve parashkollor me gjithsejtë 4 paralele. Ndërkaq, vetëm 35 % e të gjitha shkollave amë posedojnë kopshte për fëmijë dhe atë në kushte jo të kënaqshme.


Arsimi para fillor - zhvillohet në të gjitha shkollat fillore amë (12) me gjithsejtë 21 paralele për fëmijët nën moshën 6 vjeçare me numër të nxënësve 572. Prej 31 vendbanimeve sa ka komuna e Kaçanikut 10 prej tyre nuk zhvillojnë mësim parashkollor. Numri i mësimdhënësve është 21 (100 %) të gjithë të kualifikuar për këtë nivel arsimor. Edukimi parashkollor zhvillohet në 67.7 % të shkollave fillore në hapësirat rurale, po ashtu edhe në çerdhen “Agimi” në zonën urbane.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar) - në tërë territorin e komunës mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 28 objekte shkollore, mësimet i ndjekin rreth 6660 nxënës. Mesatarisht rreth 2.12 m² hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi në këtë nivel (shih grafikun më poshtë). Me hapësirë shkollore të pamjaftueshme na paraqiten këto vendbanime: Begraca (0.78 m² për nxënës), Kovaçec (0.96 m² për nxënës), Kaçanik (1.49 për nxënës së shkollës fillore), Llanishtë (1.53 m² për nxënës), Vatë (1.7 m² për nxënës), Bob (1.73 m² për nxënës), Doganaj (1.77 m² për nxënës), Gllboçicë (1,83 m² për nxënës), Dubravë (1.85 m² për nxënës



Grafiku 11. Objektet shkollore m² / nxënës dhe numri i turneve, 2009

Pjesa dërmuese e vendbanimeve mësimin e zhvillojnë në një dhe dy turne, përjashtim bënë shkolla e Kaçanikut dhe Begracës në të cilët mësimi zhvillohet në 3 turne. Ndërsa, 81.1% të personelit arsimor janë të kualifikuar dhe 18,9% të tjerë janë të pa kualifikuar. Sa i përket kualifikimeve të personelit arsimor me gjendje jo të mirë e kemi të shprehur në këto vendbanime; Runjeva (100% të pakualifikuar), Llanishta (100% të pakualifikuar), Gjurgjedeli (60% të pakualifikuar), Semajë (50% të pakualifikuar), Soponicë (50% të pakualifikuar), Strazhë (50% të pakualifikuar), Vatë (50% të pakualifikuar), Koxhaj (50% të pakualifikuar) etj. për më tepër shih grafikun nr.



Grafiku 12. Numri i nxënësve/mësimdhënës dhe kualifikimet e personelit arsimor


Raporti nxënës/mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 17,66 nxënës mesatarja për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën. Me gjendje jo të mirë të raportit nxënës/mësimdhënës na paraqitet në këto shkolla fillore si: Dubravë (24,5 nxë./mësimdhënës), Kaçanik (21.04 nxë./mësimdhënës), Elezaj (20.26 nxë./mësimdhënës.).

Arsimi i mesëm i lartë - përfshin tri dhe katër vite të shkollimit për nxënësit e grupmoshës 15 deri 18 vjeç. Në këtë komunë janë dy shkolla të mesme Gjimnazi “Skënderbeu” dhe Shkolla e Mesme Profesionale, me disa drejtime të ndryshme, dhe

gjenden në zonën urbane. Në këto shkolla numri i nxënësve që i ndjekin mësimet është 1743 nxënës, me një kuadër të mësimdhënësve prej 89 që janë të angazhuar në procesin edukativo-arsimor. Kualifikimet e personelit arsimor në këto dy shkolla të mesme sillet rreth 82.5% të kualifikuar dhe 17.5% të pakualifikuar. Ndërsa, rreth 2.98 m² hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi. Ndërsa, raporti nxënës/ 1 mësimdhënës në shkollën e mesme është 19.58 për 1 mësimdhënës, mësimi zhvillohet në dy turne.

Për detaje tjera rreth arsimit në këtë hapësirë shih hartën si më poshtë;

Harta 4. Shtrirja hapësinore e Objekteve shkollore



Kjo hartë paraqet të dhënat ekzistuese për rrjetin e shkollave si dhe shtrirja e tyre nëpër vendbanime. Duhet theksuar se shkolla e Mesme Profesionale me parcelë kadastrale i takon vendbanimit Bob.

Shkolla speciale - në shkollën fillore “Nazmi Osmani” që gjendet në vendbanimin Elezaj zhvillohet mësim special për persona me aftësi të kufizuara. Në këtë shkollë është një paralele speciale me gjithsejtë 17 nxënës dhe me dy mësimdhënës të kualifikuar. Nxënësit janë të moshave të ndryshme dhe me të meta të natyrave të veçanta, ku ju kushtohet një përkujdesje e veçantë nga personeli arsimor.

Shkalla e analfabetizimit - në këtë komunë sipas hulumtimeve të organizatave të ndryshme përkatësisht UNDP-së (në vitin 2004) rreth 5.23% të popullsisë mbi moshën 15 vjeçare e përbëjnë analfabet, ndërsa sa i përket regjistrimit të fundit të popullsisë për nevoja të PZHK-së dhe PZHU-së (viti 2009), del se 12.2% e popullsisë janë pa shkollë fillore. Sipas të njëjtit hulumtim të UNDP-së (viti 2004) mesatarja e analfabetizimit në Kosovë është 5.78% e popullsisë të po asaj moshe.

Prej të gjitha shkollave në Komunën e Kaçanikut vetëm Gjimnazi Skënderbeu posedon bibliotekë, shkollat tjera nuk kanë. Vëllimi i burimeve nuk është i madh, sillet nga 50-2000 libra varësisht prej bibliotekës, të dhënat për lexuesit në bibliotekën e qytetit tregojnë se interesimi i lexuesve nuk është i madh. Ndërsa, 20% prej tyre kanë salla sportive dhe 72% e objekteve shkollore në të gjitha vendbanimet nuk kanë

nxehe qendrore. Nga të gjitha objektet shkollore, rreth 45% e të tyre kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit, kurse pjesa tjetër furnizohen me ujë të pijshëm nga sistemet e vogla familjare me rrënjë të lirë dhe nga pusët.

4.2. Shëndetësia

Sistemi shëndetësor në Kosovë pas përfundimit të luftës së vitit '99, u ballafaqua me vështirësi të shumta në çështje organizative, infrastrukturë si dhe në përkrahje financiare. OBSH, Banka ndërkombëtare, Bashkësia Evropiane dhe organizatat tjera ndërkombëtare me investime e tyre luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin e sistemin shëndetësor.

Gjatë kësaj periudhe pothuajse të gjitha objektet shëndetësore të dëmtuara gjatë luftës janë rinovuar dhe shumë objekte të reja janë ndërtuar. U ofruan ndihma në pajisje dhe aparatura mjekësore moderne të nevojshme dhe u organizuan trajnime në lëmi të ndryshme të mbrojtjes shëndetësore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve kualitative dhe të leverdishme të kujdesit shëndetësor primar, sekondar dhe terciar në të gjitha institucionet shëndetësore.

Një pjesë e konsiderueshme e këtyre investimeve u përqendruan në reformimin e kujdesit parësor me inicimin e mjekësisë familjare si bartëse e këtij kujdesi dhe në këtë drejtim u organizua për herë të parë shkollimi superior i mjekëve dhe personeli shëndetësorë në këtë lëmi të mjekësisë. Angazhimi i strukturave vendore, edhe pse me shumë vështirësi, si dhe përkrahja dhe bashkëpunimi me institucioneve ndërkombëtare sot e ngritin konceptin e mjekësisë familjare në Kosovë, të paktën në pasurimin e njohurive teorike, në nivel të njëjtë me të gjitha vendet e tjera të rajonit. Gjithashtu edhe në Strategjinë shëndetësore të Kosovës 2005-2015, mjekësia familjare është sektor mjaft me rëndësi në zbatimin e synimeve dhe prioriteteve shëndetësore kryesore të identifikuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Edhe në Komunën e Kaçanikut, mjekësia familjare është shtylla kryesore e shëndetësisë e cila udhëhiqet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS). DSHMS organizon punën në shërbimet primare shëndetësore, shërbimet sociale dhe shërbimet të inspektimit sanitar.

Në Komunën e Kaçanikut shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore. Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 10 institucione shëndetësore të mjekësisë familjare:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në qytetin e Kaçanikut
- Dy Qendra të Mjekësisë Familjare në vendbanimet Doganaj dhe Kaçanik i Vjetër
- Shtatë ambulanca të Mjekësisë familjare të organizuara në vendbanimet: Begracë, Biçec, Dubravë, Glloboçicë, Kotlinë, Stagovë dhe Strazhë.


Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dëshmorët e Lirisë" në Kaçanik, si bartëse e kujdesit primar, është e vendosur në qytetin e Kaçanikut dhe ofron shërbime në një ndërtesë me hapësirë 1300 m². Ky objekt është rindërtuar në vitet e '80^{ta} me destinim që nga fillimi si objekt shëndetësor, sot në gjendja fizike të kënaqshme. Në këtë qendër e cila mbulon me shërbime territorin e Kaçanikut dhe fshatrat përreth kanë qasje 17314 banor ose 45.37% e popullatës së komunës. Në këto institucion janë të punësuar gjithsej 81 punonjës, 8 mjek, prej të cilëve 4 specialistë të

mjekësisë familjare dhe 4 mjek të praktikës së përgjithshme, 1 specialist i mjekësisë urgjente, 1 oftalmolog, 2 stomatolog, 48 infermier dhe teknik si dhe 21 punëtor ndihmës jo shëndetësor. Në këtë qendër puna është e organizuar në dy ndërrime, derisa emerxhenca ofron shërbime 24 orëshe. Gjatë vitit 2008 janë realizuar gjithsejtë 125460 shërbime shëndetësore , prej të cilave 52396 vizita dhe 73064 intervenime. Largësia më e madhe e vendbanimeve që gravitojnë në QKMF-në e Kaçanikut, nuk është më e madhe se 3.5km.

Qendrën e Mjekësisë Familjare në Doganaj ka objektin e ri të ndërtuar në vitin 2001/2002 me sipërfaqe prej 80 m² në gjendje mjaftë të mirë fizike. Në këtë qendër punon një mjek dhe dy infermiere në orar të plotë , pesë ditë në javë. Në këtë qendër gravitojnë vendbanimet: Bajnicë, Duraj, Elezaj, Gabricë, Semajë, Sllatinë dhe një pjesë e vendbanimit Soponicë. Këtu ofrohen shërbime shëndetësore për 5340 banorë ose 13.99 % e popullatës së komunës. Gjatë vitit 2008 janë realizuar gjithsejtë 1516 shërbime shëndetësore , prej të cilave 759 vizita dhe 757 intervenime. Banorët e vendbanimeve Semajë dhe Bajnicë kalojnë largësinë 4-6km për të marrë shërbimet shëndetësore në QMF Doganaj, dhe paraqesin 16.1% të popullatës që gravitojnë në këtë qendër. Pjesa tjetër e popullatës e vendbanimeve që gravitojnë në këtë qendër, kalojnë distancë 0-2 km. Në QMF - Doganaj punojnë 1 mjek dhe 2 teknik, sipas kriterëve të MSH ka mungesë të kuadrit, sepse raporti tregon se 1.87 mjek/10000 banor dhe 3.75 teknik/10.000 banor.

Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kaçanik të Vjetër kanë qasje 2188 banorë ose 5.73 % e popullatës së përgjithshme. Në këtë institucion, punojnë një mjek dhe dy infermier ne orar të plotë. Hapësira prej 200 m² nuk është në gjendje të mirë. Gjatë vitit 2008 janë realizuar gjithsejtë 559 shërbime shëndetësore , 209 vizita dhe 350 intervenime. Në Qendrën e mjekësisë Familjare në Kaçanik të Vjetër punojnë 1 mjek ose 4.57 mjek/10000 banorë dhe 2 teknik ose 9.14 teknik/10.000 banorë


Harta 5. Objektet shëndetësore



Shtatë Ambulanca në fshatrat; Begracë, Biçec, Dubravë, Glloboçicë, Kotlinë, Stagovë dhe Strazhë, kryesisht kanë hapësira të punës në gjendje të mirë fizike, meqenëse janë të ndërtuara pas vitit 1999 nga donacionet e organizatave ndërkombëtare dhe pjesërisht me investime të qeverisë. Hapësira e përgjithshme e këtyre shtatë AMF-ve është 615 m². Në këto ambulanca ku mjeku punon dy herë në javë dhe dy infermiere pesë ditë në javë, ofrojnë shërbimin parësor shëndetësor për 12347 banorë ose 33.34 % e popullatës të përgjithshme të komunës. Gjatë vitit 2008 janë realizuar 5202 shërbime shëndetësore: 1153 vizita dhe 4049 intervenime.

Harta 5. Shtrirja hapësinore e objekteve shëndetësore.

Në këto institucione janë të punësuar gjithsejtë 102 punonjës, 16 mjek, 2 stomatolog, 62 teknik (infermier dhe laborant) dhe 21 punëtor administrativ. Bazuar ne kriteret e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me raportin mjek/infermier/nr.banorë në QMF Doganaj ka mungesë të stafit. Në QMF në Kaçanik i Vjetër dhe në QKMF në Kaçanik edhe pse ky raport i tejkalon kriteret e parapara për numër të mjekëve dhe për numër të teknikëve, nuk mund të themi se ka tepriçë të stafit, për arsye se mjekët dhe tekniket janë të angazhuar në shtatë ambulanca të mjekësisë familjare nëpër vendbanime të komunës.



Grafiku 13. Punëtorët shëndetësor në 10 000 banorë në komunë

Nga të dhënat e analizuar vërehet se popullata e Komunës së Kaçanikut është e mbuluar tërësisht me shërbime shëndetësore si dhe shpërndarja hapësinore e objekteve shëndetësore i plotëson kriteret e parapara me rregulloren për shërbime parësore.

Në nivel të komunës në QKMF-së, për vitin 2008 janë raportuar 132817 shërbime me 54547 vizita dhe 78250 intervenime. Prej numrit të përgjithshëm të shërbimeve 94.5% janë realizuar në QKMF në Kaçanik, 1.14% në QMF-Doganaj, 0.42% në QMF-Kaçanik i vjetër dhe 3.91 në shtatë AMF-të

Vizitat më të shpeshta ishin në shërbimin e mjekësisë familjare 52.2%, në shërbimin e Stomatologjisë 7.13% dhe 40.64% në shërbimet specialistike dhe Emergjencës.

Sëmundjet e diagnostikuara më së shpeshti, sipas klasifikimit ndërkombëtar 10, gjatë vitit 2008 kanë qenë sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes, sistemit digjestiv dhe kardiovaskular. Me diagnozë të parë prinë Diabeti (sëmundja e sheqerit) me 512 raste, Anemia (pagjakësia) me 128 raste, Tumore/neoplazmat malinje në 21 raste. Në nivel të komunës gjatë vitit 2008, situata epidemiologjike dhe lajmërimi i epidemive

të sëmundjeve ngjitëse ka qenë e qetë, përkundër 9 rasteve me Brucelozë, 6 raste me verdhëz akute dhe 625 raste të diarresë akute. Ky numër lidhet me infrastrukturë jo mirë të rregulluar të furnizimit me ujë të pijshëm nga burimet e pakontrolluara, ndërprerjet e gjata të ujit nga ujësjellësi, mungesa e kanalizimit, dispozicioni i mbeturinave jo i rregullt dhe kushtet e dobëta ekonomike dhe higjienike të cilat në Kaçanik janë evidente.

Në sektorin privat veprojnë gjithsej 13 institucione shëndetësore, të cilat aktivitetin e tyre e zhvillojnë kryesisht në zonën urbane. Në këto ordinaanca ofrohen shërbime: pediatrike, internistike, stomatologjike dhe mjekësisë familjare, ku punojnë specialist të degëve përkatëse.

Vlen të përmendet edhe objekti i spitalit (Sanatoriumit) të vjetër të qytetit i cili sot nuk është në funksion, por shumë vite më parë, nga vitet e '70, ka shërbyer për shërimin dhe rehabilitimin e pacienëve me sëmundjeve të TBC të eshtrave. Jo vetëm në Komunën e Kaçanikut, por edhe shumë pacient nga mbarë Kosova dhe



rajoni janë trajtuar dhe shëruar në këtë qendër spitalore. Lokacioni ku ndodhet objekti spitalor ka përparësi të madhe meqë aty gërshetohen klima mesdhetare me atë kontinentale, dhe e gjithë sipërfaqja për rreth objektit është e pyllëzuar dhe e gjelbëruar. Hapësira ku ndodhet objekti spitalor është në sipërfaqe 3.96 ha, vetëm

objekti ka sipërfaqen prej 1.200 m². Pas përfundimit të luftës në Kosovë, objekti i ish-Sanatoriumit është shfrytëzuar nga TMK-ja. Aktualisht është i pa shfrytëzuar dhe ka nevojë për rivitalizim dhe përmirësim të gjendjes fizike të objektit.

4.3. Papunësia

Papunësia është një ndër problemet me të cilën më së shumti po përballet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 44.4%¹⁰. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat (58.06%), pavarësisht nga shkalla shumë e lartë e jo aktivitetit për ato. Edhe pse, nuk ka të dhëna të sakta për shkallën e papunësisë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia është e lartë.


Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se shkalla e papunësisë në Komunën e Kaçanikut është e lartë (45.13%)¹¹. Vlerësohet se rreth 80% e të papunëve janë të papunë afatgjatë (të papunë për më shumë se 12 muaj).

Sipas analizës së të dhënave për punëkërkuesit e paraqitur në zyre të punësimit, në këtë komunë janë paraqitur si të papunë rreth 32,8%. Kjo vlerë është llogaritur nga

¹⁰ UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosovë, 2004.


¹¹ Po aty.

raporti mes numrit të popullsinë aktive dhe numrit të punëkërkuesve të paraqitur në zyrat e punës dhe punësimit në komunë. Kjo përqindje duhet të jetë edhe më e lartë pasi që një numër i konsiderueshëm i të pa punëve nuk janë të paraqitur fare. Gjatë regjistrimit të popullsisë janë regjistruar edhe personat që janë në marrëdhënie pune, ku del se rreth 25.5 % e popullsisë aktive janë në marrëdhënie të rregullt të punë, por ka edhe nga ata që janë të punësuar kohë pas kohe. Sipas këtyre analizave numri më i madh i punëkërkuesve është i shprehur në vendbanimet si: Dubravë-Vatë, Sllatinë, Stagovë, Runjevë, Doganaj, etj. për më tepër shih grafikun;



Grafiku 14. Papunësia sipas vendbanimeve dhe punëkërkuesit në %


Kjo shkallë e lartë e papunësisë ka prekur pothuaj të gjitha grup moshat e popullsisë, por më e theksuar është te grup moshat e reja.



Grafiku 15. Papunësia sipas moshës dhe gjinisë

Papunësia më e lartë është e shprehur te grup moshë e re e popullsisë 15-24 vjeç (66.67%). Shkalla e papunësisë zvogëlohet te grup moshat më të vjetra. Ndërkaq, sa i përket gjinisë, gjinia femërore ka shkallë më të lartë të papunësisë, e veçanta e kësaj

është se me rritjen e moshës rritet edhe shkalla e papunësisë për gjininë femërore. Sa i përket kualifikimeve të punëkërkesve kemi këto rezultate, shih grafikun;



Grafiku 16. Punëkërkesit sipas kualifikimeve

Me shkallë më të lartë të papunësisë paraqitet popullsia me kualifikime fillore (56.78%), më pas me shkallë të papunësisë pak më të vogël përfaqësohet popullsia me nivel të shkollimit të mesëm (42.86%) dhe me shkallë shumë më të ulët është e përfaqësuar popullsia me nivel të lartë të shkollimit (0.32%) por gjithsesi edhe përkundër kualifikimeve të larta (shkollë të lartë fakultet etj) është e prekur nga papunësia.

- Papunësia në raport me komunat tjera

Kjo shkallë e lartë e papunësisë është pasojë e një mori faktorësh. Ndër faktorët të cilët kanë pas ndikim të madh në shkallën e lartë të papunësisë janë faktori

- a) social,
- b) ekonomik dhe
- c) hapësinor.

- **Faktori ekonomik** - mbyllja e fabrikave gjatë viteve të '90-ta dhe shkatërrimi i tyre, vonesat në privatizimin e ndërmarrjeve, humbja e interesimit për tu marr me bujqësi, parcelizimi shumë i madh i pronave, etj, kanë pas ndikim të madh në shkallën e papunësisë.
- **Faktori social** - niveli i ulët i arsimimit (me theks të veçantë tek femrat), familjet e mëdha në numër dhe popullsi kryesisht agrare, largimi i dhunshëm prej punës nga pushtuesi serb, gjatë viteve të '90 -ta, etj.
- **Faktori hapësinor** - vendbanime të vogla dhe me largësi të theksuar nga zona urbane, zhvillime të pa balancuara në hapësirë, zhvillime monocentrike (vetëm në zonën urbane), dhe faktor të tjerë .


Të gjithë këta faktor të përmendur si më lartë dhe faktor të tjerë, kanë bërë që shkalla e papunësisë në Kaçanik të jetë shumë e lartë.

4.4. Varfëria

E shkaktuar nga një mori faktorësh, varfëria është e përhapur gjerësisht në Kosovë. Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se mbi gjysma e popullsisë (50.3%) jetojnë në varfëri të përgjithshme, ndërsa rreth 13% e popullsisë jeton në varfëri ekstreme¹².

Largimet e dhunshme nga puna të popullsisë shqiptare nga pushtuesi serb, në fillim të viteve të '90-ta, shkallë e ulët e arsimimit, zhvillim i pa balancuar ekonomik, shkatërrimet e shtëpive, bizneseve dhe ndërmarrjeve nga lufta e fundit në Kosovë ('99), etj. ndikuan drejtpërsëdrejti në shkallën e lartë të varfërisë. Varfëria ka prekur të gjitha komunat e Kosovës.

Komuna e Kaçanikut është një komunë relativisht e vogël për nga numri i banorëve dhe merr pjesë me shkallë të lartë të varfërisë në nivel vendi. Sipas hulumtimeve të bëra nga organizata të ndryshme përkatësisht UNDP-së në vitin 2004, kemi këtë paraqitje të varfërisë;




Grafiku 17. Shkalla e varfërisë në Kaçanik

Sipas hulumtimit të lartpërmendur 16.33% e popullsisë së kësaj komune jetojnë me një dollar në ditë për person, 63.88% e popullatës jeton me dy dollar në ditë për person, me varfëri ekstreme jetojnë 17.99% e popullsisë dhe me varfëri të përgjithshme jetojnë 70.22% e popullsisë.

Ndërsa, pas grumbullimit të dhënave nga Qendra për Punë Sociale e cila funksionon në kuadër të komunës për numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve nëna me asistencë sociale dhe analizave të bëra paraqitet shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Këto të dhëna, ndihmojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës. Në këtë komunë shkalla e varfërisë ekstreme është rreth 17%, ndërkaq ajo e varfërisë së përgjithshme duhet të jetë shumëfish më e lartë. Në mungesë të indikatorëve tjerë (shkalla e arsimimit, të ardhurat për kokë banori, kushtet higjienike, banimi etj) të cilat janë të domosdoshme për matjen e shkallës së varfërisë është vështirë të përcaktohet gjendja aktuale e shkallës së varfërisë së përgjithshme.

Me shkallë më të lartë të varfërisë është e prekur gjinia femërore me 51.4%, kurse nga gjithsejtë 719 familje me asistencë sociale 16.3% janë kryefamiljare nëna. Kjo shkallë e lartë e varfërisë është e shtrirë gjerësisht në tërë territorin.

¹² UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosovë, 2004.



Grafiku 18. Popullsia me asistencë sociale-varfëri ekstreme

Me shkallë minimale të varfërisë (0%) është vendbanimi Nikoc, përderisa, me shkallë maksimale (22.2%) është Kotlina. Vendbanimet me shkallë më të lartë të varfërisë janë kryesisht ato kodrinore-malore me largësi të theksuar nga zona urbane.

Krahasuar me komunat me të cilat Kaçaniku ka karakteristika të ngjashme janë: Lipjani (41.88%), Shtimja (59.94), etj.

Në shkallën e lartë të varfërisë kanë ndikuar një mori faktorësh: dëbimi i popullsisë shqiptare nga vendet e punës nga pushtuesi serb nga fillimi deri në fund të viteve të '90-ta, shkatërrimet e luftës, shkalla e lartë e papunësisë, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, të ardhurat e vogla për kokë banori, arsimimi i pamjaftueshëm etj. Të gjitha këto fakte sjellin deri te konstatimi se ky problem është serioz. Në këtë kategori hyjnë: të papunët, ata në punë me orar të reduktuar ose punë të pasigurta, të moshuarit, të sëmurët, të paaftët, si dhe anëtarët e familjeve të mëdha ose të familjeve me një prind, pensionistët, familjet me kryefamiljare nëna, etj. Kjo shkallë e lartë papunësisë nuk duket se mund të bjerë në të ardhmen e afërt, ndërsa papunësia e i shtyn gjithnjë e më shumë familjet drejt varfërisë.

4.5. Kultura, Rinia dhe Sporti

Kultura

Kultura tregon të kaluarën dhe të tashmen e një populli. Në Komunën e Kaçanikut zhvillimet kulturore kanë zënë vend që një kohë të gjatë. Pas Luftës së Dytë Botërore zunë vend shfaqja e shumë aktiviteteve kulturore – artistike. Në këtë kohë ishin formuar shoqëri të shumta kulturore-artistike; shoqëria kulturore artistike “Përparimi” në Kaçanik (1947), “Vëllazërimi” në Kaçanik të Vjetër, “Zëri i Rinisë” në Dubravë, “Tingujt e Vendlindjes” në Stagovë dhe shoqëri të tjera. Në vitin 1978 mbahet për herë të parë Festivali Kombëtar i shoqërive kulturore – artistike dhe Ansambleve Muzikore dhe nga atëherë bëhet festival tradicional. Në këtë komunë janë zhvilluar ngjarje të rëndësishme historike si: shpallja e Kushtetutës së Kosovës e ashtuquajtura Kushtetuta e Kaçanikut.

Në Komunën e Kaçanikut ka vepruar edhe grupi letrar „Hivzi Sylejmani” i cili grup përveç tjerash botoi edhe përmbledhjen e poezive „Goca e Kaçanikut”. Në këtë komunë gjenden pesë biblioteka ku dy prej tyre janë në qytet, një në Kaçanik të Vjetër, një në Stagovë dhe një në Doganaj. Në dy bibliotekat e qytetit janë rreth 18378 botime dhe 283 lexues ndërkaq, në atë të Kaçanikut të Vjetër 5202 botime dhe 21 lexues, në bibliotekën e Stagovës janë 4012 botime me 40 lexues dhe në bibliotekën

Doganaj janë 6199 botime dhe 31 numri i lexuesve. Mungojnë të dhënat për m² të bibliotekave, numrin e punëtorëve, shtëpia e kulturës, për ngjarjet kulturore vjetore, teatri dhe shfaqjet teatrore etj.

Rinia

Rinia paraqet grup moshën më të madhe të popullsisë në këtë komunë, njëjtë si në nivel të Kosovës. Rreth 65% e popullsisë së përgjithshme e përfaqëson rinia në moshën 30 vjeç. Në dekadën e fundit si në tërë Kosovën edhe në Komunën e Kaçanikut ndodhen ndryshime të theksuara socio-kulturore. Këto ndryshime ndodhën si rezultat i hyrjes së shumë organizatave ndërkombëtare të cilat sollën përvoja të reja dhe investime në përmirësimin e infrastrukturës rinore në përgjithësi. Në këtë komunë mund të thuhet se kushtet për zhvillimin e aktiviteteve rinore janë relativisht të mira. Aktivitetet rinore zhvillohen në qendrën rinore të qytetit, stadiumin e qytetit, fushën e hendbollit, shtëpinë e kulturës, në objekte shkollore etj. Por jo vetëm kaq, këtu kemi të bëjmë edhe me organizimin e kurseve dhe trajnimeve të ndryshme rinore me karakter edukativo arsimor. Një ndihmesë të madhe rinisë kaçanikase i'a ofroj edhe shtrirja e internetit kryesisht në zonën urbane. Mandej, themelimi i shumë organizatave rinore, qëllimi i të cilave është organizimi i aktiviteteve të ndryshme rinore etj. Edhe pse të arriturat (përmirësimi i kushteve rinore) në dekadën e fundit janë të prekshme, si do që të jetë mbetet edhe shumë për tu bërë.

Mungojnë shënimet për aktivitetet rinore brenda vitit dhe llojit të tyre.

Sporti

Një ndër aktivitetet më të preferuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë është sporti. Sporti në Komunën e Kaçanikut zhvillohet në mënyrë ekipore dhe individuale. Në këtë komunë zhvillohen lëmi të ndryshme të sportit si: futboll, hendboll, basketboll, karate, shah, atletikë, skijim dhe mundje. Aktivitetet e veta i zhvillojnë një mori e klubeve sportive: klubi futbollistik "Lepenci" i cili bënë pjesë në ligën e dytë të Kosovës. Në kuadër të këtij klubi veprojnë: fatosat, pionierët, kadetët si dhe juniorët që bëjnë gara të rregullta në regjionin e Ferizajt, Gjilanit dhe numron mbi 250 anëtarë.

KH" Lepenci" Kaçanik bënë gara të rregullta me ekipin e meshkujve në Ligën e Parë të Kosovës dhe ekipin e femrave në Ligën e Dytë të Kosovës në hendboll. Poashtu ka edhe ekipin e pionierëve. Numri i gjithmbarshëm është diku mbi 120 anëtarë .

KB" Lepenci" Kaçanik bënë gara të rregullta në Ligën " A2" të Kosovës në basketboll dhe numron rreth 20 anëtarë.

KB" Sharrcem" Kaçanik poashtu bënë gara të rregullta në Ligën " A2 " të Kosovës me rreth 25 anëtarë.

KB "Kaçaniku" Kaçanik është ekip e femrave e cila bënë gara të rregullta në Ligën e Parë të Kosovës ka 20 anëtarë.

KSH" Lepenci" Kaçanik bënë gara të rregullta në ligën e dytë të Kosovës. Ka ekipin e juniorëve dhe junioreve që është produkt i shkollës së Shahut ka mbi 50 anëtarë.

KK "Lepenci" Kaçaniku dhe "Sharri" bëjnë gara në formë të turneve ku numri i tyre është mbi 300 anëtarë.

KA" Avdullah Baftiu" Kaçaniku merr pjesë në mitingje që organizohen në Kosovë ka mbi 30 anëtarë.

KSPPP"Kaçaniku" Kaçanik është klub që merr pjesë në gara të skijimit si dhe organizon gara të ndryshme në borë. Po ashtu në gjiun e vetë ka edhe paraponten e cila zhvillohet kryesisht në malet e Sharrit, ka mbi 25 anëtarë. Klubet sportive i kanë në gjiun e vetë 1.125 anëtarë, prej tyre meshkuj 925 anëtarë ndërsa femra 220 anëtare. Për të gjithë të rinjtë e kësaj komune është vetëm një objekt i futbollit i cili nuk i plotëson nevojat e të rinjve në komunë.

Fusha e hendbollit me 1.250 m² nuk i plotëson kërkesat e të rinjve të kësaj komune. Ka 13 shkolla fillore me 8.540 nxënës me vetëm një fushë të asfaltuar. Poashtu ka 3 shkolla të mesme me 1.493 nxënës me vetëm një fushë të asfaltuar dhe një sallë për kulturë sportive.

Bashkëpunimi në mes të komunës së Kaçanikut dhe klubeve sportive është i mirë. Gjatë vitit 2002 dhe 2003, nga organet komunale, klubeve të komunës u janë nda një shumë materiale prej 32000 €.

I.5. VENDBANIMET

5.1. Tipologjia e vendbanimeve sipas madhësisë

Trajtimi i vendbanimeve në planet zhvillimore komunale është i domosdoshëm dhe kyç ngase i tërë aktiviteti dhe organizimi i jetës së shoqërisë njerëzore ka qenë dhe është i lidhur për to. Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte. Kurse vendbanimi më i vogël zakonisht tregon të kundërtën e asaj të parës.¹³ Pikërisht nga kjo arsye vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë populatave dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejshëm të komunës apo edhe më gjerë.

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në Komunën e Kaçanikut mund t'i kategorizojmë në:

vendbanimet e vogla rurale, të mesme rurale, të mëdha rurale dhe vendbanimet e karakterit urban.

Në bazë të regjistrimit të fundit të numrit të popullsisë nga DGK dhe komuna, të vitit 2009, në grupin e vendbanimeve të vogla deri në 500 banorë mund të grupohen 9 vendbanime, nga 29 sa janë gjithsej në territorin e komunës (në këtë rast trajtohen 31 vendbanime në 29 komuna kadastrale); Gjurgjedelli 235 banorë, Drenogllava 54 banor, Gërlica e Epërme 432 banorë, Korbliqi 153 banorë, Nikoci 7 banorë, Semaja 249 banorë, Sllatina 189 banorë, dhe Strazha 271 banorë.

Në kategorinë e dytë të vendbanimeve të madhësisë 500-999 banorë janë 10 vendbanime; Bajnica 610 banorë, Duraj-Gabricë 703 banorë, Elezaj 547 banorë, Gajre 540 banorë, Ivaja 587 banorë, Kotlina 618, Nikaj 912, Raka 843, Runjeva 839 banorë dhe Koxhaj 980 banorë.

Në kategorinë e tretë të vendbanimeve të madhësisë 1000-1999 banorë janë 8 vendbanime; Biçeci 1620 banorë, Bobi 1669 banorë, Doganaj 1146 banorë, Dubravë-Vatë 1253 banorë, Gllaboçica 1289 banorë, Kovaçeci 1418 banorë, Soponica 1464 banorë dhe Stagova 1413 banorë.

¹³ I.Ramadani, Zhvillimi rural, Dukagjini, Pejë, 2004.

Në kategorinë e katërt të vendbanimeve të madhësisë 2000-4999 banorë janë 2 vendbanime: Kaçaniku i Vjetër 2188 banorë dhe Begraca 2495 banorë.

Në kategorinë e pestë radhitet vetëm Kaçaniku-qendër komunale me 13450 banorë. Vendbanimi Kaçanik si qendër komunale shtrihet ndërmjet masiveve malore të Sharrit dhe Karadakut, në boshtin kryesor komunikativ që lidhë Prishtinën me Shkupin, në distancën prej 50 km nga kryeqendra e Kosovës dhe 30 km nga Shkupi. Ndërsa, vet pozita e volitshme e vendbanimit rrëzë maleve malore të lartpërmendura duhej të ishte atraktive për banim që nga parahistoria.

Për shkak të kalimit të rrugës me rëndësi ndërkombëtare dhe rrjedhës së lumit nëpër këtë qendër, vendbanimi është zhvilluar përgjatë këtyre vijave-arterie dhe kjo kushtëzoi formën lineare të kësaj qendre urbane. Në aspektin hapësinor Kaçaniku i takon tipit të grumbulluar të vendbanimeve. Ndërsa në aspektin funksional është qendër e rëndësishme për territorin administrativ prej 211.40 km² dhe gravitimin e popullsisë prej 38174 banorë, të shpërndarë në 31 vendbanime.

Komuna kadastrale e Kaçanikut shtrihet në sipërfaqe prej 1568 ha, në të cilën jetojnë 13450 banorë. Zona e ndërtuar e saj arrin në 129 ha, ose 8.2% të territorit dhe, dendësia e banimit në rreth 100 b/h.

Pjesëmarrja e numrit të banorëve të Kaçanikut në raport me numrin e përgjithshëm të komunës ka ndryshuar dukshëm nga viti 1948 e deri sot. Derisa në vitin 1948 Kaçaniku si vendbanim kishte 2094 banorë, ose 12.8% të popullsisë së territorit të njëjtë administrativ, në vitin 2009 pjesëmarrja e numrit të banorëve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë së komunës arrin në 35.2% të popullsisë që jeton në këtë qendër komunale, mirëpo kjo pjesëmarrje e popullsisë urbane u rrit dukshëm me rastin e ndarjes së disa vendbanimeve që u bashkëngjitën komunës së re të Hanit të Elezit.

5. 2. Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë

Gjithashtu edhe shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë është e një rëndësie të veçantë për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës. Në bazë të kësaj analize mund të përcaktohen kahet e zhvillimit dhe organizimit të më tejme shoqëroro-ekonomik në hapësirën e caktuar. Madhësia mesatare e vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut është 1316 banorë, ndërsa nëse llogarisim vetëm numrin e popullsisë së vendbanimeve rurale, pa qytetin e Kaçanikut, atëherë madhësia mesatare e vendbanimeve për nga numri i popullsisë është 883 banorë. Dallimet në numrin e popullsisë të disa vendbanimeve janë të konsiderueshme, ndërsa nëse bëjmë krahasimet pa vendbanimin e Kaçanikut atëherë dallimet sillen në mes maksimumit 2495 banorë (Begraca) dhe minimumit 7 banorë (Nikoci), që është dallim shumë i madh. Këto dallime janë të kushtëzuara nga pozita e vendbanimit dhe gjeomorfologjia e terrenit. Prandaj, është me rëndësi edhe analiza e shtrirjes së këtyre vendbanimeve sipas zonave të lartësisë mbidetare.

Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve.

Karakteristikë e rrjetit të vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut është numri më i madh i vendbanimeve, i grupit të madhësisë së mesme, ndërsa, gati gjysma e territorit (viset kodrinore-malore mbi 700 m) është e banuar shumë rrallë dhe me

vendbanime të vogla. Në zonën e ulët nën 700 m ka më së shumti vendbanime të kategorisë 1000-2000 banorë (vendbanime të mesme të mëdha) 7 vendbanime nga gjithsej 8 sa janë në territorin e komunës, ose 87.5 % të kësaj kategorie, ndërsa vendbanimet e mëdha (mbi 2000 banorë) janë 3 vendbanime, duke përfshirë edhe Kaçanikun, që të gjitha shtrihen në këtë zonë.


Zona kodrinore-malore mbi 700 m karakterizohet me vendbanime të vogla të kategorisë deri 500 banorë, ose 87.5% të kësaj kategorie. Vetëm vendbanimi Gllboçicë ka 1289 banorë, që i takon kategorisë së mesme të mëdha të vendbanimeve, ndërsa Koxhaj dhe Ivaja i takojnë kategorisë së mesme të vendbanimeve që ndodhen në këtë lartësi.

Numri më i madh i vendbanimeve ka pasur rritje nga viti 1981-2009 (17 vendbanime, ose 58.6%). Vendbanimet tjera (12 vendbanime, ose 41.4%) paraqesin zona shpopulluese.

Tabela 10. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë demografike në periudhën 1981-2009*

Vendbanimet sipas kategorive të madhësisë	Numri i Vendbanimeve			
	1981	%	2009	%
0-499	12	41.4	8	27.6
500-999	8	27.6	10	34.5
1000-1999	8	27.6	8	27.6
2000-5000	-	-	2	6.9
Mbi 5000	1	3.4	1	3.4
Gjithsej	29	100.0	29	100.0


*Në tabelë gjashtë vendbanime janë përfshi në tri komuna kadastrale



Grafiku 19. Numri i vendbanimeve sipas madhësisë demografike për periudhën 1981-2009

Nga tabela dhe grafikoni shihet se vendbanimet e kategorisë së vogël deri në 500 banorë kanë pasur zvogëlim në numër, nga 12 sa ishin në vitin 1981, në 8 në vitin 2009.

Ndërsa vendbanimet e kategorisë 500-1000 banorë janë rritë në numër, nga 8 sa ishin në vitin 1981, në 10 në vitin 2009, kurse vendbanimet e kategorisë 1000-2000 banorë, mbetën në numër të njëjtë, nga 8 sa ishin në vitin 1981, mbetën prapë 8 në vitin 2009.

Harta 6. Vendbanimet sipas madhësisë në Komunën e Kaçanikut

Vendbanimet e mëdha të kategorisë 2000-5000 banorë e kanë rritë numrin nga 0 në vitin 1981 në 2 vendbanime në vitin 2009, ndërsa në kategorinë e vendbanimeve mbi 5000 banor numri ka mbetë i njëjtë në periudhën 1981-2009, në 1 vendbanim (Kaçaniku). Nga e tërë kjo shihet se ndryshimet në strukturën e vendbanimeve sipas madhësisë janë shumë të vogla.

5.3. Karakteristikat morfologjike dhe urbanistike të vendbanimeve

Kaçaniku si vendbanim urban vetëm me një pjesë të saj të vogël mund të konsiderohet me plan, ndërsa të gjitha vendbanimet e komunës së Kaçanikut janë formuar në mënyrë spontane. Forma e tyre e parregullt është si pasojë e kushteve natyrore në terren, por edhe faktorëve shoqëror-historik.

Shikuar në aspektin e strukturës morfologjike-urbanistike, dallohen këta tipa të vendbanimeve:

Tipi i grumbulluar i vendbanimeve – Karakteristikë strukturale e këtyre vendbanimeve është koncentrimi i të gjitha objekteve ndërtimore, oborreve ekonomike, rrugëve, etj. Kurse, numri më i madh i parcelave për nga madhësia e sipërfaqeve është më e vogël se në tipet tjera të vendbanimeve. Ky tip i vendbanimeve kryesisht është prezent në zonën e ulët të fushës, oborret ekonomike janë të madhësive të ndryshme, por zakonisht me sipërfaqe të vogla. Ndërsa ato janë të shfrytëzuara në mënyrë maksimale, qoftë në pjesën e përparme (kah rruga) apo në pjesën e mesme të tyre: Kaçaniku, Bobi, Duraj, Gabrrica, Strazha, Dubrava, Nikaj. Nga dendësia e madhe e objekteve dhe ekonomive familjare që mbretëron në këto vendbanime shpesh paraqiten vështirësi në mirëmbajtjen dhe sigurimin e higjienës. Në këto vendbanime është e theksuar qartë zona e ndërtimit. Në bazë të konsultimit të një numri të hartave topografike dhe kadastrale të territorit të komunës, është vlerësuar se shumica e këtyre vendbanimeve kanë pozitë të përshtatshme në raport me komunat e tyre kadastrale, rrugët publike i prekin shumicën e këtyre

vendbanimeve ose janë afër tyre, prandaj ato janë të lidhura mjaft mirë mes veti, si dhe, me qendrat tjera të rendit më të lartë.

Te këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë vijës së asfaltuar të fshatit me karakter rendor të objekteve. Kjo ndodh jo për arsye ekonomike (zgjerim apo avancim i ekonomive bujqësore), por kryesisht për t'u liruar nga dendësia e madhe dhe afrimi në rrugën kryesore. Ky proces mund të quhet transferimi i fshatit nga tipi grumbullor në tip rendor ose zbritja e fshatit në rrugë.

Te këto vendbanime në disa raste vërehet edhe procesi i aglomerimit ose bashkimit të tyre për shkak të zgjerimit dhe afërsisë së tyre mes veti, varësisht nga kushtet gjeomorfologjike të terrenit: Kaçanik -Bob-Kovaçec-Nikaj-Rakë-Dubravë-Soponicë-Doganaj.

Për shkak të zgjerimit të formës aglomerative në hapësirë këto vendbanime në të ardhmen nuk mund ta ruajnë kuptimin e fshatit.

Lidhur me vendbanimet e tipit të dendur mund të konstatohet se ky tip i vendbanimeve në krahasim me tipin e shpërndarë të fshatit është shumë më i përshtatshëm sepse ato paraqesin mundësitë për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës me pajisje urbane dhe objekte të standardit shoqëror.

Tipi i shpërndarë i vendbanimeve – Vendbanimet e tipit të shpërndarë janë prezent kryesisht në viset kodrinore-malore. Karakteristikë themelore e këtyre vendbanimeve është ndarja e tyre në lagje të banimit në tërë territorin e fshatit.

Këto vendbanime nuk posedojnë elemente të centralitetit, ndërsa dendësia e popullsisë është e vogël. Vendbanime të këtij tipi janë: Sllatina, Elezaj, Gërlica e Epërme, Ivaja, Kaçaniku i Vjetër, Gjurgjedelli, Koxhaj, Korbliqi, Kotlina, Nikoci (të gjitha këto vendbanime të organizuara në lagje, me më tepër se dy lagje, të ndara nga njëra tjetra). Numri i ekonomive familjare për një lagje arrin nga 2 e më shumë shtëpi, ndërsa lagjet janë të ndara nga njëra tjetra.

Numrin më të madh të këtyre vendbanimeve që moti e ka përfshirë procesi i depopullimit. Prandaj, një numër i konsiderueshëm i tyre në të ardhmen do të mbeten vetëm si toponime në hartat gjeografike. E vetmja mënyrë për t'i shpëtuar këto vendbanime nga shuarja e plotë do të ishte ndërtimi i rrugëve dhe lidhja e tyre në sistem, formimi i qendrës në ndonjë lagje apo në terren të hapur, e kjo do të ndikonte pozitivisht dhe moralisht tek popullsia e këtyre viseve që të mbeten aty.

Tipi i zgjatur (linear) – Vendbanimet e këtij tipi në formë të zgjatur i takojnë tipit të dendur dhe pak të dendur që shtrihen kryesisht përgjatë luginave dhe rrugëve nacionale ose lokale në zonën e ulët. Koxhaj, Soponica, Rakë, Stagova, Runjeva, Ivaja, Gajra.

Këto vendbanime karakterizohen me parcela më të vogla ndërtimore (oborret), ndërsa anën e tyre të ngushtë, në të shumtën e rasteve, e kanë të orientuar duke ndërtuar objektet buzë rrugës. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është se kanë tendencë të zgjerimit dhe bashkëngjijtes duke krijuar kështu korridore ndërtimore përgjatë rrugës. Një proces i tillë ka marrë hov sidomos kohëve të fundit, përkundër faktit se një trend i tillë në aspektin urbanistik dhe hapësinor është i pavolitshëm, ngase ato i përcjellin një mori problemesh e konfliktesh si dhe paraqesin pengesë në zhvillimin normal të komunikacionit.

Një numër i vendbanimeve të tipit linear shtrihen në skajin e fushave pjellore me objekte të ndërtuara në dy fronte dhe me rrugën në mes, të cilat janë shembull i ruajtës së sipërfaqeve bujqësore dhe njëherazi më të përshtatshme në aspektin ekologjik:

Tabela 11. Popullsia dhe dendësia e banimit në zonat e ndërtuara, në hektar*

Zona	Nr. popullsisë	Zona e ndërtuar ha	Dendësia ban/ha	Nr.lagjeve	Tipi
Zona e ulët 400-700 m		ha	ban/ha		
1. Bajnica	610	12.1	50.4	2	Grumbulluar
2. Begraca	2495	68.7	36.3	11	Shpërndarë
3. Biçeci	1620	38.6	42.0	10	Grumbulluar
4. Bobi	1669	40.5	41.2	4	Grumbulluar
5. Doganaj	1146	35.6	32.2	11	Dendur
6. Dubrava-Vata	1253	40.2	31.2	8	Dendur
7. Duraj-Gabrricë	703	30.0	23.4	2	Grumbulluar
8. Elezaj	547	19.7	27.7	9	Shpërndarë
9. Gajre	540	12.9	41.8	6	Grumbulluar
10. Kaçaniku	13450	129.5	103.8	-	Grumbulluar
11. Korbliq	153	10.3	14.8	6	Shpërndarë
12.Kovaçec	1418	28.9	49.1	6	Grumbulluar-
13.Nikaj	912	23.4	38.9	-	zgjatur
14. Raka	843	34.5	24.4	5	Grumbulluar
15. Runjeva	839	15.9	52.7	3	zgjatur
16. Saponica	1464	32.1	45.6	7	Grumbulluar-
17.Stagova	1413	35.9	39.4	10	zgjatur
18. Kaçaniku i Vjetër	2180	62.5	33.9	8	Shpërndarë
19.Koxhaj	980	34.3	28.6	8	Zgjatur
Zona kodrinoro-malore mbi 700 m					
20. Gjurgjedelli	235	12.2	19.3	7	Shpërndarë
21. Drenogllava	54	3.3	16.4	2	Shpërndarë
22. Gllaboçica	1289	34.3	37.6	5	Grumbulluar
23.Gërlica Epërme	434	13.1	33.1	2	Shpërndarë
24. Ivaja	587	18.6	31.5	6	Shpërndarë
25.Kotlina	618	16.7	37.0	4	zgjatur
26.Nikoci	7	1.0	7	-	Shpërndarë
27.Semaja	249	15.0	16.6	2	Shpërndarë
28.Sllatina	189	12.2	15.5	6	Shpërndarë
29.Strazha	271	11.0	24.6	2	Grumbulluar

Këtij tipi i takon; Sllatina afër lumit, Gajra, Runjeva, Saponica.

Nga tabela shihet se vendbanimet të cilat shtrihen në zonën nën 700 metra të lartësisë mbidetare kanë dendësi mjaft të lartë, ndërsa Kaçaniku si qendër e karakterit urban dallohet për nga dendësia e banimit nga vendbanimet tjera, por dendësia është e mundur që edhe më tej të rritet. Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, vetëm 8.4 km², ose 3.98 % është zonë e mbuluar nga vendbanimet.

5.4. Funksionaliteti i vendbanimeve


Sistemin e vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut e përbëjnë 30 vendbanime rurale dhe 1 qendër urbane të organizuara në 29 komuna kadastrale. Funksionaliteti i këtij sistemi mbështet aktivitetin në arritjen e zhvillimit ekonomik dhe koncentrimin e popullsisë. etj.

Vendbanimet e komunës së Kaçanikut mund t'i klasifikojmë sipas funksioneve themelore në këto tipe:

- vendbanimet rurale primare,
- vendbanimet me qendrën rurale,
- qendra komunale.

Në grupin e vendbanimeve primare të komunës hyjnë ato vendbanime në të cilat jetojnë prodhuesit bujqësorë dhe pa kurrfarë funksione eksterne ndaj vendbanimeve përreth. Në këto vendbanime zhvillohen vetëm ato funksione interne të cilat shërbejnë për përmbushjen e nevojave të përditshme të popullsisë së atij vendbanimi. Këto vendbanime paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë dhe njëkohësisht i takojnë kategorive më të vogla të fshatrave. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrës dhe në viset kodrinore-malore, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë, transformimi i vogël, lidhje e dobët me qendrën dhe në fund zbrazja e tyre graduale. Këto vendbanime në të ardhmen do t'i përcjellin ndryshimet e mëdha, kuptohet në aspektin negativ, veçanërisht ato vendbanime të cilat kanë më pak se 500 banorë, sepse shumica prej tyre ka pasur zvogëlim të numrit të popullsisë: Gjurgjedelli, Drenogllava, Korbliqi, Nikoci, Semaja, Sllatina, Strazha.

Harta 7. Organizimi administrativ i komunës së Kaçanikut



Procesi i zbrazjes së territoreve kodrinore-malore në mënyrë spontane, sidomos në periudhën e pasluftës dhe zgjerimi i vendbanimeve dhe koncentrimi i popullsisë në zonat e rrafshëta të cilat edhe ashtu kanë dendësi të madhe të popullsisë, mund të ketë pasoja negative në aspektin strategjik dhe konvencional për të ardhmen e komunës dhe Kosovës në tërësi. Prandaj, nga kjo konsiderojmë se patjetër duhet gjetur forma dhe mënyra për të ndaluar këtë proces. Kjo mund të realizohet me zhvillimin e turizmit rural, stimulimin e prodhimit të bujqësore, (blegtorinë) me organizim dhe teknologji bashkëkohore. Lidhjen e vendbanimeve me ndërtimin e rrugëve (rruga është parakusht për ekzistencën e këtyre vendbanimeve), etj. Ndryshimin e skemës së organizimit funksional përmes organizimit dhe zhvillimit të qendrave dhe bashkësive rurale. Pastaj, pajisjen e këtyre vendbanimeve me funksione të domosdoshme me të cilat do të përmbushin nevojat e përditshme të popullsisë.

Si vendbanime primare janë edhe një numër i fshatrave pranë qytetëse me numër të konsiderueshëm të popullsisë jobujqësore që punojnë në qytet dhe funksionojnë të lidhura me qytetin.

Vendbanimet me qendrën rurale.- Janë bërthama initiale organizative të cilat i bashkojnë dy e më tepër vendbanime primare në një tërësi shoqëro-ekonomike dhe hapësinore. Në këto vendbanime, përveç funksioneve interne, janë të zhvilluara edhe funksionet e eksterne të cilat u shërbejnë edhe popullsisë së vendbanimeve përreth. Këto vendbanime njëherazi paraqesin njësitë polarizuese të zonës në hapësirë.

Nga funksionet shoqërore, në këto vendbanime ndodhet bashkësia lokale dhe zyra e vendit, shkolla fillore, ambulanca, shitoret me shumicë e pakicë për furnizimin e popullsisë, ndonjë veprimtari zejtare, etj. Këto vendbanime paraqesin tip kalimtar nga ato tradicionale-bujqësore, në të përziera, sepse në to jeton një numër i konsiderueshëm i popullsisë jobujqësore. Një numër i konsiderueshëm i këtyre vendbanimeve ndodhet jo larg qyteteve. Ato i karakterizon një shkallë mjaft e lartë e transformimit por edhe deagrarizimit. Numri i këtyre vendbanimeve në komunë arrin në 5, ose 16.6% nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve, (Gllloboçica, Ivaja, Vata, Doganaj, dhe Kaçaniku i Vjetër)

Në këto vendbanime vetëm se janë paraqitur shenjat e semi-urbanizimit si pasojë e veprimit të faktorëve urban, në një anë dhe prodhimit të modernizuar të bujqësisë në anën tjetër. Shumica e këtyre vendbanimeve i takojnë kategorisë së madhësisë së mesme (1.000-.2.000 banorë) Gllloboçica, Doganaj, Vatë. Kurse mbi 2000 banorë ka vetëm Kaçaniku i Vjetër. Në këto vendbanime gravitojnë mesatarisht 4 944.8 banorë

Sa i përket vendbanimeve pranë-qytetëse ato paraqesin zona sub-urbane me karakteristika të veçanta:

- karakterizohen me shkallë të lartë të transformimit.
- kanë shkallë të ulët të autonomisë për shkak të varësisë nga qendra urbane,
- shkalla e deagrarizimit të popullsisë është mjaft e shprehur. Këtij grupi i takojnë vendbanimet; Bobi, Runjeva, Kovaçeci.

Prandaj, këto vendbanime nuk duhet t'i lihen stihisë siç ka ndodhur deri tani, sepse ato shndërrohen në barriera të cilat do të paraqesin pengesa në zgjerimin e mëtejshëm të qytetit.

Në grupin e vendbanimeve urbane bën pjesë vetëm Kaçaniku si qendër komunale, në të cilën janë të vendosura funksionet që shërbejnë tërë territorit, funksionet shoqërore-ekonomike.

5.5. Rrjeti i vendbanimeve

Rrjetin e vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut e përbëjnë 31 vendbanime prej të cilave 1 vendbanim është i karakterit urban, (Kaçaniku) me 13450 banorë ose 35.2% dhe 30 vendbanimet tjera janë rurale, me numrin e popullsisë prej 24724 banorë ose 64.8% të popullsisë, në vitin 2009. Madhësia mesatare e vendbanimeve është 1231.4 banorë, në vitin 2009, ndërsa dendësia mesatare e popullsisë arrin në 173.5 banorë në km², por me dallime të mëdha, varësisht nga karakteristikat gjeo-morfologjike të terrenit. (shiko hartën dhe tabelën)

Harta 8. Rrjeti i vendbanimeve





Tabela 12. Rrjeti i vendbanimeve dhe dendësia e popullsisë në km²*

Kodi	Vendbanimi	Nr. Popullsisë	Sip/km2	Dendësia b/km2
70917048	Kaçanik - Llanishtë	13450	15.68	857.78
70917002	Bajnicë	610	3.39	179.94
70917003	Begracë	2495	11.52	216.58
70917007	Biçec	1620	18.09	89.55
70917008	Bob	1669	3.86	432.38
70917026	Doganaj	1146	3.5	327.43
70917032	Drenogllavë	54	3.48	15.51
70917035	Duraj – Gabrricë	703	1.84	382.06
70917038	Elezaj	547	2.77	197.47
70917016	Gajre	540	3.48	155.17
70917021	Gërlica e Epërme	432	1.28	337.50
70917037	Gjurgjedell	235	12.93	18.17
70917018	Glloboçicë	1289	13.03	91.35
70917041	Ivajë	587	8.17	71.84
70917086	Kaçanik i Vjetër	2188	9.8	223.26
70917050	Korbliq	153	16.06	9.52
70917052	Kotlinë	618	10.62	58.20
70917049	Kovaçec	1418	5.28	268.56
70917093	Koxhaj	980	2.58	379.84
70917064	Nikaj	912	3.18	286.80
70917074	Rekë	843	2.28	369.73
70917065	Nikoc	7	4.91	1.42
70917075	Runjevë	839	6.38	131.50
70917078	Semajë	249	2.61	95.40
70917080	Sllatinë	189	20.78	9.10
70917083	Soponicë	1464	3.13	464.73
70917085	Stagovë	1413	11.73	120.46
70917088	Strazhë	271	4.65	23.59
70917012	Dubravë – Vatë	1253	3.9	321.28
Total		38174	211.40	181.0

Harta 9. Vendbanimet dhe dendësia e popullsisë



Dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Kaçanikut ku mesatarisht jetojnë rreth 857.78 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe, siç janë: Soponicë (464 b/km²), Bob (432 b/km²). Duraj - Gabrrica (382 b/km²), Koxhaj (379 b/km²), Rekë (369 b/km²). Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Nikoci (1.4 b/km²), Sllatina (9.1 b/km²), Korbliqi (9.5 b/km²).

Vendbanimet që kanë dendësi më të vogël të popullsisë janë kryesisht vendbanime që gjenden më larg qendrës urbane të Kaçanikut, shtrihen në lartësi më të mëdha mbidetare, kanë mungesë të shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme, andaj edhe numri i popullsisë është më i vogël si dhe rreziku nga depopullimi është më i madh.

a) Në zonën e ulët në mes të izohipsave 400-700 metra të lartësisë mbidetare shtrihen 18 vendbanime ose 62.1% nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve të komunës, me numër mesatar të popullsisë prej 1847.5 banorë për vendbanim dhe dendësi mesatare prej 410.9 banorë në km². Kjo njëherazi është edhe hapësira me dendësi më të madhe në komunë (2.3 herë më e lartë se mesatarja e komunës dhe 79.3 herë më e lartë se në viset kodrinore malore).

b) Në hapësirën kodrinore-malore, mbi 700 metra të lartësisë mbidetare, shtrihen 11 vendbanime ose 37.9 % të vendbanimeve të komunës, me dendësinë e popullsisë prej 21.8 banorë në km² dhe, njëkohësisht, kjo zonë paraqet territorin më rrallë të banuar në komunë.

Me rëndësi të veçantë, në këtë rast do të ishte edhe analiza e dendësisë hapësinore të vendbanimeve dhe largësia mesatare e tyre. Dendësia mesatare e vendbanimeve në komunë është 14.7 vendbanime në 100 km² (në Kosovë 13,22 vendbanime në 100 km²). Në dendësinë e rrjetit të vendbanimeve janë të dukshme dallimet varësisht nga pozita apo gjeo-morfologjia e terrenit. Në zonën 400-700 metra të lartësisë mbidetare, dendësia e vendbanimeve është 21 vendbanime në 100 km².

Në zonën mbi 700 metra të lartësisë mbidetare dendësia e vendbanimeve arrin në 8.2 vendbanime në 100 km, ose 2.6 herë më pak se në zonën e ulët. Dendësia e rrjetit të vendbanimeve shprehet edhe përmes largësisë hapësinore të vendbanimeve. Andaj në bazë të kësaj, largësia mesatare ndërmjet vendbanimeve në nivel komunal është 2.6 km, që është pothuajse e barabartë me Rrafshin e Kosovës.

Tabela 13. Dendësia dhe distanca mesatare e vendbanimeve në komunë

Hapësira	Dendësia e vendbanimeve në 100 km ²	Distanca mesatare
Hapësira kodrinore - malore	8.2	3.5
Hapësira nën 700 metra lartësi mbidetare	21	2.2
Komuna	14.7	2.6

Në viset kodrinore malore largësia është 3,5 km dhe në hapësirën nën 700 metra të lartësisë mbidetare largësia është 2,2 km (në Kosovë 2,76 km).

Vendbanimet të cilat shtrihen në zonën e ulët nën 700 metra të lartësisë mbidetare kanë arritur një shkallë mjaft të lartë të zhvillimit dhe transformimit të tyre. Vendbanimet të cilat shtrihen në viset kodrinore-malore kanë mbetur të pazhvilluara, pa institucione dhe shërbime elementare, e me tendenca të zbrzjes së tyre.

5.6. Karakteristikat e vendbanimeve sipas zonave

Në këtë rast, e një rëndësie të veçantë do të ishte diferencimi morfologjik i territorit të caktuar, përmes të cilës komponentë pasqyrohen mundësitë dhe kahet e zhvillimit të më tej. Hapësirën e komunës e përbëjnë tri tërësi morfologjike që dallojnë nga njëra-tjera në bazë të karakteristikave gjeografike natyrore:

zona fushore-bregore nën 700 metra lartësi mbidetare, me sipërfaqe prej 85.84 km² ose 39.02% të hapësirës së gjithëmbarshme të komunës,

zona kodrinore-malore 700-900 metra të lartësisë mbidetare, e cila përfshin sipërfaqen prej 65.96 km² ose 29.98 % të komunës dhe

zona malore > 900 metra lartësi mbidetare, me sipërfaqe prej 68.4 km² ose 31.09%.

Zona kodrinore-malore zë pozitën lindore dhe perëndimore të komunës, është kryesisht e pazhvilluar, me karakteristika të shpopullzimit ose stagnuse. Zona e ulët fushore shtrihet në veri të qytetit të Kaçanikut që kufizohet në lindje me malet e Sharrit dhe në

perëndim me malet Karadakun, e cila ka veçori tjera demografike dhe kushte më të volitshme për zhvillim. Këto parametra tregojnë edhe për pozitën e territorit të ekspozuar veri-perëndimit, që është një komponentë e rëndësishme në planifikimin hapësinor.

Për të vërtetuar konstatimin e mëparshëm se hapësira kodrinore-malore është pjesa më e pazhvilluar e komunës, do t'i analizojmë më hollësisht vendbanimet në aspektin demografik dhe funksional sipas shtrirjes zonale, ngase sa më atraktive që do të jetë një hapësirë, ajo do të jetë edhe më e populluar dhe anasjelltas.¹⁴

Që në fillim duhet theksuar se zona e ulët karakterizohet me dendësi të madhe të popullsisë në të cilën dominojnë vendbanimet e kategorisë së mesme dhe të mëdha prej 500 deri në mbi 10 000 banorë. Kjo tërësi hapësinore në kuptimin demografik është më stabile, sepse procesi i shpërnguljes së popullsisë së këtyre vendbanimeve drejt qendrave urbane është në rrjedhat normale. Në anën tjetër, rritja popullore e vendbanimeve dhe transformimi fizik i tyre është shumë më i shpejtë në krahasim me vendbanimet kodrinore-malore.

Tabela 14. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë*

Kategoria e madhësisë	Gjithsej vendbanime		Zona nën 700 m		Zona mbi 700 m	
	1981	2009	1981	2009	1981	2009
0-499	11	8	4	1	7	7
500-999	10	10	6	7	4	3
1000-1999	7	8	7	7	-	1
2000-5000	-	2	-	2	-	-
Mbi 5000	1	1	1	1	-	-
Gjithsej	29	29	18	18	11	11

* Në tabelë gjashtë vendbanime janë përfshi në tri komuna kadastrale

Nga tabela shihen ndryshime të rëndësishme në strukturën e vendbanimeve në zonën e ulët nën 700 metra, në të cilën është ndryshuar struktura e vendbanimeve sipas madhësisë, nga 11 vendbanime të vogla, sa ishin në vitin 1981, ka rënë numri në 8 vendbanime të kësaj kategorie në vitin 2009, ndërsa numri i vendbanimeve të mëdha (1000-2000 banorë) është rritë nga 7 sa ishin në vitin 1981, në 8 vendbanime në vitin 2009. Vendbanimet nga 2000 deri 5000 banor janë rritë nga 0 në vitin 1981 në 2 vendbanime në vitin 2009. Ndërsa numri i vendbanimeve me mbi 5000 banorë ka mbetë i njëjtë, vetëm 1 vendbanim (Kaçaniku).

Në zonën kodrinore-malore (mbi 700 metra) gjendja ka ndryshuar vetëm në një vendbanim që kalon në grupin e kategorisë së mesme (Gllloboçica).

Sa i përket hapësirës kodrinore-malore, karakteristikat gjeo-ekologjike të tyre kanë vlera të kundërta me ato të rrafshit të Kosovës.¹⁵ Në këto hapësira dominojnë kryesisht vendbanimet e vogla, deri 500 banorë, (me ndonjë përjashtim, Gllloboçica) dhe, ato të tipit

¹⁴ . K. Doksiadis, *Çovek i grad*, Nolit, Bgd, 1982, f. 71.

¹⁵ . R. Çavolli, *Gjeografia regjionase e Kosovës*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë 1997, f. 127-140.

të shpërndarë, të cilat dita ditës po e humbin popullsinë deri në zbrazje të përgjithshme të tyre.

Në tabelën vijuese do të paraqiten disa nga indikatorët themelorë të hapësirës kodrinore-malore të komunës (mbi 700 m), në të cilën hapësirë komuna ka pjesëmarrje të konsiderueshme, me gjithsej 134 km² ose 61% të hapësirës së komunës,

Tabela 15. Indikatorët themelorë të hapësirës Kodrinore-malore, mbi 700m, periudha 1981-2009

Komuna	Sipërf. e përgjith. e komunë në km ²	Sipërfaqe kodrinore malore mbi 700m	Gjithsej nr. popullsisë në komunë	Nr. popull. kodrin-malore	Pjesëmarrja në %	Nr. i vendba. gjithsej në komunë	Nr.i Venban. kodrinore malore
1981	210.90	134 km	24822	4545	18.3	29	11
2009	211.40	134 km	38174	2919	7.6	29	11

Në hapësirën kodrinore-malore (mbi 700 metra) të komunës, në vitin 1981 kanë jetuar 4545 banorë, ose 18.3% e popullsisë së komunës. Nga gjithsej 29 vendbanime të komunës në vitin 1981, në hapësirën kodrinore-malore kishte 11 vendbanime, ose 37.9%. Ndërsa në vitin 2009 në hapësirat kodrinore-malore jetojnë 2919 banorë, respektivisht 7.6 % të popullsisë së komunës, ose 1. herë më pak se në vitin 1981.

Për të treguar vlerën e një hapësire, rëndësi të veçantë ka analiza e dendësisë së popullsisë, qoftë relative, qoftë rurale apo agrare.¹⁶


Në tabelën vijuese do të bëjmë krahasimin e dendësisë së popullsisë në mes dy hapësirave kryesore të territorit të Komunës.

Tabela 16. Dendësia e popullsisë sipas zonave të lartësisë mbidetare në komunë në vitin 2009

Zonat e komunës	Dendësia relative km ²	Dendësia rurale km ²	Sipërfaqja në km ² për një vendb.	Dendësia mesatare e vendbanimeve në 100 km ²
400-700 m	410.9	333.6	4.7	21.0
Mbi 700 m	-	21.8	12.2	8.2
Komuna	173.5	121.2	7.6	21.6

Vlerat e dhëna në tabelën 29 tregojnë se dendësia relative e popullsisë së hapësirës kodrinore- malore është mjaft e vogël në krahasim me atë të zonës së ulët dhe në nivel të komunës, por që në kohët e fundit, kjo po merr përmasa shqetësuese. Tani dendësia e popullsisë së viseve kodrinore-malore është 18.8 herë më e vogël se ajo e zonës së ulët dhe 8.0 herë më e ulët se mesatarja e komunës. Në periudhën 1948-1981 këto diferenca ishin shumë më të vogla.

¹⁶ A. Pushka, "Aspekte gjeopopullative në Kosovë", f. 237. Shih edhe D. Simonovic, Uredjenje seoskih teritorija, f. 43

Harta 10. Shtrirja e vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare në Komunën e Kaçanikut

Duhet theksuar gjithashtu se këto hapësira janë lënë anash në aspektin e zhvillimit ekonomik, kurse qyteti dhe qendrat e zhvilluara ndodhen në hapësirën nën 700 metra të lartësisë mbidetare. Prandaj, shumica e objekteve ekonomike dhe të funksioneve qendrore janë përqendruar në qytet. Gjithashtu edhe potenciali demografik është më i lartë rreth qytetit, ndërsa duke shkuar nga periferia ky potencial zvogëlohet. Në këtë mënyrë, bërthamat urbane me potencialin e tyre demografik paraqesin "kupa" në "profilin popullativ" të regjionit.¹⁷ Duke u larguar nga qendra, potenciali popullativ gjithnjë e më tepër arrin vlerat më të ulëta dhe në këtë mënyrë, përfundon ndikimi i qendrës, ku mund të tërhiqet vija ndarëse e regjionit të qytetit në bazë të parimit të gravitetit popullativ.


Nga hulumtimet është vërtetuar se vendbanimet të cilat ndodhen sa më afër qendrës komunale, aq më i madh është ndikimi i kësaj qendre në rritjen e popullsisë së tyre. Me rritjen e distancës prej qendrës komunale kryesisht vjen deri te zvogëlimi i indeksit të rritjes së popullsisë. Kjo rregull është më e shprehur në komunat të cilat njëkohësisht kanë qendër më të madhe urbane.¹⁸ Nga këto shkaqe një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve pranë-qytetëse e kanë rritur dukshëm numrin e popullsisë së tyre, nga

¹⁷ M. Vresk, *Po aty*, f. 78

¹⁸ A. Pushka, *po aty*, f. 237.

arsyeja se nuk kanë pasur emigrim të shprehur të popullsisë në drejtim të qendrave tjera ose kanë pranuar emigrant nga vendbanimet kodrinore-malore.

Nëse e vështrojmë koncentrimin e popullsisë në raport me sipërfaqen, atëherë mund të konstatohet se përqendrimi i popullsisë, sidomos në zonën e ulët, ka arritur një shkallë mjaft të lartë. Derisa 39.0% e sipërfaqes së komunës gjendet nën 700 metra të lartësisë mbidetare, në këto hapësira në vitin 1981 jetonin 20277 banorë ose 81.7% e popullsisë së komunës, kurse pjesëmarrja e sipërfaqeve mbi 700 metra të lartësisë mbidetare është 60.9%. Mirëpo në këto sipërfaqe jetonin vetëm 18.3% e popullsisë së komunës, që është si pasojë e kushteve të ndryshueshme natyrore në mes këtyre dy hapësirave dhe aktivitetit të njeriut, i cili është i lidhur kryesisht për hapësirat më të përshtatshme të komunës ku e ka zhvilluar aktivitetin ekonomik. Rritja popullore e komunës gjithashtu është e kushtëzuar edhe nga rrethanat historike të zhvillimit shoqëroro-ekonomik, nga veprimi i faktorëve biologjik, socio-ekonomik, ekologjik, kulturor e social, të cilët drejtpërdrejtë shprehen në mënyrën dhe formën e organizimit të vendbanimeve. Kështu, vendbanimet si qendra të aktivitetit të përgjithshëm njerëzor, krahas ndryshimeve shoqëroro-ekonomike, në mënyrë të vazhdueshme e ndryshojnë edhe fizionominë e tyre, madhësinë, funksionalitetin dhe ndikimin e tyre në rrethinë dhe më të gjerë.



Grafiku 20. Pjesëmarrja e sipërfaqeve, popullsisë dhe e vendbanimeve në vitin 2009 sipas lartësisë mbidetare

Grafiku pasqyron raportet mes pjesëmarrjes së popullsisë, sipërfaqeve dhe vendbanimeve në zonat e territorit të komunës sipas lartësisë mbidetare.:

Brezi më i ulët i hapësirës së komunës, në mes izohipsave 400-700 metra të lartësisë mbidetare, përfshin pjesën e rrafshët të komunës dhe luginat e lumenjëve, në sipërfaqe prej 85.8 km², në të cilën jetojnë 35251 banorë (39% të territorit dhe 91.7% të popullsisë), e vendosur në 18 vendbanime, të cilat shtrihen pranë qendrës komunale dhe pranë rrugës nacionale Prishtinë-Shkup. Karakteristikë e përgjithshme e këtyre vendbanimeve është rritja e vazhdueshme popullore dhe zgjerimi hapësinor i vendbanimeve, me tendencë të bashkimit të tyre. Këto vendbanime i ka përfshi procesi intensiv i deagrarizimit, por nuk i ka përcjellë sa duhet procesi i urbanizimit.

Hapësira kodrinore malore (mbi 700 m) përfshin pjesën perëndimore të komunës me një sipërfaqe prej 134 km² dhe me 2919 banorë (61% të territorit ose mbi gjysma e territorit të komunës dhe vetëm 7.6% të popullsisë së komunës) të shpërndarë në 11 vendbanime. Vendbanimet kodrinore-malore shtrihen në lartësi mbidetare mbi 700 metra, të cilat

disponojnë pasuri të konsiderueshme të pyjeve e kullosave, por ndihet mungesë e sipërfaqeve bujqësore. Edhe ato sipërfaqe që i disponojnë janë të kualitetit të dobët dhe janë nën ndikimin e procesit të erozionit. Këto vendbanime janë të tipit të shpërndarë dhe gjysmë të dendur, të ndara në lagje, larg njëra-tjetrës, të vendosura në shpate të përshtatshme, rrafshje dhe anët e përrenjve malor.

Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është emigrimi i konsiderueshëm i popullsisë në drejtim të viseve të ulëta për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore, mungesës së objekteve të standardit jetësor dhe lidhjes së dobët me qendrat e tyre. Veprimtaria themelore e tyre është blegtoaria dhe pylltaria e më pak lavërtaria. Prandaj, të gjitha këto vendbanime kanë karakter agrar.

5.7. Banimi në Komunën e Kaçanikut

Në Komunën e Kaçanikut, sipas shënimeve më të reja të siguruara nga institucionet komunale dhe regjistrimit të numrit të popullsisë nga kompania DGC, jetojnë 38174 banorë në sipërfaqe prej 211.40 km².

Pjesa dërmuese e popullsisë në Komunën e Kaçanikut jeton në fshat, 64.7 % e popullsisë. Vetëm 35.3 % e saj jeton në qendrën e vetme urbane të kësaj komune me qendër, në Kaçanik.

Dominon banimi i karakterit individual, pasi që, vetëm në qendrën urbane janë të ndërtuara një numër i vogël i banesave shumëfamiljare, të karakterit kolektiv. Numri i përgjithshëm i objekteve të banimit në kuadër të komunës së Kaçanikut është rreth 7700, nga e cila shumë, 5880 objekte, ose 75.7 % janë të ndërtuara në zonat rurale, 1890 objekte të banimit, ose 24.3 % e tyre janë të ndërtuara në zonën urbane.

Raporti i banimit individual nga ai shumëfamiljarë në qytet është 85/15 %. Në zonën e ulët të fushës vendbanimet zakonisht janë të tipit të grumbulluar, prandaj edhe dendësia e banimit është më e madhe. Në viset kodrinore-malore shumica e tyre janë të tipit gjysmë të dendur, të organizuara në lagje dhe, të tipit të shpërndarë. Dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar është më e ulët. Pra, faktorët natyror (relievi) kanë ndikuar dukshëm në formën dhe dendësinë e vendbanimeve. Te vendbanimet që ndodhen afër qendrës urbane dhe atyre afër rrugëve, vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit dhe ato të bizneseve shtrihen në formë vargore. Kjo arsyetohet edhe me faktin se popullsia vazhdimisht po heq dorë nga bujqësia.

Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në zonën e ulët të fushës, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjes së hapësirës banuese, kjo hapësirë gjithashtu disponon me një fond më cilësor banesor.

Dendësia mesatare e banimit në territorin e komunës së Kaçanikut arrin në 180 banorë në një km², në territorin e k. kadastrale të qytetit arrin në 780 banorë në km², kurse në vendbanimet rurale është 121.2 banorë në km². Hapësirat me dendësi më të madhe janë rreth qendrës komunale dhe në zonën e rrafshët (Doganaj, Bob, Duraj, Gërlicë e Epërme,

Koxhaj, Rekë, Soponicë, Dubravë-Vatë), në të cilat dendësia e banimit arrin në 420 banorë në km² ku tejkalon mesataren e dendësisë së hapësirës së komunës për 2.4 herë.

Objekte të vjetra banimi ka pak sepse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur t'i përballojë kohës. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime, varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit, vendbanimet kodrinore-malore. Shumica e objekteve të banimit janë të rrethuara me mure, në oborre dallohen edhe objektet tjera ekonomike bujqësore.

Deri vonë objektet e banimit ndërtoheshin me material të dobët; qerpiçi dhe druri, që zakonisht forma e objekteve i ngjante shkronjës L dhe T. Në këto dy dekadat e fundit objektet e banimit ndryshuan tërësisht si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, të zakonshëm janë kulmet me dy ujëra, ndërsa me material ndërtimor si; tulla, blloka të pjekur, betoni e hekuri. Kështu që, objektet e ndërtuara të banimit në fshat fare pak dallojnë me ato në qytet. Nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit.

Dendësia e banimit në zonën e ndërtuar, në vendbanimet rurale, është dukshëm më e ulët, në raport me qendrën komunale dhe këto vlera sillen rreth 40 banorë në ha. Ndërsa, në qendrën e vetme urbane, në Kaçanik, dendësia e banimit arrin në 103 banorë në ha (është llogaritur vetëm zona e banimit), që gjithashtu është dendësi që duhet të rritet.

Gjendja e banimit në vendbanimet rurale dhe në vet qytetin e Kaçanikut u dëmtua rëndë në luftën e fundit, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i madh i objekteve të banimit dhe ekonomike, ndërsa pasojat po evitohen ngadalë.

Hapësira e banimit në raport me sipërfaqet e ndërtuara është dominante, me 90 % në raport me zonën e ndërtuar në nivelin komunal, në vet qytetin e Kaçanikut, ajo dominon me rreth 85 %. Kjo tregon se aktivitetet tjera janë në nivel shumë të ulët të zhvillimit të tyre.


Numri i anëtarëve për ekonomi familjare varion nga 7 anëtarë në vendbanimet rurale, në 6.4 anëtar në qendrën urbane, mesatarja e numrit të anëtarëve për ekonomi familjare në nivelin komunal sillet në 6.7 anëtarë. Kjo është si pasojë e jetës së përbashkët të dy e më shumë gjeneratave në një ekonomi familjare, kjo gjendje e rëndon standardin jetësor. Sipërfaqja e banimit për banorë është me sa vijon; 17.8 m² për anëtarë në vendbanimin urban dhe 17.5 m² për anëtarë në vendbanimet rurale.

5.8. Vendbanimet joformale

Institucionet komunale, në bashkëpunim me ekipin për përpilimin e planit zhvillimor komunal kanë identifikuar vendbanime joformale që duhet trajtuar urgjent:

Pjesa e lagjes "Agim Bajrami"/Kaçanik, Lokaliteti Kashan, Lagjja "Ramadan Agushi", Fshati Strazhë, Pjesë e lagjes "Dushkaja"1, Pjesë e lagjes "Dushkaja"2.

Harta 11. Vendbanimeve jo formale



1. Pjesa e lagjes "Agim Bajrami"/Kaçanik
(dy familje rome në qytet jetojnë në shtëpi të 9 familjeve tjera rome që janë zhvendosur jashtë vendit, në një apartament).

- është vendbanim i cili gjendet në zonën urbane,
- vendbanim afër zonës rrëshqitëse,
- popullata e këtij vendbanimi të gjithë janë shqiptarë,
- uji nuk është në rrjet të qytetit, kanalizimi derdhet në natyrë (lumi Lepenc),
- rruga është e paasfaltuar,
- grumbullimi i mbeturinave nuk është në sistem,
- shkolla është në largësi 1,4 km,
- ambulanta është në largësi 1,5 km,
- çerdhja është në largësi 1,30 km,
- shtëpia e kulturës është në largësi 1,5 km,

Prioritete për këtë vendbanim janë: asfaltimi i rrugës, ndërtimi i mureve mbajtëse për stabilizimin e kësaj pjese, rregullimi i kanalizimit, etj.

2. Lokaliteti Kashan

- është vendbanim i cili gjendet në zonën rurale,
- popullata e këtij vendbanim të gjithë janë shqiptarë,

- nuk ka infrastrukturë fizike të organizuar, furnizimi me ujë bëhet në mënyrë individuale, kanalizimi i pa organizuar, hedhja e mbeturinave në natyrë,
- rruga është e paasfaltuar,
- nuk ka shkollë, çerdhe as shtëpi të kulturës, të gjitha janë në një largësi prej 6 km.
- rrugë e paasfaltuar,
- popullata e këtij vendbanimi merren me aktivitete të ndryshme si: me bujqësi, blegtori,
- disa edhe me ndihma sociale, etj.

Prioritete për këtë vendbanim janë rregullimi i kanalizimit, ujësjellësit, asfaltimi i rrugës, ndërtimi i shkollës, etj.

3. Lagjja “Ramadan Agushi”

- është vendbanim i cili gjendet në zonën urbane
- vendbanim afër zonës rrëshqitëse,
- popullata e këtij vendbanimi të gjithë janë shqiptarë,
- kanalizimi i paorganizuar derdhet në natyrë në lumin Lepenc, ujësjellësi i këtij vendbanimi është në rrjet të qytetit, mbeturinat janë në sistem nga “Pastërtia”, rruga është e pakategorizuar,
- shkolla është në largësi 1,6 km,
- ambulanta është në largësi 1,6 km,
- çerdhja është në largësi 1,5 km,
- popullata e këtij vendbanimi merren me veprimtari të ndryshme si: afariste, tregtare, arsim, ka edhe me ndihma sociale, etj.

Prioritete për këtë vendbanim janë ndërtimi i mureve mbajtëse për stabilizimin e gjendjes, rregullimi i kanalizimit, asfaltimi i rrugës, etj.

4. Fshati Strazhë

- është vendbanim i cili gjendet në zonën rurale
- popullata e këtij vendbanimi të gjithë janë shqiptarë
- rruga është në nivel mesatar – e paasfaltuar
- furnizimi me ujë i organizuar – në sistem
- kanalizimi jo në rrjet të organizuar
- grumbullimi i mbeturinave – nuk është në sistem
- shkollë ka dhe funksionon
- ambulante ka
- çerdhe s’ka

Popullata e këtij vendbanimi merren me veprimtari të ndryshme si: bujqësi, blegtori, arsim, ka edhe me ndihma sociale, etj.

Prioritete për këtë vendbanim janë caktimi i statusit të vendbanimeve, shtrimi i rrugëve, rregullimi i kanalizimit, etj.

5. Pjesë e lagjes “Dushkaja”1

- është vendbanim i cili gjendet në zonën urbane,
- vendbanim afër zonës rrëshqitëse (shtëpi të rrezikuara drejtpërdrejt nga rrëshqitja),
- popullata e këtij vendbanimi të gjithë janë shqiptarë,
- furnizimi me ujë i organizuar – në sistem,

- kanalizimi është në rrjet të organizuar,
- rruga është e asfaltuar, në gjendje të mire,
- shkolla është në largësi 1,0 km,
- ambulanta është në largësi 1,0 km,
- çerdhja është në largësi 1,0 km, edhe shtëpia e kulturës është po në këtë distancë

Popullata e këtij vendbanimi merren me veprimtari të ndryshme si: afariste, tregtare, arsim, ka edhe me ndihma sociale, etj.

Prioritete për këtë vendbanim janë ndërtimi i mureve mbajtëse për mbrojtje nga rrëshqitja,

6. Pjesë e lagjes “Dushkaja” 2

- është vendbanim i cili gjendet në zonën urbane,
- vendbanim afër zonës rrëshqitëse (shtëpi të rrezikuara drejtpërdrejt nga rrëshqitja),
- popullata e këtij vendbanim të gjithë janë shqiptarë,
- furnizimi me ujë i organizuar – në sistem,
- kanalizimi është pjesërisht në rrjet të organizuar,
- rruga është e kualitetit të dobët,
- shkolla është në largësi 0,6 km,
- ambulanta është në largësi 0,6 km,
- çerdhja është në largësi 0,6 km, edhe shtëpia e kulturës është po në këtë distancë,

Popullata e këtij vendbanimi merren me veprimtari të ndryshme si: afariste, tregtare, arsim, ka edhe me ndihma sociale, etj.


Prioritete për këtë vendbanim janë ndërtimi i mureve mbajtëse për mbrojtje nga rrëshqitja, rregullimi i kanalizimit,

5.9. Shfrytëzimi i tokës në Komunën e Kaçanikut

Gjithnjë në kontekstin e shfrytëzimit dhe destinimit të sipërfaqeve në nivelin komunal, duke u bazuar nga burime të ndryshme të informatave, punës në terren, si dhe llogaritjeve tona, konkludohet se territori i komunës së Kaçanikut shtrihet në sipërfaqe prej 211.40 km², në të cilat sipërfaqe jetojnë 38170 banorë. Jeta organizohet në një qendër urbane (qendra komunale e Kaçanikut) dhe 30 vendbanime rurale, të organizuara në 29 komuna kadastrale, me gjithsej 6 qendra lokale (një qendra lokale brenda në qytet).

Mbi gjysma e vendbanimeve shtrihen në zonën e rrafshët, duke përfshi edhe vet qendrën urbane të Kaçanikut, kurse zgjerimi i tyre bëhet në mënyrë të pakontrolluar, gjithnjë në dëm të sipërfaqeve bujqësore të kategorisë së lartë, si dhe përgjatë korridoreve me rëndësi strategjike. Ndërsa vendbanimet të cilat shtrihen në viset kodrinor-malore karakterizohen me rritje të ngadalshme të numrit të popullsisë ose me tendenca të shpopullimit.


Harta 12. Shfrytëzimi i tokës në Komunën e Kaçanikut



Degradimi dhe humbja e sipërfaqeve bujqësore nga ndërtimet dhe, zgjerimi i vendbanimeve është brengë e cila kërkon trajtim adekuat. Vetëm qyteti i Kaçanikut në këto dy dekadat e fundit mbulojë ose degradoi mbi 100 hektar tokë bujqësore, pa llogaritur humbjen e sipërfaqeve në vendbanimet tjera fushore. Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës shihet mënyra e përdorimit të tokës në tabelë dhe grafikon.

Tabela 17. Shfrytëzimi i tokës në hektar

Sipërfaqe	ha	%
Pyje	11381.8	53.9
Park Nacional	2473	11.7
Bujqësia	4584	21.7
Vendbanimet	849.8	4.02
Varrezat	26.7	0.1
Livadhe	282.5	1.3
Kulloja	1225.24	5.8
Djerrina	214.1	1.01
Rrugë	38	0.18
Sip.ujore	15	0.7
Gjithsej	21140	100.0



Grafiku 21. Shfrytëzimi i tokës në hektar

Në bazë të numrit të banorëve dhe potencialit të sipërfaqeve bujqësore të kategorisë I-IV, del se për një banor në Komunën e Kaçanikut bien më pak se 0.12 hektar.

Varrezat- Duke u bazuar në ligjet e aprovuara nga organet qendrore dhe lokale, konstatohet se çdo njësi organizative, sikurse edhe komuna e Kaçanikut aprovon: Rregulloren komunale për menaxhimin e varrezave.

Neni 1-Me këtë rregullore parashihen kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të varrimit si dhe rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e komunës së Kaçanikut.


Neni 25- 25.1. Çdo vendbanim i banuar mund të ketë varreza,

25.2. Dy ose ma shumë vendbanime mund të kanë varreza të përbashkëta.

Në bazë të kësaj rregullore funksionon shërbimi i varrimit dhe varrezave. Në bazë të analizave në terren grupi hulumtues ka identifikuar lokacionet e varrezave në tërë territorin e Komunës së Kaçanikut.

Në fazën vijuese të PZHK-ës dhe PZHU-së trajtohen edhe mundësitë e reja të lokacioneve si dhe mënyra e trajtimit të sipërfaqeve të nxënë me varreza si dhe nevojat për sipërfaqet e reja.

Gjendja momentale është e paraqitur në hartën në vijim me të dhëna për secilin vendbanim.

Harta 13. Lokacioni i varrezave në Komunën e Kaçanikut

I.6. KARAKTERISTIKAT FIZIKO - GJEOGRAFIKE DHE MJEDISI

6.1. Ndërtimi gjeologjik dhe mbërthimi tektonik

Në bazë të analizës së hartës gjeologjike të Kosovës si dhe fondeve dhe materialeve të tjera studimore, të kryera në territorin e komunës së Kaçanikut dhe rrethinës së saj rezultojnë këto veçori të përgjithshme të ndërtimit gjeologjik. Në ndërtimin gjeologjik të komunës së Kaçanikut marrin pjesë formacionet e Palezoiku, Triasiku, Jurasiku, Kretaku i Sipërm, Neogjenit dhe sedimentet e Kuaternarit

6.2. Karakteristikat litostratigrafike

Palezoiku - Formacionet me të vjetra janë ato të palezoikut të cilat kanë një shtrirje më të gjerë pothuajse nga të gjitha formacionet dhe janë të përfaqësuara me mermere, rreshpeve kristalore (filite, rreshpe secite, amfibolite) magmatite dhe gnejse migmatike e gëlqeror të metamorfizuar me trashësi të ndryshme të cilat ndërtojnë pjesët perëndimore dhe jugore të Kaçanikut. Shtrihen në një brez të gjerë me shtrirje nga lokaliteti Bajnicë në veri-perëndim e deri te lokalitete Gllboçicë-Kotlinë në jug-perëndim, por edhe në pjesën jugore të hapësirës në lokalitetet Kaçanik, Bob, Gjurgjedell etj. Këto përfaqësohen nga rreshpet sericite, kuarcitet, biotite muskovike dhe gnejse e mermere. Në kuadër të këtyre formacioneve marrin pjesë në masë të vogël edhe filitet dhe pelitet e metamorfizuara të cilat janë në kontakt me formacionet e kretaktut në njërën anë. Ndërsa në suaza të këtij brezi të gjerë të formacioneve palezoike shtrihet edhe një brez në formë intrudimi i ngushtë i serpentineve dhe perioditeve.


Triasiku - përfaqësohet me gëlqeror të metamorfizuar. Shkëmbinjtë gëlqeroret e metamorfizuar i takojnë triasikut të mesëm dhe të ulët. Janë dobët të shtresuar dhe masiv me thellësi disa qindra metra. Në drejtim të metamorfiteve kanë kalim gradual. Ndërsa, me formacionet paleozoikut kanë kontakte tektonike. Ndërtojnë në fragmente të caktuara, pjesën jug-perëndimore dhe perëndimore të territorit të Kaçanikut (Gllloboçicë, Sllatinë). **Jurasiku** - përfaqësohet me serpentinite dhe periodite (harzburgitet) që paraqitet përgjatë dis-lokacioneve në formë të një brezi të ngushtë veri-jug në sipërfaqe të vogla

Kretasiku - Në territorin e komunës së Kaçanikut është mjaftë i zhvilluar kompleksi sedimentar i kretës së epërm (Cenoman-Mastrihtian) të cilat i takojnë subzonës qendrore të Vardarit. Formacionet Kretasike në këtë hapësirë shtrihen në pjesët qendrore dhe lindore të territorit dhe me formacionet e paleozoikut dhe jurasikut tektonikisht kufizohen. Këto formacione tektonikisht janë mjaftë të shkapërderdhura dhe të thyera nga shkëputjet gjatësore me drejtim -shtrirje VP-JL. Përfaqësohen nga konglomeratit, brekçet, ranoret gëlqeroret dhe flishet me trashësi qindra metra. Kanë shtrirje VVP-JJL dhe ndërtojnë pjesën qendrore dhe lindore të komunës së Kaçanikut Nikaj, Kovaçec, Nikoc, Korbliq etj.). Konglomeratet paraqesin horizontin më të vjetër me trashësi deri disa qindra metra, të cilët zëvendësohen nga brekçet dhe ranoret kokërr-trash.

Plioceni - Njësia ranore-argjillore me horizontin e zhavorreve në hapësirën e komunës së Kaçanikut është e vendosur mbi sedimentet e kretës së epërme (senonionit). Kryesisht shtrihen në kontakt me rreshpet e paleozoikut dhe flishoret në tersit bregore të anës veriore të Kaçanikut në mbylljet të fushëgropës së Kosovës. Horizonti i zhavorreve gjendet në pjesën e sipërme të kësaj njësie dhe si duket paraqet fazën përfundimtare të sedimentimit liqenorë. Mosha e saj është përcaktuar duke i krahasuar sedimentet e pontianit të sipërm të fushëgropës së Kosovës.

Pleistoceni - është i përfaqësuar në fragmente të vogla kryesisht me sedimente glaciale-morenike në anën perëndimore të komunës së Kaçanikut përkatësisht në rrëzë të malit Sharrë (në lokalitetet Sllatinë dhe Biqec).

Kuaternari - Sedimentet aluviale në formë të tarracës lumore, janë të përfaqësuar përgjatë të dy anëve të rrjedhave ujore dhe përbëhen nga zhavorret, rëra, dhe suargjillat. Sedimentet aluviale, janë prezentë përgjatë të dy anëve të rrjedhave lumore (Lepenci) dhe degëve të tyre, e që përfaqësohen nga depozitimet zhavorreve dhe rërës. Shtrirja e këtyre sedimenteve si për kah trashësia ashtu edhe gjerësia është e ndryshme.

Harta 14. Gjeologjia e komunës së Kaçanikut

6.3. Tektonika


Në aspektin tektonik territori i komunës së Kaçanikut i përket tri zonave tektonike: zonës së Vardarit, zonës së Sharrë-Korabit dhe në skajin VP pjesërisht zonës së Drenicës (Drino-Ivanjicës). Kufiri në mes të zonës së Vardarit dhe zonës së Drenicës është i mbuluar me sedimentet liqenore neogjenë të basenit të Kosovës. Ndërsa, zhvillimi i këtyre tri njërive gjeotektonike është i ndryshëm deri në neogjen.

Njësia Kaçanik Ferizaj karakterizohet më rreshpe paleozoike dhe futet në skajin VP të Kaçanikut ndërsa brezi flisheve është pjesërisht i mbuluar me formacione të neogjenit në pjesën veriore. Ky kontakt në mes këtyre dy njërive është tektonik me shkëputjen e Ferizajt. Nga e tëra që u cek me lartë, rrjedh se, rolin kryesor në tektonikën e Kaçanikut e kanë shkëputjet tektonike me drejtim shtrirje VVP-JJL të cilat kanë ndarë formacionet në shtrirje të brezave dhe një mori shkëputjesh tërthore të cilët strukturave i japin karakter bllokor. Shkëputjet tektonike dominante në suaza të territorit të Kaçanikut janë ajo e Nerodimes që vazhdon në drejtim të jugut, e Elez Hanit dhe ajo Stagovës në mesin e se cilave lumi Lepenc ka prerë luginën grykëtërthor tejet imponante.

6.4. Seizmika

Kosova sa i përket seizmicitetit llogaritet si njëra prej zonave seizmike aktive, nga e cila rrjedhimisht, pritën tërmete me shkallë të lartë. Duke u bazuar në të dhënat seizmike nga e kaluara e deri me sot, territori i Kosovës, por edhe i komunës së Kaçanikut, kanë qenë të përfshira nga një mori tërmetesh të cilat përgjithësisht kanë pasur karakter autokton. Por, në raste të veçanta, lëkundjet janë ndier edhe nga territoret fqinjë të Kosovës kur ka pasur ndonjë vatër të tërmeteve. Vlen të përmendim tërmetin në Ferizaj, me 26 shkurt 1755 me intensitet epiqendre I - IX ballë shkalla MSK-64 dhe magnitudë 6.1 shkalla Riter. Pastaj, ai i vitit 1921, me intensitet prej IX ballë MSK-64, i cili goditi rajonin Ferizaj-Viti-Gjilan, i cili ka përfshirë edhe territorin e komunës së Kaçanikut. Vet shtrirja e territorit të Kosovës në suaza të shumë zonave dhe nën-zonave tektonike, të cilat gërshetohen brenda territorit të saj kanë kushtëzuar një seizmicitet lokal aktiv, por edhe seizmiciteti që shkaktohet prej tërmeteve jashtë hapësirës së Kosovës. Këto dëshmojnë për renditjen e saj në radhën e territoreve me një aktivitet të lartë sizmik. Territori i komunës së Kaçanikut në aspektin seizmik karakterizohet si hapësirë jo shumë aktive duke u bazuar në atë se brenda kësaj hapësire kemi një gërshetim, përkatësisht kontaktin tektonik pothuaj të tri zonave tektonike (Zona e Vardarit, Drenicës (Drino-Ivanjicës) dhe e Sharr-Korabit të cilat kanë qenë aktive sidomos gjatë periudhës së Pliocenit. Prej shkëputjeve që mundën të llogariten brenda mëti territori është ajo e Lepencit e cila manifestohet në suaza të zonës së Sharr-Korabit dhe e cila nuk karakterizohet me një seizmicitet të shprehur por që mundet të llogaritet si mundësi e paraqitjes së burimeve lokale seizmogjene, pastaj një shkëputje në anën lindore të gropës së Hanit të Elezit e cila përfshinë territorin e komunës së Kaçanikut dhe karakterizohet si aktive seizmike.

Nëse e analizojmë hartën seizmike të Kosovës, shihet çartë se territori i komunës së Kaçanikut, lidhet me ekzistencën e hipo-qendrës së tërmeteve autoktone me të cilat karakterizohen rajonet e gjëra të terreneve si vijon: Ferizaj-Gjilan-Viti-Kaçanik. Thellësia e hipoqendrave të këtyre tërmeteve është e ndryshme, por nuk i kalon 15 km. Duke analizuar hartën seizmike të Kosovës rrjedh se brenda territorit të komunës së Kaçanikut kalojnë izoseiste prej IX ballësh dhe ajo prej VIII ballësh. Izoseiste prej IX ballësh përfshinë një sipërfaqe prej 560.00 ha, përkatësisht në 2.5 % të territorit të Kaçanikut. Këtë seizmicitet e hasim në pjesën veri-lindore të komunës së Kaçanikut, përkatësisht përfshinë lokalitetin Begracë. Ndërsa izoseistet prej VIII ballësh shtrihet në një hapësirë prej 21460 ha përkatësisht në 97.5 % të territorit të Kaçanikut. Hapësira e cila hynë në suaza të kësaj izoseiste është i terë territori i Kaçanikut përpos lokalitetit të sipërpërmendur .

Harta 15. Harta sizmike e komunës së Kaçanikut

6.5. Relievi

Relievi është njëri prej komponentëve më të rëndësishëm fiziko-gjeografik të çdo hapësire. Ndikimit i ti kushtëzon edhe faktorët tjerë natyror siç janë: klima, ujërat, tokat, vegetacioni etj., Nga i varet sa do të jetë një hapësirë e caktuar tërheqëse, komunikative si dhe funksionale.

Relievi të territorit të Kaçanikut është rezultat i bashkëveprimit të fuqive të brendshme dhe atyre të jashtme të cilat kanë modeluar atë. Pikënisjen e bazamentit strukturor të territorit të Kaçanikut lidhët më ngritjet periferike të shprehura të maleve të Sharrit dhe Jezercit në jugperëndim dhe veriperëndim dhe ato të maleve të Karadakut në anën lindore si dhe uljes së vazhdueshme të strukturës grabenore të fushëgropës së Kosovës në anën veriore që lidhet me tektoogjeneza miocenike. Kjo tektonikë është shoqëruar edhe me shkëputje të rëndësishme gjatësore (shkëputja e Lepencit) e tërthore mjaft aktive gjatë këtij evolucioni. Në aspektin morfologjikë brenda territorit të Kaçanikut mund të diferencohen këto njësi morfologjike, malet e Sharrit dhe ato të Jezercit në pjesën jugperëndimor dhe veri perëndimore, malet e Karadakut në anën lindore si dhe pjesa më jugore e fushëgropës së Kosovës. Pjesa jugore e fushëgropës së Kosovës dhe lugina grykëtërthore e Kaçanikut, përbën nivelin bazë të erozionit për relievet kodrinoro-malore dhe malore të maleve të lartpërmendura në ngritje të vazhdueshme. Fillimisht, amplituda e uljeve tektonike e kësaj fushëgropë nuk arritën të kompensohen me masën e materialeve copë, të ardhura nga gërryerja e rrjedhjeve ujore në zonat kodrinore-malore dhe malore kufizuese, duke ndikuar kështu në transformimin e saj në një liqen.

Njësit morfologjike kufizuese (malet e Sharrit, Jezercit dhe Karadakut) ndahen prej kësaj fushëgropë grabenore dhe luginës grykëterthore të Lepencit nëpërmjet rrëpirave tektonike, janë kryesisht rrëpira shkëputjesh. Këto rrëpira janë modeluar gjatë planit të shkëputjeve normale, e që janë formuar nga diferencimi tektonik i ri i bazamentit strukturor të kësaj fushëgropë me njësitë morfotektonike kufizuese. Në kuadrin morfologjik verior të hapësirës së Kaçanikut, që lidhet me fushëgropën e Kosovës, vërehet edhe prania e relievit kodrinor shumë të butë në periferi të saj, i modeluar në molasat liqenore, i cili ka zbutur mjaft kontrastin morfologjik midis fushëgropës dhe rrëpirave tektonike të shpateve kufizuese.

Shpatet lindore të maleve të Sharrit të cilat shtrihen në pjesën jugperëndimore të territorit të Kaçanikut karakterizohen me pjerrtësi relativisht të madhe dhe me vlera të copëtimit vertikal dhe horizontal mesatare deri te larta të relievit. Këto vlera mesatare dhe të larta të thellësisë së copëtimit, lidhen me rrjedhjet ujore (lumi i Dubravës, Strazhës, Kotlinës, etj.), duke i shfrytëzuar kryesisht edhe shkëputjet tërthore. Në këtë pjesë shtrihet njëherit edhe lartësitë më të mëdha relievore maja e Lubotenit (2498m). Përveç formave fluvio-denudivë në këtë pjesë hasim edhe forma fluvio-glaciale dhe ato nivative që lidhen me periudhën e pleistocenit por edhe të ditëve të sotme të cilat kanë kushtëzuar formimin e rrymave gurore dhe grumbujve të tëra të materialeve shkëmbore të cilat mbulojnë sipërfaqe të tëra të shpatijeve të pjesëve të larta malore.

Në pjesën lindore e territorit të Kaçanikut shtrihet mali i Karadakut i cili karakterizohet më shtrirje JP-VL. Kryesisht karakterizohet si tërësi morfologjike kodrinoro-malore dhe malore me lartësi ma të madhe brenda këtij territori 1280m në majën e Blinajës në pjesën juglindore të Kaçanikut. Relievi karakterizohet me vlera deri mesatare të copëtimit vertikal dhe horizontal të cilat i kanë kushtëzuar rrjedhat lumore (lumi Runjeva, lumi Shtrembët, Trapovës dhe Kluçka).

Në mesë këtyre tërësive morfologjike shtrihet lugina grykëterthore e Kaçanikut (Lepencit). Kjo luginë grykëterthore ka një gjatësi rreth 7km brenda hapësirës së Kaçanikut dhe në gjerësi mesatare prej 0.5 km në fundin e se cilës rrjedhë lumi Lepencit, i cili ka pre terracat e tia. Lugina është prerë në rreshpe palezoiku me shtrirje shtresash me drejtim VP-JL dhe rënie nga ana VL.


Ndërsa pjesën veriore të Kaçanikut e përbën pjesa me jugore e fushëgropës së Kosovës në aspektin morfologjik. Vetëm në skajin JL kjo fushë lidhet gjerësisht me atë të Moravës së Binçës nëpërmjet një pragu strukturor 60-100 m lartësi midis Sllatinës dhe Kaçanikut të Vjetër, duke u karakterizuar nga një lidhje e natyrshme, por me diferencim tektonik e morfologjik, të shprehur midis tyre. Në suaza të territorit të Kaçanikut shtrihet sektori JL i fushëgropës së Kosovës i cili, ngushtohet menjëherë deri në 4-5 km, kurse gjatësia e saj arrin rreth 10-12 km duke pasqyruar kështu drejtpërdrejt ndryshimet strukturore të saj në shtrirje. Rreth 39% të sipërfaqes së komunës së Kaçanikut shtrihet në lartësinë mbidetare deri në 700m, pra, reliev të ulët deri mesatare. Ndërsa, pjesët anësore të relievit gradualisht ngritën duke marrë tipare të relievit kodrinoro-malor(700-900m) me një shtrirje prej 30% të sipërfaqes së përgjithshme. Ndërsa, relievet malore të ulëta dhe, deri në një mesatare të larta përfshijnë rreth 21.5% te territorit të Kaçanikut. Ndërsa

relieve të larta malore shtrihen ne një sipërfaqe prej 9.50% të hapësirës së Kaçanikut dhe zënë kryesisht pjesët jugperëndimore të Kaçanikut(malet e Sharrit).

Tabela 18. Pjesëmarrja e sipërfaqeve nëpër kate hipsometrike në Komunën e Kaçanikut

Katet hipsometrike	Sipërfaqja (ha)	%
400-700m	8584.14	38.98
700-900m	6596.35	29.86
900- 1200m	4742.97	21.54
1200- 2500m	2097.10	9.52
Gjithsej	21140	100

Harta 16. Hipsometria e terrenit



Mund të theksojmë se këto shpate paraqiten mjaft të modeluara nga veprimtaria e forcave ekzogjene të cilat kanë lenë gjurmë të shumta në to, por edhe nga veprimtaria e faktorit antropogjen.

Nëpër këto shpate vihen re lugje të thelluara të ndryshme gjatësore të krijuara si rezultat i rrjedhjeve ujore si dhe veprimit të denudacionit dhe shpëlarjes.

6.6. Erozioni dhe Vërshimet

Erozioni është njëra prej komponentëve që duhet trajtuar për shkak se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori antropogjen. Kjo dukuri është prezent pothuaj në tërë territorin e komunës së Kaçanikut, në forma dhe madhësi të ndryshme. Një rol të rëndësishëm në përshpejtimin e tij në shumë raste e ka luajtur edhe faktori antropogjen si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër prezent e kemi mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjëve, e përrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj. Procesi erozionit është i pranishëm në 60% të pellgut të Lumit Lepenc i cili brenda vitit depoziton rreth 1800m³ /km² ¹⁹

Tabela 19. Shkalla e erozionit

Kategoritë e erozionit për Komunën e Kaçanik	Sipërfaqe / ha	%
Erozion shumë i dobët	1510	7.1
Erozion i dobët	7121	33.7
Erozion i mesëm	5846	27.7
Erozion i fortë	4630	21.9
Erozion shumë i fortë	1983	9.4

Territori i komunës së Kaçanikut karakterizohet me një pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët kapin një hapësirë prej 1510 /ha, përkatësisht rreth 7.1% të territorit të kësaj komune. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht në pjesën veriprendimore përkatësisht në lokalitetet Bajnicë, Duraj, Elezaj, Koxhaj etj. Territorët me erozion të dobët kapin sipërfaqe prej 7121 /ha përkatësisht rreth 33.7 % të komunës së Kaçanikut. Shtrihen në lokalitetet Semajë, Kaçanik i Vjetër, Vatë-Dubravë, Sllatinë, Biçec etj. Erozioni i mesëm shtrihet në një sipërfaqe prej 5846 /ha përkatësisht në 27.7 % të territorit të komunës së Kaçanikut. Ky lloj erozioni shtrihet në lokalitetet Nikoc, Begracë, Gllloboçicë, Kotlinë, Ivajë dhe pjesën JP të Sllatinës.

Hapësirat me erozion të fortë në Komunën e Kaçanikut kapin sipërfaqe prej 4630 /ha përkatësisht 21.9 %. Këtë pjesëmarrje e relativisht të madhe të këtij erozioni e hasim në pjesën qendrore dhe JL të komunës. Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet, Kaçanik, Korbliq, Dreogllavë, Stagovë Gllloboçicë etj.


¹⁹ Dr Riza Qavolli, Gjeografia regionale e Kosovës f 224 Prishtinë 1997

Tabela 20. Kategoria e erozionit

Kategoritë e erozionit për Republikën e Kosovës	Sipërfaqe /km ²	%
Erozion shumë i dobët	1097.5	10.2
Erozion i dobët	3680.2	34.3
Erozion i mesëm	3367.7	31.3
Erozion i fortë	1890.2	17.6
Erozion shumë i fortë	714.3	6.6

Erozioni shumë i fortë shtrihet në 9.4 % të territorit të komunës së Kaçanikut dhe, atë në lokalitetin Bob, Gjurgjedell, Stagovë, Ivajë etj. Nëse bëjmë një krahasim të erozionit në Komunën e Kaçanikut me atë në nivel të Kosovës rrjedh se këtu kemi erozion shumë të fortë për rreth 3% ma tepër se ajo në nivel të Kosovës.


Harta 17. Erozionet në Komunën e Kaçanikut



Vërshimet

Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni

Komuna e Kaçanikut është e pasur me burime ujore. Nëpër territorin e komunës së Kaçanikut rrjedhin dy lumenj, Lepenci dhe Nerodimja. Lumi Lepenc buron në malet e Sharrit dhe është i pasur me ujë. Në bazë të të dhënave nga Instituti Hidrometeorologjik, prurja mesatare ujore në pikën matëse në Han të Elezit është $8.52\text{m}^3/\text{s}$. Lumi Nerodime



buron në malet e Jezercit dha ka prurje mesatare $4.06\text{m}^3/\text{s}$ (të dhëna të viteve 1980 - 91 në IHMK)

Në territorin e komunës së Kaçanikut ujërat sipërfaqësor përfshijnë një sipërfaqe prej 315.03 ha ose 1.07% nga sipërfaqja e tërë komunës prej së cilës lumenj janë 213.79 ha, përroje 99.7 ha, jaz 1.17 ha dhe kanal 0.378 ha.

Lumi Nerodime përshkon gjatësinë prej afër 25 km deri në derdhjen e tij në lumin Lepenc. Kryesisht kalon pjesë të banuara dhe pranë tokës bujqësore, për të vazhduar rrjedhën e tij nëpër qytezën e Kaçanikut ndërsa në dalje derdhet në lumin Lepenc. Meqenëse ka gjatësi



të madhe, gjatë vërshimeve shpeshherë shkakton dëme të konsiderueshme. Projekti „Rregullimi i shtratit të lumit Nerodime“ në gjatësi prej 400 m ka arsyeshmëri të plotë si në aspektin ekonomik poashtu edhe në aspektin e sigurisë së popullsisë nga vërshimet.

Realizimi i këtij projekti do të parandalonte përmbytjen e tokave bujqësore dhe do të mbronte vendbanimet, rrugët dhe hekurudhën nga vërshimet. Gjatë të reshurave të mëdha, Nerodimja rregullisht ka dal nga shtrati duke shkaktuar dëme të mëdha materiale.

Rregullimi i shtratit të lumit Nerodime, krijon mundësi të mira edhe për shfrytëzimin e tokës përgjatë tij për nevoja të bujqësisë.

Lumi Lepenc i cili kalon nëpër territorin e komunës së Kaçanikut, ka rrjedhë shumë të shpejtë për shkak të terrenit malor nëpër të cilin kalon. Gjatë stinëve me të reshura shkakton dëme të mëdha duke dalë nga shtrati dhe vërshuar një numër të madh të tokave bujqësore. Ky lum mbledhë shumë përroska të cilat poashtu kanë shpejtësi të madhe dhe shkaktojnë dëme të mëdha gjatë vërshimeve. Mbi lumin Lepenc janë disa ura të cilat lidhin shumë fshatra me pjesën e qytetit. Gjatë vërshimeve në të kaluarën ky lum i ka dëmtuar edhe këto ura. Prandaj rregullimi i shtratit të Lepencit do të

zvogëlonte shpejtësinë e rrjedhës së lumit, do të parandalonte rrezikun nga erozioni në pjesën malore dhe do të mbronte tokat bujqësore nga vërshimet.


Projekti "Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc" që do të realizohej në një gjatësi lumore prej 2139 metrash, ka arsyeshmëri të plotë si nga aspekti ekonomik poashtu edhe nga aspekti i sigurisë së popullsisë nga vërshimet. Me realizimin e këtij projekti në mënyrë të drejtpërdrejtë do të sigurohej një bazë e mirë që pjesa e infrastrukturës komunle pranë të cilës kalon lumi Lepenc, të jetë më e sigurt. Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc krijon mundësi të mira edhe për shfrytëzimin e tokës përgjatë tij për nevoja të bujqësisë dhe industrisë(të dhëna nga komuna).

Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet janë rreth 180 ha. Shih Hartën

Faktorët që ndikojnë në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet janë :

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve),
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjëve,
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë-rritura pranë brigjeve të lumenjëve etj
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.



Harta 18. Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet

6.7. KUSHTET KLIMATIKE, VALORIZIMI KLIMATIK, KARAKTERISTIKAT

Faktorët kryesorë që i japin karakteristikat klimatike kësaj komune janë gjerësia gjeografike lartësia mbidetare, relievi etj. Kosova por edhe komuna e Kaçanikut ndodhen në gjerësi të mesme gjeografike prandaj kjo komunë ka klimë të mesme kontinentale. Në klimën e një vendi kanë ndikim faktorët mikroklimatikë që ndikojnë që secila hapësirë pak a shumë ti ketë disa specifika të vetat. Në Komunën e Kaçanikut ndikim kryesorë ka relievi përkatësisht malet me lartësinë e tyre. Në pjesët e larta dominon klima malore e cila është më e ashpër se klima e mesme kontinentale. Këto hapësira janë malet e Sharrit dhe malet e Karadakut. Luginat me drejtimin e shtrirjes së tyre paraqiten si korridore që ndikojnë në depërtimin e rrymave ajrore. Lugina e Lepencit është e ngushtë dhe me laka për të depërtuar ngratësi nga Shkupi. Lumenjtë me masën e tyre ujore sadopak ndikojnë me freskinë e tyre dhe në rritjen e lagështisë së ajrit. Lartësia më e ultë mbidetare është 396 metra në fshatin Gjurgjedell në luginën e Lepencit, dhe pika më e lartë ndodhet në 2498m në malet e Sharrit që ndodhet në kufi me Maqedoninë. Dallimet hipsometrike shprehin edhe dallime në klimën e vendbanimeve të komunës së Kaçanikut. Në kushte normale duhet llogaritur që temperatura në mes pikës më të ultë dhe më të lartë dallimin në temperaturë mund ta kenë 11,7 °C ngase disniveli është 2102m. Në territorin e komunës nuk ekziston stacion hidrometeorologjik prandaj të dhënat duhet të shfrytëzohen nga stacioni më i afërt Ferizaji. Dallimet ndërmjet Kaçanikut dhe Ferizajit që kanë ndikim në klimë janë:

1. Ferizaji ndodhet në lartësi mbidetare 571 m ndërsa qyteti Kaçanikut 470 m, kjo është një diference që ka efekte klimatike, njëkohësisht Kaçaniku ka karakter me tepër malor
2. Ferizaji ndodhet në fushëgropën e Kosovës, ndërsa Kaçaniku ndodhet në luginë lumore e përkufizuar me male përreth.
3. Kaçaniku ndodhet me në jug në krahasim me Ferizajin që ndodhet diçka më në veri. Përdorimi i të dhënave klimatike të Ferizajit nuk mund të thuhet se është ide e qëlluar, por të dhënat duhet pakë modifikuar.

Temperaturat në këtë komunë oscilojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale. Për analizë do të shfrytëzohen temperaturat mesatare mujore 15 vjeçare, minimumet dhe maksimumet absolute.

Tabela 21. Temperaturat në Ferizaj

Muajt	Temperaturat mesatare	Maksimumi absolut	Minimumi absolut	Amplituda
1	-1,4	16	-26	42
2	0,3	20,4	-25,6	46
3	4,3	30,5	-17,9	48,4
4	10,1	28	-5,5	33,5
5	14,5	32,4	-1,2	33,6
6	18,5	34	4,5	29,5
7	20,6	36,1	4	32,1
8	20,5	37,3	4,9	32,4
9	16,4	35	0,6	34,4
10	10,6	29,4	-3	32,4
11	6	20,9	-13,1	34
12	1,5	18,8	-20,8	39,6
Vjetore	10,2	37,3	-26	63,3
Dimri	0,1	20,4	-26	
Pranvera	9,6	32,4	-17,9	
Vera	19,9	37,3	4	
Vjeshta	11	35	-13,1	
Per.vegje.	16,8	37,3	-5,5	

Temperatura mesatare është 10,2 °C, muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -1,4 °C, muaji më i ngrohtë është korriku me 20,6 °C. Muaji më i ftohtë me temperaturë ekstreme është janari me -26 °C ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me 37,3°C. Amplituda më ekstreme për këtë periudhë është 63,3 °C. Amplituda mesatare për të gjithë muajt është 36,4 °C. Në bazë të analizës së izotermave vjetore vërehet se pjesa e rrëzës malore ndodhet ndërmjet izotermës 10 dhe 9 °C, ndërsa tërësia e malit Sharr ndërmjet izotermave vjetore 9 e 8 °C. Vendbanimi i Gllloboçicës ka klimë diçka më të butë, temperatura më të larta ngase ka ndikim pjesa e Pollogut dhe Fushëgropa e Shkupit nga Maqedonia. Për jetën e përditshme ka rendësi lagështia relative e ajrit që paraqet shkallën e ngopshmërisë së ajrit me avull të uji. Varësisht nga

temperatura e ajrit varet edhe lagështia relative e ajrit. Në temperatura më të larta ajri ka kapacitet të pranojë më tepër lagështi ajri.

Tabela 22. Lagështia e ajrit në Ferizaj

Lagështia mesatare relative e ajrit ne %, Ferizaj												
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
86,1	80,2	75,9	71	71,5	69,5	65	63	66,2	78,1	84,5	85,5	74,7

Ne tabelë shihet se muajt e ngrohtë kanë lagështi relative me të vogël ndërsa muajt më të ftohtë lagështi relative më të lartë. Lagështia relative e ajrit dhe temperatura e ajrit kanë rendësi bioklimatike. Zakonisht gjatë muajve të verës mund të ndodhë në periudha të shkurtra kohore kur janë temperaturat e larta dhe shpejt fillojnë te zbresin. Gjatë zbritjes se temperaturës rritet lagështia e ajrit dhe krijon të ashtuquajturën zabullimë që ka efekte negative te personat e moshuar që shoqërohet me vështirsim të frymëmarrjes, por ndihet ndjenje e pakëndshme te e gjithë popullata. Për shkak të afërsisë së maleve në Komunën e Kaçanikut këto janë raste shumë të rralla.

b. Reshjet se bashku me temperaturën paraqesin tiparin primar klimatik të hapësirës. Sasia, forma e reshjeve dhe intensiteti i tyre janë karakteristika shumë të rëndësishme për hapësirën e një territori. Reshjet paraqesin vetëm një pjese të ciklit hidrologjik dhe ripërtitjes së ujit për një hapësirë të dhëne sidomos për territorin e komunës se Kaçanikut.

Tabela 23. Sasia e reshjeve në milimetra, Kaçanik

Muajt	Reshjet Mesatare mm	Sasia absolute maksimale mm	Sasia absolute minimale mm	Maksimumi absolut ditor
1	74,1	228,4	21,0	45,0
2	78,1	286,8	10,7	40,7
3	57,1	124,5	2,7	30,2
4	72,5	133,3	9,0	70,8
5	95,7	174,7	29,9	41,0
6	67,8	132,8	13,7	70,5
7	49,3	119,5	0,7	100,5
8	40,4	106,0	2,5	50,6
9	45,2	126,4	9,9	40,9
10	83,2	206,8	0,4	70,5
11	121,4	228,5	12,5	70,4
12	76,6	224,0	16,0	45,0
Vjetore	861,4	1056,8	580,3	100,5
Dimri	228,8			
Pranvera	225,3			
Vera	157,5			
Vjeshta	249,8			
Per.vegje	370,9			

Sasia vjetore e reshjeve është 861,4 mm që është mbi mesataren e Kosovës për këtë periudhë (784mm). Sasia vjetore reshjeve është një fakt që tregon për disa modifikime

dhe karakteristika të kësaj komune. Me këtë arsyetohet pohimi se shfrytëzimi i të dhënave nga stacioni meteorologjik i Ferizajit duhet të merren me disa rezerva. Në Ferizaj sasia e reshjeve është dukshëm më e ultë dhe nën mesataren e Kosovës me 784 mm. Në anën tjetër në stacionin shimatës në Jazhincë në lartësinë mbidetare 980m ka sasi vjetore të reshjeve 1022 mm. Muaji më i lagësht është nëntori (121,4) ndërsa muaji më i thatë gushti me 40,4mm. Si shihet në tabelë gjatë periudhës vegetative bien 43% e sasisë së reshjeve. Prej stinëve vjeshta është më e lagështa ndërsa vera është më e thata me 157,5 mm.

Nëse kalkulojmë sasinë vjetore të reshjeve (861mm) me madhësinë e territorit të komunës së Kaçanikut (211.40 km²) del se mesatarisht bien 189.420.000 m³/vit ose 0,18km³ ujë. Kjo është vlerë mesatare dhe duhet pasur parasysh se pika monitoruese është në pjesën e ultë, me që territori i kësaj komune ka pjesë malore që kanë sasi të reshjeve më të lartë. Kjo sasi mund të merret si vlerë më e ultë ndërsa sasia e reshjeve është më e lartë.

Reshjet kanë oscilime dhe karakteristika klimatike të rëndësishme është maksimumi dhe minimumi ngase çrregullon ekuilibrin natyrorë. Maksimumi absolut është 286,8mm në muajin shkurt që paraqet 33% të sasisë mesatare. Muaji me minimum absolut është korriku me vetëm 0,4mm (40 mililitra për m²).

Përkundër këtyre karakteristikave ekstreme të sasia e reshjeve është shumë e rëndësishme intensiteti i tyre. Mesataret mujore vjetore e shumëvjeçare i fshehin në vete shpërndarjen e tyre. Te analiza e reshjeve shpeshherë nuk është e rëndësishme sasia e tyre sa është e rëndësishme shpërndarja dhe intensiteti. Sipas të dhënave në tabelë shihet se ka raste kur bien pa ndërpre edhe deri në 100,5mm në ditë në muajin korrik. Kjo është sasi e madhe e koncentruar për kohë të shkurtër në raport me mesataren vjetore (përfshin 11,6 % të sasisë vjetore).

Thatësia si dukuri që paraqitet herëpasëherë është fatkeqësi elementare, në Kaçanik mund të zgjate edhe deri në 65 ditë pa reshje që është paraqitë gjatë muajve nëntor dhe dhjetor.

Në metodologjinë klimatologjike për analizën e klimës janë aprovuar indekse të ndryshëm për të përcaktuar kushtet klimatike në rend të parë regjimin pluviometrik. Sipas kalkulimeve në bazë të vlerave mesatare për këtë territor asnjë muaj nuk kualifikohet i thatë, korriku gushti dhe shtatori konsiderohen muaj mesatarisht të thatë, të gjithë tjerët hyjnë në regjim të lagësht. Këta muaj kanë reshje më pakë që sillet 45-50 mm ndërsa në anën tjetër temperaturat janë më të lartat. Të mos harrojmë se ky indeks bazohet në sasinë e reshjeve dhe temperaturave mesatare vjetore.

Bora shumë e rëndësishme paraqet akumulim të ujit deri në ditët më të ngrohta dhe shkrirja e sajë sidomos kur është graduale e ngop tokën me ujë dhe ushqen ujerat nëntokësorë e sipërfaqësorë.

Tabela 24. Ditët me borë për stacionin e Ferizajit

Muajt	Ditë me borë	Dite me mbulesë bore	Lartësia max. shtresës së bores cm
1	8,9	14,9	64
2	7,6	13,6	53
3	5	6,1	38
4	1,4	0,4	9
5	0,3		
6			
7			
8			
9			
10	0,1		
11	2,2	2,1	33
12	5,1	9,9	20
Vjetore	30,6	47	64
Dimri	21,6	38,4	64
Pranvera	6,7	6,5	38
Vera			
Vjeshta	2,3	0,1	33
Per. vegje	1,7	0,4	9

Mesatarisht ditë me borë janë 30,6 ditë, ndërsa dite me mbulesë bore janë 47 ditë gati një muaj e gjysme, pjesa me e madhe vitit është pa mbulesë bore. Muaji që ka mbulesë bore më së shumti është janari me 14,9 ditë. Shtresa maksimale e bores është mjaft e lartë edhe pse e rrallë megjithatë ndodhë ngase shkakton një varg problemesh në jetën e përditshme. Në muajin janar trashësia maksimale e borës mund të jetë edhe 64 cm që jep sinjal të çartë se mund ta paralizoj jetën e atij territori, në pjesën e Sharrit shtresa mbi 1-2 m është dukuri normale. Në analizën e hartës së përhapjes së ditëve me shtresë bore del se në këtë komunë sillen prej 50 ditë në pjesët e ulëta ndërsa arrin në 70 ditë në viset e larta malore (vërejtje: tabela është për Ferizaj).

Mesatarisht dita e parë me bore paraqitet 30 nëntor ndërsa dita me e hershme me 5 nëntor. Zakonisht dita e fundit me borë paraqitet 23 mars ndërsa me e vonshme deri me 27 prill. Këto të dhën janë për qytetin e Kaçanikut që ka lartësi relativisht të ulët mbidetare, në pjesët e larta malore nënkuptohet që zgjasin edhe më gjatë.


c. Insolacioni varet nga gjerësia gjeografike dhe relievi. Malet mesatarisht të larta ndikojnë që në këtë territor të ketë diçka më pak orë me diell.

Tabela 25. Mesataret mujore të diellzimit-orë me diell/muaj -Ferizaj

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
65,2	92,2	141,9	175,3	229,5	239,1	261,4	264,4	214,1	168,4	118,5	65,8	2035,8


Shuma totale vjetore e insolacionit është 2035,8 orë me diell. Muaji me më së shumti orë diellore është korriku me 264 orë. Mesatarja e mbulimit të qiellit me re është 57% dhe lëviz prej 33% në muajin korrik deri në 74 % në muajin janar. Me që Kaçaniku ndodhet në luginë me shtrirje veri-jug ndërsa malet ndodhen në lindje dhe perëndim këto vlera janë më ulëta. Përgjithësisht territori nuk ka diellzim të njëjtë për shkak të thyerjes së terrenit. Në orët me diell ndikon edhe mbulimi i qiellit me re.

d. Erërat me drejtimin e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës. Erërat e thata dhe të ngrohta ndikojnë në rritjen e avullimit dhe humbjen e lagështisë nga toka dhe bimët. Erërat ndikojnë në komoditetin e ambientit të njeriut, ndikojnë në temperaturat fiziologjike të njeriut. Në temperatura të larta dhe erëra të dobëta organizmi dobësohet dhe vështirë reziston temperaturat e larta. Erërat zakonisht e zvogëlojnë temperaturën e organizmit duke e bartur nga sipërfaqja e trupit. Kështu në kushte të njëjta të temperaturës erërat dukshëm ndikojnë në kushtet e jetës. Në temperatura të ulëta era sado e vogël është e pakëndshme ngase e ulë shumë temperaturën e organizmit.



Grafiku 22. Trëndafili i erërave

Me së shumti fyejnë erërat veriperëndimore, juglindore dhe ato veriore. Në grafikon drejtimet janë të shprehura në promil në mënyre që të eliminohet numri jo i njëjta i ditëve gjatë muajve. Ditët e qeta pa erë janë 120 ‰ që nuk janë futur në grafikon ngase çrregullojnë anët kryesore të botës.




Grafiku 23. Shpejtësia e erës

Shpejtësi me të madhe mesatare kanë erërat juglindore me 4 m/s dhe jugore me 3 m/s. Shpejtësinë më të ultë e kanë erërat verilindore. Shpejtësia maksimale është te erërat juglindore deri 22,6 m/s, juglindore 18,6 m/s. Në viset e larta që janë të ekspozuara shpejtësia e erës duhet të jetë me e madhe sidomos në rrëzat e Sharrit.

6.8. Hidrografia

Territori i komunës së Kaçanikut ka rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në pjesën më të madhe në drejtim të pellgut të Detit Egje dhe një pjesë më e vogël në drejtim te Detit të Zi. Nëpër këtë komunë kalon lumi i rëndësishëm jo vetëm për Komunën e Kaçanikut por për tërë Kosovën, Lepenci. Buron në shpatiet veriore të malit Sharr te Oshlaku me lartësi mbidetare 2212m. Lepenci ka luginë interesante kompozite e ndërtuar nga pjesët e gjëra dhe ngushticat. Prej Kaçanikut fillon gryka më e thellë dhe më e bukur e kësaj pjese. Në këtë pjesë lumi ka shtrat të ngushtë dhe të thellë dhe është relativisht i shpejtë. Nëpër territorin e komunës së Kaçanikut Lepenci ka gjatësi rreth 18 km, në territorin e komunës lumi hynë në fshatin Bajnicë (610 m lartësi mbidetare) dhe rrjedh në drejtim lindje-perëndim. Në fshatin Soponicë merr drejtim jugor dhe e lëshon territorin komunal në fshatin Gjurgjedell (710 m lartësi mbidetare). Ky lumë vetëm me një sektor i takon kësaj komune pjesa tjetër më e madhe rrjedh nëpër komunat dhe shtetet fqinje. Në komunë Lepenci ka rënie të tërësishme 214m ose rënje mesatare 11,8m/km. Gjerësia e lumit sillet 11 deri 20 m me thellësi mesatare 40 deri 60 cm, maksimale sillet edhe 2 m. Shtratin e ka të ndërtuar nga rëra, zhavorri dhe blloqe të shkëmbinjve që sjell lumi me fuqinë e tij gjatë niveleve të larta. Prurja mesatare e ujit te Lepencit sillet rreth 10,1 m³/s në Elez Han që paraqet diku 8,2% të ujërave të Kosovës. Në këtë territor për shkak te relievit malorë koeficienti i rrjedhjes është rreth 51%. Kjo tregon që gjysma e sasisë së reshjeve rrjedh e pjesa tjetër infiltrrohet dhe avullohet. Për pellgun e Sitnicës kjo vlerë sillet 30 % ndërsa për pellgun e Moravës së Binçit është edhe më e ultë me 25%. Moduli


mesatar i prurjes sillet $14,1 \text{ l/s/km}^2$ që tregon vlere mjaft të lartë dhe është karakteristikë për lumenjtë malorë. Kjo vlerë sillet edhe deri në 25 l/s/km^2 në viset e larta rreth Lypetenit. Me rëndësi është se lumi i Lepencit për shkak të burimit në lartësitë e mëdha mbidetare që mbulohen me borë i sigurojnë ushqim stabil me ujë. Bora qëndron deri në fillim të qershorit. Ushqimi i tij është nivalo-pluvial (bora dhe shiu). Sipërfaqja e pellgut është e mbuluar me pyje ndërsa në viset e larta me kullota malore.



Grafiku 24. Prurjet mesatare mujore të lumit Lepenc për periudhën 1951-75

Në grafikun e prurjeve shihet se niveli maksimal paraqitet në muajin maj atëherë kur procesi i shkrirjes së borës është më intensiv. Niveli më i ultë është në muajin gusht dhe shtator ($3,26 \text{ m}^3$), ndërsa nga muaji tetor fillon ngritja e nivelit deri në muajin mars që paraqet maksimumin e dytë. Lumi Lepenc kësaj hapësire i jep fizionomi interesante dhe gjallëri. Lepencit i bashkangjiten edhe shumë degë tjera të shkurta që rrjedhin nga shpatiet e maleve. Degë e rëndësishme është lumi i Kotlinës që buron afër majës së Lypetenit.

Harta 18. Lumenjtë dhe rrugët kryesore



Dega më e rëndësishme e lumit Lepenc është Nerodimja e cila buron nga malet me këtë emër dhe në qytetin e Kaçanikut bashkohen. Nerodimja ka gjatësi 8,5 km në territorin komunal me rënie të tërësishme 53m dhe rënje mesatare 6,2 m/km që është dukshëm më e ultë se e lumit Lepenc. Deri në fshatin Stagovë ka karakter të lumit fushorë me rrjedhje të qetë e të ngadalshme. Prej këtij fshati lumi hynë në luginë në terren malorë me elemente të grykës normale. Kalon nëpër qytetin e Kaçanikut që shpeshherë i ka përmbyt pjesët rreth brigjeve të lumit. Me rregullimin e shtratit në qytet ky problem është evituar.

Nga komuna e Kaçanikut e ka burimin lumi i Moravës së Binçës përkatësisht lumi i Korbliqit i cili derdhet në Detin e Zi. Ky lum dhe venbanim kanë pozitë periferike ndaj qendrës komunale dhe lidhje të kufizuar, gjatësia e tij është 6,5 km që buron nga malet e Karadakut. Sipërfaqja e pellgut të këtij lumi që i takon kësaj komune përfshinë 20 km². Kjo pjesë është e mbuluar me pyje dhe lumi rrjedh nëpër luginë relativisht të ngushtë dhe shumë rralle e banuar. Është i gjerë 4-5 m në kushte normale thellësi 20 deri 30 cm dhe sasia e ujit nuk i kalon 200 l/s.

Shtirja e lumenjëve në raport me territorin komunal konsiderohet e mire ngase e përshkoi pothuajse në mes territorin, përveç lumit të Korbliqit. Degët tjera për shkak të relievit të theksuar kanë rrjedhje të shpejtë dhe shumica janë rrjedhje të përkohshme.

Ujërat nëntokësorë kanë përhapje të kufizuar.

Nga analiza e hartës hidrogeologjike shihet se ka ujëra nëntokësorë rreth aluvioneve lumore si është Lepenci dhe lumi Nerodime. Diçka me të theksuara janë sedimentet ujëlëshues në hapësirën e Kaçanikut të Vjetër, Koxhaj Doganaj, Elezaj. Ujëra karstike ka pakë me që shkëmbinjtë gëlqerorë janë pakë të përhapur në këtë komunë. Ekzistojnë burime që kanë prurje të vogla si është "Kroni i Bardhë" me sasi uji 20-40 l/s por është kaptuar dhe përdoret për furnizim me ujë për qytetin e Kaçanikut. Burimet tjera janë edhe më të vogla por ka mjaft për shkak sasisë së reshjeve dhe terrenit malorë.

6.9. Tokat

Në Komunën e Kaçanikut mbi shkëmbinjtë dhe depozitimet e ndryshme gjeologjike nga proceset pedogjenetike janë krijuar tipe, nëntipe dhe varietete të llojëlloshme të tokave. Nga harta Pedologjike e Kosovës²⁰ rrjedhë se në këtë hapësirë që ka sipërfaqe prej 21731.73/ha, janë veçuar këto tipe më të përfaqësuara të tokave: Tokat kafeje, aluviale-deluviale, pseudogleje, smonica, rankeri dhe rendëzinë. Kurse në areale të caktuara na paraqiten edhe tokat gurore (Litosolet).

²⁰ Grup autorësh "Harta pedologjike e Kosovës" IEU, J. Cerni, Beograd 1974

Tabela 26. Tipet e tokave në Komunën e Kaçanikut

Kodi	Tipet e Tokave	Thellësia në cm	Sipërfaqja në Ha	Sipërfaqja sipas tipeve	%
16	Toka aluviale ranore-deltinore	> 80	492.6		
17	Toka aluviale deltinore	> 80	163.4		
23	Deluvim Teltynor	>80	733.7		
26	Aluviale -deluviale ranore-deltinore	50 - 80	106.6		
27	Toka aluviale-deluviale deltinore	> 80	204.4		
	Tokat Aluviale- Deluviale			1700.7	8.07
45	Toka rendezine e hinjët kafeje mbi gelqëror	< 25	47.92		
52	Toka rendezine kafeje mbi serpentinite	< 25	1.13		
	Tokat Rendezine			49.05	0.22
61	Toka Rankeri mbi gurë	< 25	707.2	707.2	3.5
72	Toka smonicë e kafenjëzuar	> 80	49.78		
	Tokat Smonice			49.78	3.6
89	Tokë e kuqe kafeje mbi form. gëlqëror	25 - 50	326.5		
90	Tokë kafeje ranore mbi sed. të kuqërremta	50 - 80	1800		
94	Toka e kafeje e lesivuar mbi sedimente të kuqërremta	25 - 80	809.1		
105	Toka e kafeje e cekët mbi substrat gëlqëror	< 25	710.2		
107	Toka kafeje mbi flishe	< 25	3176		
108	Toka kafeje mesatarisht e thellë mbi flish	50 - 80	386		
109	Tokë kafeje e thellë mbi flishe	> 80	96.46		
110	Tokë kafeje e lesivuar mbi flishe	25 - 50	66.48		
112	Tokë kafeje mesatarisht e thellë mbi zallishte		80.95		
120	Toka kafeje e cekët mbi substrat(filite, mikashiste, etj)	< 25	8809		
121	Toka kafeje mesatarisht e thellë (filite, mikashiste, etj)	50 - 80	228.7		
	Tokat Kafeje			16489.39	77.5
137	Pseudoglej Deltinor		158.3		
134	Tokat pseudogleje	25 - 80	1068		
	Tokat pseudogleje			1226.3	6.1
10	Toka Litosol mbi shkëmbinj gëlqëror të fortë	< 25	862		
150	Tokat gurore		6.31		
	Tokat gurore			868.31	4.5
	Gjithsej		21140	21140	100

Tokat kafeje, smonicat, litosolet dhe rendëzinat dhe rankeret i takojnë rendit të tokave automorfike, ndërkaq aluviumet dhe pseudoglejet rendit të tokave hidromorfike. Tipet dhe nëntipet e tokave kafeje i përkasin klasës së tokave kambike dhe eluvialo-iluviale.

Tokat e klasës kambike Karakterizohen me ndërtim të profilit A-(B)-C. Këto toka për shkak të lagështisë më të madhe dhe ajrosjes optimale krijojnë kushte të përshtatshme hidrotermike, të cilat ndikojnë në rrjedhën dhe intensitetin e proceseve pedogjenetike, që lidhën me alterimin kimik dhe biologjik, duke ndryshuar në tërësi strukturën e shkëmbinjve. Kësisoj vie deri të lirimi i oksideve të hekurit të cilat se bashku më procesin e shtimit të argjilës (argjilogjenezës) profilit të tyre i japin ngjyrë kafeje.

Tokat kafeje në Komunën e Kaçanikut përfaqësohen me tokat: toka e kafeje e lesivuar mbi sedimente të kuqërremta, toka e kafeje e cekët mbi substrat gëlqeror, toka kafeje mbi flishe, toka kafeje mesatarisht e thellë mbi flishe, toka kafeje e cekët mbi substrat(filite, mikashiste, etj), të cilat kanë profil A₁-C, në pyje mund të jenë A₀₀ dhe kryesisht janë të cekëta. Këto toka shtrihen në pjesët periferike perëndimore, veri-perëndimore, verilindore, qendrore dhe jug-lindore të komunës së Kaçanikut, përkatësisht në lokalitetet Gllloboçicë, Gërlicë e Epërme, Sllatinë deri në Korbliq. Në aspektin hipsometrik pothuaj se janë të përfaqësuar në të gjitha katet hipsometrike mirëpo më të shprehura janë në lartësinë mbidetare prej 600-1200m. Pjesa dërmuese e këtyre tokave shtrihen në terrenet me pjerrtësi të theksuar dhe zënë një sipërfaqe prej 16831.39/ha, përkatësisht 77.5% të komunës së Kaçanikut. Ato janë krijuar mbi shkëmbinj të kompakt (flishe, mikashist, filite e gëlqeror) dhe sedimente të shkapërderdhura. Këto toka përmbajnë skelet (20-40%).

Karakterizohen më diferencim të dobët të profilit, ndërsa sa i përket përmbajtjes së argjilës ato përmbajnë pak argjilë prandaj janë të lehta për punë. Janë toka me aciditet të shprehur (pH 5-5.5) dhe shkallë të vogël të ngopshmërisë me baza. Sasia e humusit varësisht nga lartësia mbidetare sillet: në lartësinë nën 1000m përmbajnë 2.5% humus, ndërsa në lartësinë mbi 1000m 5-10%, kurse në tokat e punuara sasia e humusit është përgjysmë më e vogël. Sa i përket aftësive prodhuese të këtyre tokave mund të themi se këto toka kanë një rëndësi të madhe ekonomike, sepse mund të shfrytëzohen për prodhimtari pemëtare, vreshtarë e pjesërisht edhe për kultura lavërtare.

Tokat gurore (litosoli) (150,10)- përfaqësohen në Komunën e Kaçanikut me tri tipe tokash me atë Litosol mbi shkëmbinj të gëlqeror, gnejse dhe ato Gurore. Këto toka përfaqësojnë skeletin e alternuar në shkëmbinj të gëlqeror i cili nuk mund të jetë më i thellë se 20 cm, kurse nën këtë thellësi paraqiten shkëmbinj të kompakt. Kryesisht janë toka të pa zhvilluara me profil (A)-C me horizontin humusor në fazën iniciale të zhvillimit në të cilat ende nuk është formuar kompleksi organo-mineralik. Kjo tokë formohet "in situ", d.m.th. me migrimin e thërrmijave të imtësuar, kurse për shkak të shtrirjes së saj në kushte jo të favorshme klimatike dhe proceseve të shprehura të erozionit, nuk kanë pedogjenezë të zhvilluar. Pra dallimi i saj me substratin amë është shumë i vogël, prandaj edhe vetit e saj prodhuese janë shumë të kufizuara.

Shtrihet në sipërfaqe prej rreth 968.31/ha në disa fragmente të vogla në pjesën jugore dhe jug-lindore të komunës së Kaçanikut, përkatësisht në afërsi të lokalitetit Gajre, Sllatinë etj në lartësinë mbidetare mbi 800m .

Tokat smonica (vertisol)- Në Komunën e Kaçanikut përfaqësohen me tipin, smonica të kafenjëzuara. Krijimi i saj është i lidhur me kushtet terestrike, përkatësisht në kushte klimatike gjysmë të thata (semiaride) deri në gjysmë të lagështa (semihumide). Substrati

gjeologjik i saj kryesisht është i përbërë nga sedimentet terciare liqenore. Janë toka të thella më profil A-C gjegjësisht A-AC-C. Kur përmbajtja e lagështisë është më e madhe, këto toka kanë ngjyrë hiri të mbyllët deri të e zezë. Këto toka shtrihen në pjesën verilindore të komunës së Kaçanikut (lokalitetin e Begracës) në lartësinë mbidetare prej 560-700. Kanë pjesëmarrje relativisht të vogël (3.6%).

Prej veçorive më karakteristike e kësaj toke është përmbajtja e madhe e argjilës (mbi 40%) përgjatë tërë thellësisë së profilit. Nga mineralet e argjilës dominues është montmoriloniti (mbi 90%). Pra janë toka të rënda dhe të vështira gjatë punimit. Përndryshe karakterizohen me veti të përshtatshme kimike. Reakcioni i tyre mund të jetë acid i dobët deri të alkalik i dobët (pH 6.5-8.0). Përmbajtja e humusit sillet prej 3-5 %. Këto toka ofrojnë kushte të përshtatshme për kultura lavërtare (grurë dhe misër), por në raste më të rralla kultivohen edhe pemët.

Rendzina- Në territorin e komunës së Kaçanikut janë zhvilluar rendëzinat tipike mbi serpentinite dhe ato mbi gëlqeror dhe kanë përhapje në pjesët perëndimore dhe veri-perëndimore të Kaçanikut përkatësisht në lokalitetet e Gërllicës, në lartësinë mbidetare mbi 700m. Ka një shtrirje relativisht të vogël (0.2%) të sipërfaqes së komunës së Kaçanikut.

Më shkriftësimin e substratit amë (nën ndikimin e faktorëve fizik, kimik, dhe biologjik) formohet horizonti i shkrifët ku depozitohen fraksionet e materies organike gjegjësisht horizonti A. Përbërja teksturale e kësaj toke është e llojlojshme (prej argjilores deri në ranore), prandaj edhe karakteristikat e saja (raportet ujë-ajër) janë heterogjene. Varësisht nga lartësia mbidetare edhe përmbajtja e humusit është e ndryshme dhe ajo sillet prej 5% në pjesët e ulëta deri në 15 % në lartësi të mëdha mbidetare. Këto toka kanë reaksion të dobët acidit (pH 6.0-6.5) dhe ngopshmeri të lartë me baza. Vetitë prodhuese të këtyre tokave gjithashtu varen nga substrati amë. Janë toka pak produktive.

Rankeri (toka humusoro- silikatore)- Zakonisht këto toka llogariten si toka malore, mirëpo ndodhë të paraqiten edhe në terrenet e rrafshëta. Janë sinonim i tokave të pa zhvilluara në shkëmbinjtë silikator me profil A - R, ku janë formuar horizontet molik, umbrik dhe organik. Këto toka formohen në shkëmbinjtë kompakt dhe të alteruar. Në Komunën e Kaçanikut janë të përfaqësuar në ranker tipik mbi filite. Nga kjo rrjedhë se formimi i këtij tipi të tokave në Komunën e Kaçanikut është lidhur më shkëmbinjtë bazik (Filite) dhe shtrihen në rreth 3.5% të sipërfaqes së saj.


Shtrihet kryesisht në pjesët jug-perëndimore (lakesa e Sopotnikut) të komunës në lartësinë mbidetare mbi 1700m dhe pjerrësisë së terrenit 4 - 8°. Janë toka të lehta (përmbajtja e argjilës sillet 20-25 %) dhe të ajrosura mirë, ndërsa pjesëmarrja e skeletit sillet deri 40 %. Janë mjaftë të pasura me materie organike (5-15 % humus) gjë që varët nga stadi i zhvillimit dhe lartësia mbidetare. Vlerat prodhuese e këtyre tokave lidhet ngushtë me thellësinë e tyre dhe substratit amë. Këto toka kryesisht shfrytëzohen për kullosa dhe livadhe e pjesërisht si ara (patate, elb dhe tërshërë).

Nga rendi i tokave hidromorfe, në Komunën e Kaçanikut dallojmë këto tipe tokash: tokat aluviale dhe pseudoglej.

Tokat aluviale (Fluvisol)- Përfaqësohen me këto tipe në Komunën e Kaçanikut, aluviale ranore-deltinore, aluviale deltinore, aluviale argjilore, aluviale-deluviale deltinore etj. Bëjnë pjesë në tipin e tokave të pa zhvilluara dhe janë produkt i depozitimeve shtresore të lumenjëve Lepenci, Nerodimja, etj., dhe kanë profil (A), A_p, por edhe G. Meqenëse të këto toka nuk janë zhvilluar proceset e pedogenezës përshkrimi i profilit të këto toka nuk bëhet me horizonte, por numërohen shtresat duke i evidencuar me numra romake. Tokat aluviale në këtë komunë shtrihen për gjatë dy anëve të lumenjëve Lepenci , Nerodime, etj dhe shtrihen në një sipërfaqe prej 1754.7/ha gjegjësisht në 8.7% të sipërfaqes së përgjithshme. Sipas përbërjes mekanike këto toka janë mjaftë heterogjene dhe varësisht nga sektorët e rrjedhjes lumore ato mund të jenë prej ranore në sektorin e epërm të rrjedhjes deri te argjiloret në sektorin e poshtëm të rrjedhjes. Përmbajtja e humusit përgjatë profilit nuk ka ndonjë shtrirje të rregullt dhe sasia e tij sillet prej 1-3 %. Varësisht nga përbërja mekanike ndryshon edhe produktiviteti i tokave aluviale. Këto toka në Komunën e Kaçanikut mese tepërmi shfrytëzohen për kultivimin e kulturave lavërtare (grurë, misër), mirëpo kohëve të fundit me sukses në këto toka po kultivohen edhe perimet.

Tokat pseudogleje- Janë të formuara si rezultat i lagies së tepërt të horizontit sipërfaqësor nga ujërat stagnuese. Me kalimin e kohës sasia e tepërt e ujit në thellësi të profilit ka formuar horizontin B_t jo ujëlëshues (që pengon infiltrimin e rregullt). Këto toka kryesisht shtrihen në pjesën veriore të Kaçanikut, lokalitetet Gërlicë e Epërme dhe Kaçanik i vjetër, etj., në lartësi mbidetare prej 900m dhe zënë rreth 6.1% të sipërfaqes së Kaçanikut. Këto toka janë me veti shumë të këqija fizike, kimike dhe prodhuese si pasojë e formimit të horizontit jo ujëlëshues.

Harta 19. Harta pedologjike



6.10. Bota bimore dhe shtazore

Komuna e Kaçanikut e shtrirë në jug të Kosovës me terren kodrinor dhe malore ka ndikua edhe në përhapjen e botës bimore dhe shtazore. Malet e Sharrit paraqesin begati të llojeve bimore me një numër të madh të llojeve. Malet e Sharrit janë shpallur park nacional dhe një pjesë i takon komunës së Kaçanikut. Në këto male janë konstatuar 2000 lloje bimore dhe 68 bashkësi bimore²¹. Në mesin e këtyre llojeve 86 janë deklaruar me rëndësi ndërkombëtare²². Në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjve dallohen pyjet gjetherënëse si: ahu (*fagus sylvatica*), qarri (*quercus cerris*), bungu, shkoza (*carpinus orientalis*). Në rrëzat e maleve të Sharrit dallohet ahu si më i përhapur por edhe me dimensione (gjatësia dhe trashësia e drurit). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta lloji i shkurreve si thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj. Prej bimëve barishtore ka lloje të ndryshme si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjëve si edhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bime që pas trajtimit përdoren si është çaji i malit (*origanum vulgare*), kantarioni (*hypericum perforatum*), kamomili (*matricaria chamomila*), dredhëza (*fragaria vesca*) etj. Në lartësitë mbi 1500 m shtrihen kullotat malore që janë bimë barishtore të ulëta dhe për shkak kushteve klimatike nuk ka pyje.

Edhe pse Malet e Sharrit e kanë mjaft lloje të pyjeve gjethembajtëse, në territorin e kësaj komune ka fare pakë pyje gjethembajtëse.

Hapësira e rrafshët e komunës është e vogël pa drunj të dendur zakonisht rritet shelgu (*salix alba*) në brigje të lumenjëve. Bimë të ulëta ka mjaft si është lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (*papaver rhoeas*), hithi (*urtia dioica*), formacionet e livadheve si tërfilli dhe shkurre të rralla. Livadhe ka pakë në këtë komunë.

Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë ujku (*canis lupus*), dhelpra, lepuri (*lepus europaeus*), iriqi (*ernaceus europeus*) etj. Në viset e larta malore është i njohur ariu i murrmë (*ursus arctos*), dhia e egër (*rupicapra rupicapra*), kaprolli (*capreollus chrysaetos*).

Nga hapësira e Sharrit e ka prejardhjen raca autoktone e qenit Pastori Ilir që në popull njihet si Qeni i Sharrit. Jeton gjarpri i ujit (*natrix natrix*), gurit (*vipera ammodytes*), bollujca (*tropidonatus natrix*), kërmilli i vreshtës (*helix pomatia*), breshka e rëndomtë (*testudo bermanni*). Peshq nuk ka shumë lloje, në lumin Lepenc më kryesorët janë trofta e përroskave që jeton në ujëra të shpejta dhe ftohta, mustaku i përrenjve, bërcoku, mlyshi, krapuliqi, krapu etj.

²¹ Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, Vlerat e Trashëgimisë Natyrore të Kosovës, faqe 37, MMPH, Prishtinë 2005

²² Po aty faqe 35



Insekte ka shumë lloje si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje, merimanga, kaçadreri (lucanus cervus) etj.

Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si trishtili kokëzi (parus major), zogu i malit, pëllumbi i egër (columbia livia), qukapikthi (dryobates major), laraska (pica pica) qyqja (cuculus canorus) etj. Shpezë grabitqare që jetojnë janë shqiponja e zezë (aquilachyretos), petriti (malco tinnunculus). Shpezë shtegtarë që jetojnë janë dallëndyshja, lejleku etj.

Foto Çerdhja e lejlekut, fshati Soponicë (04.04.2009)


6.11. Pyjet

Komuna e Kaçanikut është e pasur me pyje ku mbi gjysma e sipërfaqeve tokësore janë me pyje 11381.8 ha ose 58.9% e sipërfaqes së përgjithshme.

Degradimet e pyjeve janë dukuri e njëjt sikur në çdo pjesë të Kosovës e sidomos prerjet ilegale. Nuk ka të dhëna të sakta lidhur me prerjet ilegale por në bazë të raportit të Gjendjes së Mjedisit 2006-2007 nga AKMM humbjet llogariten shumë të mëdha. Vetëm nga zjarret komuna ka pas humbje në vlerë në rreth 150000 euro. Pasuri e madhe pyjore shtrihet në perëndim dhe në lindje të komunës. Dallohen me formacione ahu (fagus sylvatica), qarri (quercus cerris), bungu, shkoza (carpinus orientalis), brekia, bliri (tilia kordata), frashri etj.

Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta lloji i shkurreve si thana (cornus mas), murrizi (crataegus monogyna), kaça (rosa canina), manaferra e egër (rubus fruticosus), shtogu (sambucus nigra), kulumbria (prunus spicosa), lajthia (corylus avellana), në vise të larta fieri shqiponje (pteridium aquilinum) etj

Hata 20. Pyjet në Komunën e Kaçanikut



6.12. Livadhet dhe Kullosat

Livadhet dhe kullosat janë me sipërfaqe të mjaftueshme sa i përket mundësisë së shfrytëzimit për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale dhe bletare .

Nga sipërfaqëja e përgjithshme 7.1 % i takon livadheve dhe kullosave ose rreth 1507.74 ha. Është bazë e mirë për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale e sidomos në viset kodrinore malore. Sipërfaqet pyjore, kullosat, livadhet , është bazë ekonomike shumë e favorshme për zhvillimin e blegtorisë edhe aktiviteteve të pylltarisë dhe bletarisë.

6.13. Ndotja e ujit

Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës njashtu edhe në Komunën e kaçanikut është si pasoj e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në trupat uJOR. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në vist e ulta fushore aty edhe ku ka shtrirje aktiviteti njerzor.

Në bazë të klasifikimit të cilësisë së ujrave në komunën e Kaçanikut janë prezente tri shkallë të ndotjes.

Në shkallën e parë që nuk ka ndotje kimike dhe biologjike janë lumenjtë që shtrihen nga burimet deri në vendbanime, e ato janë: Lumi Korblicit, Runjevës, Nikovcit, Terstenikut, Dubravës, Urec dhe gjysma e shtratit të lumit Ivajë.

Shkallës së dytë të ndotjes i takon lumi Lepenc dhe nga vendbanimi Ivajë e deri në grykderdhje si dhe shkallës IIb i takon lumi Nerodime deri në bashkimin e Lumit Lepenc në Kaçanik.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit. Mesatarisht çdo banor shkarkon 16.46 m³/vit ujëra të zeza.


Në lumin Nerodime shkarkohen ujëra të zeza që nga K. e Ferizajit e deri në hyrje të territorit të Komunës së Kaçanikut

Në bazë të statistikave demografike numri i banorëve në Komunë është rreth 38174 banorë $38174 \times 16.46 = 628344.04 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra të zeza ose 71 litër në ditë pa llogaritur industrinë dhe vendbanimet e Komunës së Ferizajit.

Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka. Përveç ndotjes kimike të ujërave, ku ndotësit hynë si përbërës i ujit, është ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre, krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe parazitëve që janë të dëmshëm për jetën e njeriut, florën dhe faunën që shtrihet përgjatë shtratit të lumit. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet për botën e gjallë natyrore të ujërave.

Shkarkimi i mbeturinave të ngurta është dukuri tjetër negative e lumenjëve të Kosovës, por edhe të vendbanimeve të komunës. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime ku nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave.

Harta 21. Ndotja e lumenjëve



	Pika monitoruese	Vlerat e TDS-mg/l			Vlerat e pH			Vlerat e O ₂ të tretur ne mg/l		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
	Kaçanik	109	106	121	8.07	8.17	8.20	11.09	11.3	10.5
Lepenc	Hani i Elezit	128	119	147	7.69	8.07	8.13	11.2	11.5	10.57

Lumi	Pika monitoruese	Vlerat e TDS-mg/l			Vlerat e pH			Vlerat e O ₂ të tretur ne mg/l		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
	Gërlicë	203	210	275.2	7.75	7.84	7.82	7.50	8.19	6.20
Nerodime	Kaçanik	209	223	265	7.81	8.00	8.02	9.52	10.36	9.71

Vlerat mesatare të analizave fiziko-kimike janë brenda kufinjëve të lejuar për klasën e parë dhe të dytë të shkallës së ndotjes.


6.14. Degradimi i lumenjëve

Në bazë të dhënave komunale nxjerrja e inerteve ka shkaktuar degradim të shtretërve të lumenjëve dhe, si pasojë ka ardhur deri të ndërrimi i rrjedhës natyrore të lumit, pastaj ndotjen dhe shkatërrim e biosferës në shtratin e lumit dhe përreth tij. Pasojat e shfrytëzimit të inerteve në mënyrë të pa planifikuar në shtretërit e lumenjëve shkaktojnë edhe vërshime në tokat bujqësore. Dukuritë negative janë shfaqur në këto vendbanime:

Ujë-rrjedha e lumit Lepec	Soponicë, Doganaj, Rekë, Nikaj, Biçec, Kovaçec, Bob, Kaçanik, Gajre
Ujë-rrjedha e lumit Nerodime	Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë, Gajre

Vet rritja e bimëve të larta, pengesat natyrore dhe ato antropogjen, kanë ndikuar negativisht në rrjedhën natyrore të lumit kryesisht në Lepenc dhe Nerodime.

Sipërfaqja ujore në Komunën e Kaçanikut, në bazë të vrojtimeve dhe në bazë të analizave të bëra në GIS, kanë pësuar ndryshime për shkak të uzurpimeve të shtratit të lumenjëve dhe për shkak të mbjelljes së bimëve të larta nga fermerët që kanë pronat përgjatë shtratit të lumit. Krijimi i fyteve shkakton edhe vërshime të tokave bujqësore. Krijimi i argjinaturave artificiale kanë prishë imazhin natyror të shtratit. Dukuri e tillë është përgjatë shtratit të lumit në vet qytetin e Kaçanikut por kjo zgjedhje hidroteknike ka mundësi përmirësimi me mbjellje të drujve përgjatë shtratit të lumit. Hedhja e mbeturinave janë prezent në të gjithë lumenjtë e Komunës

Harta 22. Vërshimet, gurthyesit dhe degradimet e tokës

6.15. Ndotja e ajrit

Ajri - Si ndotës i ajrit në këtë komunë është fabrika për prodhimin e gelqeres e cila ndotë ajrin me CO₂, NOX dhe me pluhur që vërehet qartë mbi kulmet e shtëpive. Komuna nuk disponon me mjete për matjen e sasisë së ndotjes, prandaj paraqitet nevoja për pajisje me këto mjete dhe avancimi i teknologjisë së prodhimit të gelqeres në mënyrë që të zvogëlohet ndotja që e shkakton procesi i prodhimit, si dhe qarkullimi i automjeteve në zonën urbane përgjatë rrugës nacionale Prishtinë-Kaçanik-Shkup

6.16. Degradimi i tokës

Sipërfaqet e tokave që kanë pësuar degradim, si pasojë e shfrytëzimit të pa kontrolluar të gurëthyesve dhe materialeve inerte lan pasoja të rënda mjedisore. Në bazë të vizitave në terren këto dukuri janë prezent në këto vendbanime: Runjevë, Doganaj, Soponicë, Bajnicë, Semajë, Ivajë, Biçec,dhe Kaçanik. Këto dukuri janë prezente edhe në territore tjera.

Dukuri negative e dëmtimit dhe degradimit të pyjeve është edhe prerja ilegale e pyjeve që si pasojë rritë sipërfaqet e zhveshura dhe inicim të dukurive negative të erozionit dhe vërshimeve.

Përkujdesja e vogël ndaj pyjeve ka ardhur edhe deri te sëmundjet dhe insektet, pastaj kalbja e drunjëve në formacionet e bungut etj.

Mjedisi jo i pastër dhe hedhja e mbeturinave të ngurta janë prezent në vendbanimet e komunës ku janë krijuar deponi ilegale që kanë pasoja për botën bimore dhe shtazore, si dhe në vetë mjedisin ku jeton njeriu. Gjatë hulumtimeve në terren janë vënë re pika degradimi edhe pranë shtretërve të lumenjëve dhe në pjesë të ndryshme të tokave.



6.17. Trashëgimia kulturore

Teritori i Komunës së Kaçanikut ka qenë i banuar që nga koha antike, nga periudha e gurit e këndej. Prania e Dardanëve në këto anë e dëshmojnë të dhënat arkeologjike në vendbanimet e ndryshme, si: Bobë, Sllatinë, Gjurgjedell Kotlinë etj.

Nga shk III p.e. sonë Kaçaniku bie nën sundimin e Perandorisë Romake, ndërsa pas ndarjes së Perandorisë Romake treva e Kaçanikut bie nën sundimin e Perandorisë Bizantine .

Nga mesi i shek IX kjo trevë bie nën sundimin bullgar . Nga fundi i shek XII Nemanjiqët shtrin pushtetin në këto treva.

Në shekullin XIV turqit osman pushtuan Kaçanikun.

Gjatë Luftës së Parë Botërore trojet shqiptare po edhe Kaçaniku u gjind në një pozitë shumë të palakmueshme. Edhe përkundër rezistencës heroike këto troje ranë nën sundimin e Bullgarëve.

Tabela 27. Objektet arkeologjike dhe historike ne Komunën e Kaçanikut

Vendbanimi	Mbetjet arkeologjike	Varre të vjetra	Kisha dhe mbetje	Kalaja
Bajnicë		Varreza të moçme	Gjiri i Kishës	
Biçec		Varreza te moçme	Lluga e Kishës	
Begracë	Mbetje te qeramikes dhe tjegullave	Varreza ilire	Themele të kishës së vjetër	
Sllatina	Rrasa guri, skelete njerëzish dhe mbetje tjera arkeologjike		Kishë e vjetër shqiptare	Kala e vjetër ilire
Bobi	Material epigrafik: I kushtohet perëndisë Andinus		Kishë e kohës romake	
Doganaj	Mbetje arkeologjike, Shkëmbi te shkruar me shkronja latine	Varreza te shumta te kohës iliro-romake dhe ato nga koha osmane	Kish te Zalli I Hodë Rekës	Nekropole romake
Drenogllava	Mbetje te ndryshme arkeologjike			
Elezaj				
Gajre	Tumë ilire	Skelete njerëzish - varreza ilire		
Goranca			Rrënoja te kishave te vjetra	
Shtraza		Varreza te vjetra shqiptare të krishtera	Themele te një kishë te vjetër	Kalaja e vjetër
Ivaja	Gjurmë arkeologjike iliro-romake	Tumë-varrezë ilire		Kalaja e vjetër mbi mahallën e Staneve dhe ne pjesën e poshtme te fshatit
Kaçaniku	Gjurmë te shumta arkeologjike .Stelë me mbishkrim latine kohës iliro-dardane			Kalaja simbol i Kaçanikut ndërtuar ne fund te shek. XVI, Kala mbi Gurin e shpumë
Kaçanik i vjetër	Gur me shkrim	Varret e tatarit	Kishë e vjetër ilire	

	latin			
Gjurgjedeli	Qeramikë bakri		Janë zbulua themele te kishës	
Korbliçi	Mbetje te tjegullave tullave etj	Varreza te vjetra krishtere		Lagja Dardhishtë, Kishë e vjetër
Llanishta	Mbetja arkeologjike-Ara e Hysenit etj	Varreza te vjetra-Lama		Gradishtë - Kështjellë romake, Kala afër Gurit të shpumë
Kotlina	Gërmadhat e një vendbanimi të fortifikuar, Tuma, mbishkrime ne altarët e kishës	Varre te vjetra		Kalaja e epërme
Reka	Nekropol -Kulinë	Mbeturina te varrezave tumul, ne lagjen Kasa varreza te vjetra	Kisha e Kasës	
Gllloboçica	Gjurmë te vjetra te livadhi Lleshit dhe te kalaja			Kala e vjetër ne gufi me fshatin Shtrazë
Runjeva	Afër tumave gjenden materiale te vjetra arkeologjike		Dy kisha	Rrafshi i Kullave -kanë ekzistuar
Semaja	Mbetje arkeologjike te Livadhet e Cules	Te mahalla e poshtme -varrezat e moçme	Kish e vjetër, mbi varrezat e sotme	
Soponica	Kodra e Kullës - gjurmë arkeologjike	Varret e latinëve		
Stagova			Guri i Kishës	
Vataj			Dy kisha	

Edhe gjatë Luftës dytë Botërore ishte e njëjta gjendje ku kjo trevë ishte nën sundimin Bullgar.

Deri në qershor të vitit 1999, respektivisht me përfundimin e luftës heroike të UÇK, përfundimisht Kaçaniku fitoi lirinë dhe pavarësinë nga pushtuesit shekullor.

Nga te gjitha këto pushtime shekullore nga Perandoria Romake e deri në vitin 1999 ka pas ngjarje nga ma të ndryshmet dhe popullata që nga koha Ilire e deri me sot u përball me luftëra e rezistenca të ndryshme .

Te gjitha këto ngjarje lan gjurmë të thella arkeologjike e historike në Komunën e Kaçanikut dhe me gjerë. Kjo trevë është ende e pa hulumtuar dhe të gjitha mbetjet arkeologjike si të kishave, varrezave, tumave, kalave etj, janë pa mbrojtje të mjaftueshme institucionale.

Në bazë të hulumtimeve të bëra janë evidentuar disa nga këto mbetje arkeologjike sipas vendbanimeve.



Trashëgimia kulturore e kësaj ane përmban një pasuri të madhe vlerash shpirtërore e materiale, me ngjarje e shkatërrime tragjike edhe të këtyre vlerave që nga antika e deri sot. Sipas të dhënave dhe zbulimeve historike e arkeologjike, edhe komuna e Kaçanikut, pjesë e Dardanisë antike është tejet e pasur me vlera materiale autoktone. Zbulime arkeologjike janë gjetur në Bob, Kaçanik, Kaçanik të Vjetër etj, që datojnë nga shekulli i II.të e.s.

Numri i monumenteve në këtë komunë është 61. Sipas të dhënave të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës dhe të dhënave plotësuese nga institucionet komunale të Kaçanikut janë evidentuar këto monumente:

1. Lokacioni arkeologjik "Te Kisha" (shek. XVI) - Bob;
2. Lokacioni arkeologjik "Pasuria e Krasniqëve" (Periudha Romake) - Kaçanik i Vjetër;
3. Lokacioni arkeologjik "në pasurinë e Rexhep Kasës" (e quajtur "Kisha e Kasës" v.j.)
4. Kalaja antike dhe e Periudhës Osmane (XIV-XV) - Kaçanik;
5. Kalaja - Kotlinë;
6. Mbishkrim varri (shek. II i erës sonë), zbuluar në vitet e '80;
7. Mbishkrim kushtuar perëndisë ilire Andinus, zbuluar rreth 5 decenie më parë;
8. Varret Shqipëtare Myslimane (XX) - Runjevë;
9. Varret e Vjetra Shqipëtare të Krishtera - Biçec;
10. Varret e Spahive - Lenishtë;
11. Varret e Vjetra Shqipëtare Muslimane (XVIII) - Nikaj;
12. Varret e Latinëve - Kamenicë (lokaliteti e quan me mikrotoponim Roga v.j.);
13. Varret Shqipëtare Myslimane - Guranë;
14. Varret e Vjetra Shqipëtare "Lisi i Kishës" - Semajë;
15. Varret e Vjetra Shqipëtare - Sopot;
16. Varret Shqipëtare Myslimane (XIX) - Stagovë;
17. Varret Shqipëtare Myslimane "Kulla" - Gllaboçicë;
18. Varret Shqipëtare Myslimane (XIX) - Kaçanik i Vjetër;
19. Varret e Vjetra Shqipëtare Myslimane (XVIII) - Bicaj;
20. Tyrbja e Musa Kesexhisë - Kaçanik;
21. Xhamia e Koxha Sinan Pashës (1594 - 95) - Kaçanik;
22. Xhamia me varre dhe Tyrbja e Sheh Sinanit - Doganaj;
23. Xhamia me varre - Ivajë;
24. Mulliri rreth 500 vjeçar në Lumas (ish Provoli), i njohur më vonë si Mulliri i


- Bajram Nikës, tani pronë e Haxhi Reshat Gurit;
 25. Muranat e kishës së vjetër - Gjurgjedell
 26. Themelet e Kishës së Vjetër - Bajë;
 27. Rruga e vjetër Shkup - Selanik në Lanishtë;
 28. Oda e Xhemajl Tronit (XIX) -Kovaçec;
 29. Oda e Rexhep Gurit (XIX) - Nikaj;
 30. Oda e Hamit Tronit
 31. Shtëpia folklorike fshatare (XIX) - Stagovë;
 32. Vendi i ashtuquajtur "Te Kisha" - Sllatinë;

Duhet theksuar se shumë monumente antike mendohet se janë zhdukur plotësisht dhe në të shumtën e rasteve dalin vetëm në toponiminë e kësaj treve, ndërkohë që objektet e vjetra, për arsye të rrethanave historike, në pamundësi të mbikqyerjes institucionale gjithashtu vazhdojnë të humbin gjurmët ose të dëmtohen shumë.

Tabela 28. Monumentet me status të mbrojtjes në Komunën e Kaçanikut

	Nr.	Objekti / Tërësia	Vendbanimi	Viti i shpalljes	Komente
Monumentet Arkeologjike	1	Lokaliteti arkeologjik "Te kisha" shek.XVI, nr.V.E.K.03-102/1-4/82	Bob (III - 1)	1982	
	2	Mbeturinat e kalasë së vjetër të Kaçanikut shek.XIV-XV, nr.V.E.K.02-979/67	Kaçanik (I - 6)		
Mon. kulti myslimane	3	Xhamia e Sinan Pashës nr.V.E.K.02-168/66	Kaçanik (I - 5)	1966	
	4	Tyrbja e Musa Kesexhisë shek.XX, nr.V.E.K.02-953/67	Kaçanik (I - 7)	1967	Kjo tyrbe sot nuk ekziston, është e rrënuar (gjatë luftës diku më 1999)

Harta 23. Trashëgëmia kulturore



6.18. Trashëgimia natyrore

Llojlojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik të Komunës së Kaçanikut, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore, që kanë përhapje në territorin e komunës konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore.

Në territorin e komunës së Kaçanikut shtrihet Parku Nacional „Mali Sharr” me sipërfaqe 1560 ha, zonë e mbrojtur që nga viti 1986 .

Në bazë të analizave dhe hulumtimeve të IPH është konstatuar se sipërfaqja e tanishme e Parkut Nacional „Mali Sharr” është 22600ha, ndërsa në Komunën e Kaçanikut propozohen për mbrojtje 2473 ha.²³

I.7. ZHVILLIMI EKONOMIK

Gjendja aktuale ekonomike e Komunës së Kaçanikut i përmban të gjitha karakteristikat e një ekonomie në tranzicion. Kjo komunë nga lufta doli me shkatërrime të mëdha si në infrastrukturë poashtu edhe në sektorët e ekonomisë.

Dëmet e shkaktuara nga lufta dhe dëmet tjera indirekte të konfirmuara nga subjektet afariste ishin 6,646,795 €²⁴. Dëmet më të mëdha ishin në fabrikat prodhuese ndërsa më së keqi pësuan: Kooperativa Bujqësore dhe Sankosi (përpunimi i materialeve sanitare).

Edhe bujqësia pësoi humbje të mëdha gjatë luftës, e veçanërisht blegtoria dhe mekanizmi bujqësor. Fondi i gjedheve ka qenë 8,826 krerë, kurse tash kemi 6,338 krerë ose 28.73% më pak, kurse bagëtia e imët kishte 4.364 krerë, kurse pas luftës kishte 1,995 krerë ose 58.71% më pak²⁵. Kurse në sektorin e infrastrukturës dhe ndërtimtarisë dëmet ishin si në vijim; 1,474 shtëpi të djegura të kategorisë V dhe IV; 260 banesa të demoluara; 9 objekte shkollore të djegura dhe objektet tjera të demoluara; 2 objekte shëndetësore të djegura dhe të demoluara; 81 objekte ndihmëse të banimit; 8 depo dhe punëtori familjare; 416 shtalla të kafshëve; 6 garazha; 31 lokale afariste(shitore); si dhe dëmtime të tjera në infrastrukturë, mekanizëm bujqësor, fondin e bagëtive etj.²⁶

Prandaj prioritet në fazën e parë ka qenë rindërtimi i shtëpive, ku afro 80% është kryer, por ende mbeten fshatra të tëra ku nuk është investuar në rindërtimin e shtëpive, pastaj në arsim, ku janë ndërtuar 12 shkolla dhe janë rehabilituar edhe 26 objekte tjera shkollore, si dhe në lëmin e shëndetësisë kemi investime të konsiderueshme ku janë ndërtuar 6 ambulanca dhe renovime të vogla në ambulancën e Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, por ende ka nevojë për të investuar. Gjithashtu edhe investime në shërbimet tjera publike si: ndërtimi i rrugës qendra e qytetit-Shtëpia e kulturës, asfaltimi i rrugëve në qendër të qytetit, ndërtimi i urës mbi lumin Lepenc në fshatin Bob dhe tek pusët e Nikës, përmirësimi i rrjetit të tensionit të ulët në disa lokalitete, ndërtimi i rrjetit primar në vijën Kaçanik-Kaçanik i Vjetër, riovimi i ujësjellësit ekzistues në Kaçanik, Elezaj, Duraj-Gabrricë-Bajnicë, etj.

7.1 Bujqësia

²³ Të dhënat nga draft dokumenti Plani hapësinor „Mali Sharr”, Prishtinë, 2009

²⁴ Nga raporti i ndërmarrjeve shoqerore

²⁵ Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe mbrojtje të ambientit

²⁶ Drejtoria për Planifikim, Zhvillim dhe Rindërtim

Bujqësia është degë primare ekonomike dhe si e tillë luan rrol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Në Komunën e Kaçanikut pjesën më të madhe të sipërfaqes e mbulojnë pyjet me 58,92%, ndërsa 41,08% e sipërfaqes është ara, kopshte, livadhe dhe djerrina, nga e cila 35,7% është tokë e punueshme²⁷.

Tabela. 29 Struktura e përgjithshme e tokës ne Komunën e Kaçanikut.


Struktura e tokës	Sipërfaqja	%
Pyje	11381.8	58.92
Bujqësore	6091.74	35.70
Djerrina	214.1	5.18
Totali	17687.64	100.00

Nga tabela kuptohet se Kaçaniku ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore dhe të pyjeve të cilat paraqesin potencial të rëndësishëm ekonomik të kësaj komune.

Tabela. 30. Kategoritë e tokës bujqësore ne Komunën e Kaçanikut

Struktura e tokës bujqësore	Sipërfaqja	%
Lavërtari	4584	75.24
Livadhe	282.5	4.64
Kulloza	1225.24	20.11
Totali	6091.74	100.00

Lavërtaria është degë e rëndësishme në zonat e ulta, ndërsa prej kulturave lavërtare apo "drithërave të bardha" që kultivohen, vend dominant zë gruri dhe misri si kultura tradicionale dhe strategjike për ekzistencën e njeriut. Përpunimi i grurit bëhet në mullirin "7 Shtatori" në Matlumë, ndërsa misri kryesisht përdoret për ushqimin e bagëtisë.



Grafiku 25. Pjesëmarrja e disa kulturave bujqësore në ha/tonë

Si shihet edhe nga grafiku drithërat janë kultura dominuese bujqësore me 1100 ha dhe 3850 tonë prodhimtari ose 3.5 t/ha, pastaj radhiten pemët me 143.3ha dhe 1423tonë prodhimtari ose 9.93t/ha dhe perimet me 58.85ha dhe 99.1 tonë prodhimtari ose 16.8 t/ha. Nga këto fakte kuptojmë që pemëtaria është kultura me prodhimtari dhe levërdi


²⁷ Drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe pronësi KK Kaçanik

ekonomike më të madhe në Komunën e Kaçanikut, zaten kjo komunë ka edhe kushte mikroklimatike shumë të favorshme për perimtari, andaj këtij sektori ekonomik në të ardhmen e afërt duhet ti kushtohet rëndësi më e madhe²⁸.

Sa i përket shpërndarjes hapësinore të tokave bujqësore, nga harta në vazhdim kuptohet se vendbanimet si: Begraca, Kaçaniku i Vjetër, Stagova, Globoçica, etj, janë vendbanime me fond më të madh të tokës, njëherit janë edhe vendbanime më të mëdha. Në përgjithësi ka një lidhje në mes të përqendrimit të popullsisë dhe sipërfaqeve me ara dhe në mes të përqendrimit të vogël të popullsisë dhe sipërfaqeve me pyje.

²⁸ Veglat e punës të plotësuara nga KK Kaçanik.


Harta 24. Struktura e tokave në Komunën e Kaçanikut



Perimekultura në Komunën e Kaçanikut kryesisht kultivohet në sipërfaqe të vogla për plotësimin e nevojave familjare. Kushtet për një zhvillim të perimekulturës janë të favorshme, ka toka që janë nën ujë por fatkeqësisht sot këto nuk shfrytëzohen. Kjo komunë ka kushte të mira për ujë me që një numër të madh të përrenjve dhe dy lumenj të cilët gjatë sezonës verore kanë ujë të mjaftueshëm. Në sipërfaqet që kanë mundësinë e ujitjes kryesisht kultivohet misri në përzierje me fasule dhe një pjesë

shfrytëzohet për livadhe. Ujitja e sipërfaqeve bujqësore bëhet përmes kanaleve, nuk ka ndonjë sistem modern të ujitjes. Në këtë drejtim duhet të mendohet dhe të përgatitet projekti i ndërtimit të pendave që do të shfrytëzoheshin për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm dhe për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore të tokës së farmerëve. Fondi i mekanizmit bujqësor është i pamjaftueshëm si dhe mekanizmi ekzistues janë në gjendje jo të mirë ose të vjetruara.

Harta 25. Struktura e tokave punuese në ha në Komunën e Kaçanikut




Në të gjitha vendbanimet e komunës së Kaçanikut mbizotrojnë drithërat si kulturë dominuese mirëpo edhe kulturat tjera janë prezentë si pemët dhe perimet. Perimet kultivohen shumë pak dhe kryesisht për nevoja familjare dhe të tregut lokal dhe nuk

kanë ndonjë shpërndarje hapësinore specifike. Kurse, pemët kanë një përqendrim kryesisht të rregullt dhe janë të përqendruara kryesisht në anën e djathtë të lumit Lepenc apo në shpatet e malit të Sharrit. Ky përqendrim është i kushtëzuar kryesisht nga kushtet mikroklimatike që ka kjo zonë ku bëjnë pjesë fshatrat si; Bajnicë, Sllatinë, Elezaj, Doganaj, Dubravë, Biçec, Kovaqec, Bob, Kotlinë, etj.

Gjithashtu fondi i konsiderueshëm i livadheve dhe kullosave krijon kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë, por prania e racave jo shumë produktive, 20% busha, 60% lokale e kryqëzuar si dhe 20% racës produktive simental, frizis, montafone etj., nuk mundëson prodhimtari të kënaqshme për shkak të kapacitetit të tyre gjenetik prodhues. Gjatë luftës, bujqësia e veçanërisht blegtoria dhe mekanizimi bujqësor, kanë pësuar humbje të mëdha. Blegtoria është një sektor me rëndësi meqë familjeve në fshat u ndihmon jo vetëm të sigurojnë ekzistencën e tyre, por tepricat e prodhimeve blegtorale ti shesin në treg apo të blihen nga industria përpunuese e mishit dhe bylmeteve.

Gjedhet mbahen në ekonomitë familjare dhe produkti kryesor që fitohet prej gjedhëve është qumështi. Meqë nuk ka ndonjë qendër grumbulluese të qumështit, ai nxirret individualisht në treg. Në disa ekonomi familjare bëhet përpunimi i qumështit në djathë dhe yndyrë. Numri i deleve krahasuar me të kaluarën ka rënë dukshëm. Kjo ka ndodhur më shumë për arsyen e mungesës të plasmanit, sidomos të qengjave dhe leshit në tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Nëse do të sigurohej ky plasman, interesimi për t'u marrë me këtë veprimtari do të vinte në shprehje.



Grafiku 26. Struktura e fondit të blegtorisë

Pjesëmarrja e gjedhëve në Komunën e Kaçanikut është shumë e vogël edhe përkundër mundësive natyrore që ofron kjo komunë²⁹. Numri i lopëve qumështore arrinë në 3695 krerë ose 0.09 për kokë banori, pjesa dërmuese janë të racës joproduktive prandaj nevojat për investime në funksion të përmirësimit të racës të domosdoshme. Fondi i deleve është 3603 krerë ose 0.094 për kokë banori ndërsa dhi 538 krerë ose 0.013 krerë për kokë banori. Fondi i konsiderueshëm i kullosave dhe tokave tjera të përshtatshme

²⁹ Veglat e punës të plotësuara nga KK Kacanik.

për këto lloj bagëtish nuk shfrytëzohen sa ka mundësi dhe si duhet të shfrytëzohen. Buallicat janë në numër shumë të vogël, kurse kuajt janë në numër të konsiderueshëm, kjo për faktin që komuna e Kaçanikut është kryesisht terren kodrinoro-malor dhe në këtë terren kuajt janë shumë të përshtatshëm për nevojat e fshatarëve.


Në Komunën e Kaçanikut ekziston Stacioni i Veterinarisë, mirëpo nuk është në funksion. Ky stacion është pronë e komunës. Këshillat nga bujqësia dhe blegtoaria jepen nga drejtorati përkatës pranë KK dhe nga veterinarët në ordinancat private.

Nga harta në vazhdim kuptohet që kushtet natyrore ose konkretisht relievi dhe vegjetacioni kushtëzojnë edhe llojin dhe fondin e bagëtisë. Gjithashtu kuptohet që vendbanimet me popullatë më të madhe kanë edhe fond blegtoral më shumë dhe ky është një indikator që nënkupton se bagëtia në Komunën e Kaçanikut mbahet kryesisht për nevoja të ekonomisë familjare dhe atë kryesisht gjedhet e trasha.

Perhapja më e madhe e lopëve të qumështit është në vendbanimet fushore dhe kodrinore, kurse në terrene më të thepisura numri i tyre zvogëlohet kurse bagëtia e imët rriten në numër. Kjo për shkakun që dhinë nuk kanë kërkesa shumë specifike, përkundrazi terrene të ashpra janë më të përshtatura, gjithashtu këto terrene janë edhe një potencial i mirë për kultivimin dhe rritjen dhive, aktivitet i cili është shumë profitabil.


Sipas regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare të bëra në 2009 për nevoja të PZHK-së dhe PZHU-së rezultohet që mesatarja e tokës bujqësore për kokë banori në Komunën e Kaçanikut është 0.59ha, vlerë e cila tregon një shifër mjaft të madhe në raport me mesataren e Kosovës. Kurse sa i përket fondit të bagëtisë dhe shpezëve gjendja është si në vijim, 3695 krerë gjedhe ose 0.09 krerë gjedhe për kokë banori ose një gjedh për 10.3 banorë. Kurse për kafshë të imëta (dhen ose dhi) 0.08 krerë për kokë banori ose rreth 12 banorë kanë një dele ose dhi, ndërsa për shpezë kemi një situatë numerikisht më të favorshme por në proporcion jo të favorshëm, 0.48 copë shpezë për kokë banori ose një pulë për dy banorë.

Nëse kemi parasysh racën jo produktivë të lopëve, një lopë për 10.3 banorë nuk është e mjaftueshme. Kjo gjendje në Komunën e Kaçanikut është e pavolitshme, një komunë kryesisht rurale, me fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore dhe kullosave tregon për shkallë shumë të ultë të zhvillimit të kësaj dege ekonomike.




Grafiku 27. Numri dhe raporti i gjedheve, deleve-dhive dhe shpezëve për koke banori ³⁰

Harta 26. Pjesëmarrja e gjedheve në Komunën e Kaçanikut



Harta 27. Struktura e fondit të bagëtisë në Komunën e Kaçanikut


³⁰ Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare për nevojat e PZHK-PZHU Kaçanik, 2009.



Në komunë janë të evidentuar 184 bletarë me 1569 shoqëri bletësh-koshere. Kjo veprimtari është mjaft e vjetër në këtë komunë. Ekzistojnë kushte të volitshme natyrore për këtë veprimtari. Për shkak të florës së pasur të kësaj treve, kualiteti i mjaltit është i cilësisë së lartë.

Gjatë viteve të 90-ta pyjet janë shkatërruar shumë si nga pushteti serb poashtu edhe nga keqpërdoruesit e ndryshëm të cilët edhe tani shkatërojnë pyllin, duke eksploatuar


masën drunore për nevoja dhe qëllime të tyre. Si pasojë e këtij eksploatimi, sot kemi me qindra hektarë sipërfaqe të zhveshura që ka pasoja ekologjike të konsiderueshme. Kjo komunë posedon sipërfaqen prej 12449 ha pyje në të dy sektorët. Në sektorin privat janë të evidentuar 3485.8 ha ha, ndërsa në atë shoqëror 8963.2 ha. Në këto sipërfaqe pyjore dallohen keto formacione: *ahu, dushku, pisha, shkoza* etj. Gjendja e pyjeve nuk është e mirë për arsye të moskujdesit të qytetarëve, të cilët sigurojnë ekzistencën familjare duke e prerë pyllin ilegalisht për shitjen e drurit kryesisht për djegie. Nga viti 2002-2009 në Komunën e Kaçanikut janë ripyllëzuar 85 ha, prej tyre 78 ha janë ripyllëzuar me lloje të pishave (pisha e zezë, pisha e bardhë dhe hormoç) ndërsa 7 ha janë ripyllëzuar me bagrem. Fidanet janë siguruar nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës. Shkalla e parcelizimit është mjaft e theksuar në Komunën e Kaçanikut dhe nuk ndryshon fare në raport me situatën e përgjithshme në Kosovë. Mesatarja e madhësisë së parcelës në Komunën e Kaçanikut është 0.61 ha.



Grafiku 28. Raporti në mes madhësisë të ngastrave/ha në Komunën e Kaçanikut

Nga analiza e bërë kuptohet se 82.26% e ngastrave në Komunën e Kaçanikut janë të madhësisë deri 0.50 ha, 11.06% janë prej 0.51-1/ha, ndërsa 4.34% janë 1.1- 2/ha dhe vetëm 2.34% janë mbi 2ha. Me fjalë të tjera 93.3% e ngastrave në Komunën e Kaçanikut janë të madhësisë prej 1ha e më të vogla dhe kjo gjendje është pengesë e zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Kaçanikut. Meqë problemet e fragmentimit janë edhe probleme pronësore, çdo masë për komasacion do të jetë proces shumë kompleks në dimensionin organizativ, social, financiar dhe kohorë³¹. Ndërsa, sa i përket shkallës së fragmentimit sipas vendbanimeve nuk ka ndonjë ndryshim të madh, në përgjithësi gati të gjitha zonat kadastrale, me përjashtim të Drenogllaves, mbi 80% të ngastrave i kanë të madhësisë deri 1ha.

³¹ Analizë në GIS; planet kadastrale sipas komunave kadastrale në Kaçanik.



Grafiku 29. Raporti në mes madhësive të ngastrave në komunat kadastrale të Kaçanikut

7.3 Tregtia


Pozita gjeografike e komunës së Kaçanikut dhe situata e përgjithshme në 10 vitet e fundit kanë kushtëzuar për një dominim të sektorit tregtarë duke marr në konsideratë disa elemente strategjike si janë; dy vendkalime dhe pika doganore (70% të importit të Kosovës), rrugët e karakterit nacional, hekurudhën (5 stacione treni), nje lidhëse në mes dy kryeqyteteve (Shkupit dhe Prishtinës), etj.

Sigurisht që edhe papunësia e madhe si dhe shfrytëzimi jo i mjaftueshëm i kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve shoqërore, gjithashtu edhe problemet tjera kanë ndikuar në orientimin e qytetarëve në sektorin privat. Numri i bizneseve të regjistruara arrin në 1055³², ku shumica e bizneseve merren me tregti, kurse numri i të punësuarve vetëm në sektorin privat arrin në 1.747 punëtorë³³.

Sa i përket bizneseve të regjistruara në pronësi private ato në strukturën e veprimtarive ekonomike kryesisht janë biznese tregtare dhe shërbyese.

³² Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Kaçanikut


³³ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Kaçanikut



Grafiku 30. Struktura e bizneseve në Komunën e Kaçanikut

Tregtia është sektori më i shprehur i ekonomisë së Kaçanikut, me gati gjysmën e bizneseve të regjistruara, pastaj radhiten shërbimet me 23%, transporti me 8%, hoteleria me 7% dhe sektorët tjerë me pjesëmarrje më të vogël. Pozicioni i "Portës Jugore" të Kosovës, mungesa e kapitalit të mjaftueshëm, përvojës në biznes, qasja e pamjaftueshme në trendët bashkëkohore të biznesit kanë kushtëzuar që shumica e investimeve të drejtohen në tregti, shërbime dhe hoteleri e më pak në sektorin prodhues. Orientimi i investimeve në sektorët e lartpërmendur arsyetohet me investime më të ulta dhe përfitime më të larta.

Harta 28. Struktura e veprimtarive tregtare në Komunën e Kaçanikut



Veprimtaritë tregtare janë të shpërndara gati në të gjitha vendbanimet e komunës së Kaçanikut, me përjashtim të fshatrave Semajë, Drenogllavë, Nikoc dhe Llanishtë. Përqendrimi më i madh i tyre është kryesisht në vende strategjike për tregtinë si; vendbanimet me popullësi më të madhe, vendbanimet me shtrirje përgjatë rrugëve shetërore, kryqëzimeve rrugore si dhe në vendbanimet ku ka stacione treni. Gjithashtu edhe në vendbanimet e tjera sepse bizneset tregtare ose “shitoret” janë nevojë

elementare e furnizimit të popullsisë me artikuj ushqimorë, sanitarë etj. Sa i përket tregtisë me shumicë, ky lloj tregtie është i zhvilluar vetëm në qytetin e Kaçanikut ku ndodhën rreth 10 depo.

Kjo renditje e aktiviteteve ekonomike nuk është në përputhje me potencialet dhe nevojat zhvillimore të kësaj komune. Në Komunën e Kaçanikut ka potenciale për zhvillimin e industrisë përpunuese (druri), industrisë së materialit ndërtimor e cila dikur ka qenë bartëse e zhvillimit dhe punësimit në komunë, ndërtimtarisë, etj. Për momentin këto potenciale industriale, me përjashtim të fabrikës së gëlqeres në Kaçanik, nuk funksionojnë ose punojnë me një kapacitet shumë të kufizuar. Komuna e Kaçanikut posedon pasuri natyrore si mineralin mergele (MT) për prodhimin e materialit ndërtimor dhe lloje të tjera të gurit gëlqeror³⁴.

7.4 Turizmi

Kaçaniku edhe pse dallohet me potenciale për zhvillimin e turizmit, si psh; pjesëmarrja në PNMSH, pasuritë ujore (Lepenci), Gryka e Kaçanikut, disa objekte hoteliere dhe dy pishina, Xhamia e Koxha Sinan Pashës, kalaja, si dhe objekte dhe lokalitete tjera atraktive dhe me vlerë kulturore, të gjitha këto elemente me rëndësi turistike deri tani nuk kanë ndihmuar shumë në zhvillimin e turizmit në këtë komunë.



Nga vitet e 80-ta ekziston plani i Qendrës Rekreative Sportive “Livadhet e Shtrazës” por deri me tani nuk është bërë asnjë hap i mëtutjeshëm rreth këtij projekti. Poashtu është

³⁴ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Kaçanikut

hartuar edhe një projekt ideor për një Qendër Turistike Sportive “Kaçaniku” në shpatet e Sharrit në vitin 2002, por ende nuk ka diçka konkrete³⁵.

Monumentet kulturo-historike që e bëjnë më atraktive ofertën turistike të kësaj treve janë kalaja që gjendet në qendër të qytetit të Kaçanikut e ndërtuar në fund të shekullit XVI (1595) dhe Xhamia e Kaçanikut e ndërtuar nga veziri i madh Koxha Sinan Pasha në vitin 1594.

Shumë pllaka përkujtimore dhe lapidarë të pasluftës të vitit 1999, paraqesin një potencial turistik, p.sh. për ekskursionë të ndryshme për nxënës, studentë, grupe të ndryshme etj.

Siç shihet edhe nga fotografia peizazhi i komunës së Kaçanikut është një potencial i mirë për zhvillimin e turizmit të shumë llojeve në këtë komunë, duke filluar nga turizmi transit, malor, rural, kulturorë, skijimi dhe deri te alpinizmi³⁶. Kjo trashëgimi dhe potencial i jashtëzakonshëm natyror, dallohet me kushte të volitshme topografike dhe klimatike, duke përfshirë shpatet e Sharrit, Grykën e Kaçanikut dhe pasuritë ujore (lumenjtë Lepenci dhe Nerodinja). Një segment i rëndësishëm është mundësia e zhvillimit të turizmit transit. Ekzistojnë parakushtet për këtë lloj turizmi sepse nëpër territorin e kësaj komune kalohet nga Maqedonia në Kosovë dhe pikat kufitare hyrëse janë më të frekuentuarat në Kosovë. Me këtë rast turistëve tranzitorë, përveç monumenteve të natyrës, u ofrohen edhe monumentet kulturo-historike të kësaj treve³⁷.



³⁵ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Kaçanikut

³⁶ Vizita në terren, qershor 2009

³⁷ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Kaçanikut

Gryka e Kaçanikut dhe lumi Lepenc janë gjithashtu atraksione turistike në vete dhe përbëjnë potencial të mirë si për zhvillimin e peshkimit, gjuetisë si dhe për ekspedita me barka të cilat mund të fillojnë nga Kaçaniku dhe të arrijnë detin Egje.

7.5 Industria

Kaçaniku pas lufte doli me shkatërrime të mëdha, me infrastrukturë, transport të dëmtuar dhe vjetruar, shërbime publike me kapacitet jo të plotë funksional, me ekonomi të dëmtuar dhe pa investime zhvillimore me më shumë se një dekadë, etj. Kjo gjendje ka kushtëzuar edhe shkallën e zhvillimit ekonomik dhe industrisë në veçanti në këtë komunë.

Kaçaniku ka një traditë të hershme manufakturale dhe private, sidomos për prodhimin e gurit gëlqeror, rërës, drurit për ndërtimtari dhe shërbime të ndryshme zejtare. Në territorin e komunës afrojnë 7 ndërmarrje shoqërore, 2 ndërmarrje publike etj. Ndërmarrjet shoqërore punësojnë 1.913 punëtorë, ndërsa ato publike 77.³⁸

Veprimtari bazë e ndërmarrjeve shoqërore është prodhimi i materialit ndërtimor si: gëlqerja, gurët, produktet e gas-betonit dhe pllakave izoluese në ndërtimtari.


Kapacitetet prodhuese dhe shërbyese të ndërmarrjeve shoqërore nuk janë duke u shfrytëzuar në shkallë të mjaftueshme për shkak të një numri mjaft të madh të problemeve të natyrave të ndryshme.

Sido që të jetë mund të konstatohet se ekonomia në Komunën e Kaçanikut është vazhdimisht e ballafaquar me strukturë të papërshtatshme, pra me një strukturë të industrisë së rëndë me shpenzime të larta të investimeve në mirëmbajtje dhe me normë të ultë të akumulimit, me punësim i cili ka stagnuar me vite dhe me probleme të transformimit të pronës.³⁹

Sipas të dhënave nga komuna e Kaçanikut, kuptohet që momentalisht industria ndërtimore është më e zhvilluar ose me numër më të madh të ndërmarrjeve, kjo për faktin që komuna ishte në një stad të ulët zhvillimi dhe në një shkallë të madhe shkatërrimi gjatë luftës së fundit për liri. Pastaj vjen industria e drurit e cila sigurisht është e lidhur me resurset drunore që ka komuna e Kaçanikut si dhe me industrinë ndërtimore.

³⁸ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Kaçanikut

³⁹ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Kaçanikut




Grafiku 31. Struktura industriale ne Komunën e Kaçanikut

Nga harta shihet se industria është e koncentruar kryesisht në Kaçanik, Doganaj, Kaçanik i Vjetër, Gllloboçicë si dhe në Nikaj. Kurse në vendbanimet tjera është e përqendruar pak. Në Kaçanik dhe Doganaj zhvillohet industria ndërtimore, e drurit dhe metalurgjisë, kurse në Kaçanik të Vjetër dhe Nikaj është vetëm industria ndërtimore dhe metalurgji-kimike. Kurse në Gllloboçicë është e zhvilluar vetëm industria ndërtimore, ndoshta për shkak të mundësisë më të lehtë të eksportit dhe importit, për faktin që në Gllloboçica është edhe njëra ndër pikat doganore të Kosovës.

Industria zakonisht zhvillohet afër rrugeve dhe nyjave të rëndësishme komunikative, prandaj këto lokacione duhet të shihen si potencial i zhvillimit të ardhshëm të ekonomisë dhe industrisë në veçanti.

Harta 29. Struktura e industrisë në Komunën e Kaçanikut



7.6 Minjerat dhe xehetaria

Kaçaniku ka resurse të konsiderueshme natyrore, sidomos të mineraleve për prodhimin e materialit ndërtimor guri gëlqerorë, argjilë, pyjeve, ujërave rrjedhëse etj.

Rezervat e gurit gëlqeror në Kepin e Kaçanikut janë në sasi prej 127 mil/t të kategorisë A, B dhe C, ndërsa rezervat e gurit gëlqerorë në pjesën shkëmbore të fshatit Ivajë, janë në sasi prej 25mil/t ⁴⁰. Ka edhe rezerva tjera të cilat nuk janë konstatuar sasitë e tyre. Janë konstatuar gjithashtu edhe rezerva të argjilës në lagjen Dushkaja të Kaçanikut. Pas resurseve minerale, Kaçaniku ka resurse të mëdha të pyjeve, tokës dhe ujërave. Kaçaniku ka një fond të mjaftueshëm të pyjeve (17.302 ha ose 58.08% të sipërfaqes së përgjithshme).


Sipas të dhënave të KPMM-së⁴¹ komuna e Kaçanikut është e pasur me minerale të kromit (Cr), pastaj me rezerva të hekurit(Fe), arseniku (As), bakri (Cu). Të gjitha këto rezerva minerale ndodhën në shpatet e maleve të Sharrit dhe nga ky fakt kuptohet që prej rrjedhës së djathtë të lumit Lepenc në drejtim të malit Sharr shtrihen gati të gjitha rezervat minerare të komunës së Kaçanikut. Kjo mund të shihet edhe nga harta në vazhdim.

Në Komunën e Kaçanikut janë gjithsej 5 gurëthyes aktiv të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre në tri vendbanime, si: Doganaj (2), Runjevë (1) dhe Kaçanik (2). Gurthyesit aktivitetin e tyre më të madh e kanë filluar pas luftës së fundit dhe janë me ndikim të madh mjedisorë, disa prej të cilëve janë jo shumë larg nga kufijtë e Parkut Nacional Mali Sharr.

⁴⁰ Fabrika për prodhimin e gurit gëlqeror "Lepenci" Kaçanik

⁴¹ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (Map of Minerals of Kosovo, 1:200,000)

Harta 30. Minierat dhe resurset tjera minerale



7.7 Tregu i punës dhe papunësia

Komuna e Kaçaniku me afro 38,174 banorë me popullsi vitale ku shumicën e popullsisë e përbën gjenerata e re, ballafaqohet me problemin e punësimit. Mbi 6.473 të rinjë janë të evidentuar në byronë e punësimit, prej tyre 2.476 janë femra dhe 3997 janë meshkuj.

Numri i të punësuarve në komunë është 4.635, prej tyre 177 janë femra. Struktura e të punësuarve sipas sektorëve :

- Ndërmarrjet shoqërore 1913;
- Ndërmarrjet publike 77;
- Shërbimet publike 898 dhe
- Sektorin privat 1747⁴².

Shkalla e papunësisë në Komunën e Kaçanikut në bazë një projekti pilot në fshatin Strazhë është marrë për bazë numri i përgjithshëm i popullsisë, strukturat e popullsisë sipas grup-moshave etj, llogaritet se shkalla e papunësisë është 65 %.

Sipas regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare, i realizuar në 2009 nga komuna e Kaçanikut dhe kompania DataGISconsulting rezulton që në Komunën e Kaçanikut ka gjithsej 5859 të punësuar. Numrin më të madh e ka qyteti i Kaçanikut me 1425 të punësuar ose 24.32%, Doganaj me 599 të punësuarve ose 10.22% dhe Biçeci me 490 të punësuar ose 8.36%, kurse numrin më të vogël ose që nuk kanë të punësuar fare, janë vendbanimet si Drenogllava, Korbiliqi me 8 të punësuar ose 0.14% dhe Gjurgjedelli me 9 të punësuar ose 0.15%.

Tabela 32. Të punësuarit dhe buxheti familjarë sipas vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut⁴³.

Vendbanimi	Popullsia	Nr. te punësuarve	%	Buxheti familjar në €	%	€ / kokë banori
Bajnicë	610.00	112.00	1.91	91,875.00	4.51	2.77
Begracë	2,495.00	399.00	6.81	185,087.65	9.08	5.58
Biçeci	1,620.00	490.00	8.36	81,291.30	3.99	2.45
Bob	1,669.00	358.00	6.11	94,967.03	4.66	2.86
Doganaj	1,146.00	599.00	10.22	62,239.00	3.05	1.88
Drenogllavë	54.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Dubravë	1,253.00	166.00	2.83	59,182.60	2.90	1.78
Duraj	400.00	44.00	0.75	42,835.00	2.10	1.29
Elezaj	547.00	55.00	0.94	10,280.00	0.50	0.31
Gabrricë	303.00	39.00	0.67	19,421.00	0.95	0.59
Gajre	540.00	54.00	0.92	15,421.00	0.76	0.46
Gerlicë	432.00	88.00	1.50	15,193.40	0.75	0.46
Gjugjedelli	235.00	9.00	0.15	3,855.00	0.19	0.12
Gllloboçicë	1,289.00	164.00	2.80	44,726.20	2.19	1.35
Ivajë	587.00	32.00	0.55	9,514.00	0.47	0.29
Kaçanik	9,007.00	1,425.00	24.32	600,237.00	29.45	18.09

⁴² Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Kaçanikut


⁴³ Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare për nevojat e PZHK-PZHU Kaçanik, 2009.

Kaçanik i Vjetër	2,188.00	413.00	7.05	147,506.00	7.24	4.45
Llanishtë	436.00	10.00	0.17	2,135.00	0.10	0.06
Korbliq	153.00	8.00	0.14	2,100.00	0.10	0.06
Kotlinë	618.00	51.00	0.87	25,667.00	1.26	0.77
Kovaçec	1,418.00	380.00	6.49	179,254.30	8.79	5.40
Nikaj	912.00	166.00	2.83	41,880.00	2.05	1.26
Rekë	843.00	107.00	1.83	45,295.00	2.22	1.37
Runjeve	839.00	163.00	2.78	95,363.00	4.68	2.87
Semaj	249.00	18.00	0.31	7,745.00	0.38	0.23
Sllatinë	189.00	14.00	0.24	4,190.00	0.21	0.13
Soponicë	1,464.00	221.00	3.77	59,317.00	2.91	1.79
Stagovë	1,413.00	229.00	3.91	77,456.00	3.80	2.33
Strazhë	271.00	45.00	0.77	14,110.00	0.69	0.43
Totali	38 174	5 859	100	2,038,143.48	100	61.43

Numri i punëtorëve dhe të ardhurave për kokë banori në Komunën e Kaçanikut mund të kuptohet edhe nga hartat në vazhdim.

Në përgjithësi të ardhurat mesatare për kokë banori në komunë e Kaçanikut janë shumë të ulëta dhe investimet në sektorët me rëndësi në këtë komunë janë jetike për përmirësimin e mirëqenies sociale të popullatës së kësaj komune.

Harta 31. Numri i të punësuarve në Komunën e Kaçanikut sipas vendbanimeve



Harta 32. Të hyrat buxhetore (për familje) sipas vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut

